

magazina . evropiane

SOROS

Fondacioni i Kosovës për Shqetësi të Hapur
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo
Kosovo Foundation for Open Society

| Tetor 2011 |

| Numri 5 |

Romët, Ashkalijtë dhe Egjiptasit



Romët, Ashkalijtë & Egjiptianët

HYRJE

Integrimi i komuniteteve Rom Ashkali dhe Egjiptase ne Kosovë

Shumë pak është debatuar dhe shkruar deri tash për politikat europiane ndaj komunitetit Rom, të cilit duhet shtuar edhe atë Ashkali dhe Egjiptas kur flasim për Kosovën. Jo se BE nuk ka qenë e interesuar për këto komunitete dhe çështjet që lidhen me punën, kulturën, të drejtat, integrimin, arsimimin e tyre, sidomos kur jetojnë në shtetet anëtare të BE-së. Por edhe përkundër këtij angazhimi, ecja përpara e këtyre komuniteteve, që nuk janë fare pakicë në Europë, ka qenë e ngadalshme, dhe diku ka shënuar edhe regres.

Mund të thuhet se çështja Rome, si i thonë në Europë, vitet e fundit është bërë edhe subjekt i politikave më të shprehura të vendeve anëtare të BE ndaj tyre, të cilat do të duhej të rezultonin me përmirësime inkurajuese. Në këtë magazinë, është sjellë një informacion i bollshëm për këto politika, që do të duhej të shënonin një kthesë pozitive drejt integritit të këtyre komuniteteve në Europën e sotit.

Magazina Evropiane, ashtu si është e konceptuar nga ne në Fondacionin e Kosovës për Shoqëri të Hapur, sjell këndvështrime të ndryshme të ekspertëve dhe aktivistëve të kësaj lëmie. Dhe, për këtë numër kemi gjetur shumë persona të interesuar që të ndajnë me ne ekspertizën dhe eksperiencën e tyre, që është e bollshme, në adresimin e çështjeve romë në Europë dhe atyre që ndërlidhen posaqërisht me komunitetet RAE në Kosovë. Në dy dekadat e fundit, sidomos në Ballkan, këto grupe etnike u gjetën në mes të luftërave të cilat nuk ishin të tyre, dhe janë dashur të lëvizin nga një situatë ekstreme në tjetrën. Shumica migruan, dhe një pakicë ka mbetur të ballafaqohet me tmeret e luftës. Por edhe vendet e Europës perendimore, ku migruan ata që quhen me fat, nuk i pritën me krah të hapur. Hjek asistencën humanitare, vendet perendimore nuk treguan se dinë dhe donë me i adresuar problemet e këtyre komuniteteve, përveq se të ju ofrojnë strehim të përkohshëm.

Viteve të fundit, kur një pjesë e madhe e qytetarëve të përfshirë në luftë është konsoliduar brënda shteteve ballkanike ku jetojnë, në Kosovë, egzodi i komuniteteve RAE fillon për së dyti, por në drejtim të

kundërt. Ata tash kthehen me forcë nga shtetet nikoqire perendimore në Kosovë, dhe kryesisht ballafaqohen me probleme njejtë të rënda si një dekadë më parë.

Kjo Magazinë sjell artikuj të ndryshëm që sjellin informacion por edhe gjykim kritik për këto procese. Posaqërisht shpalosin opcionet që e kanë burimin në politikat europiane, ku shpresojmë të jetë Kosova së shpejti, si dhe rezultatet e marrëveshjeve që autoritetet kosovare i kanë bërë lidhur me ri-atdhesimin e personave që nuk kanë leje qëndrimi në vendet e europës perendimore, kryesisht anëtare të BE. Poashtu, janë adresuar edhe dy procese që e shënojnë dukshëm diskursin aktual, dhe njëkohësisht janë shansë për integrim të suksesshëm. Në planin ndërkombëtar është Dekada e Romëve dhe në planin kombëtar është Strategjia për Integrimin e Komuniteteve RAE në Kosovë. Besoj se ka shumë informacion që e sjell lexuesin më afër këtyre proceseve, të cilat qëndrojnë në ballë të veprimit të institucioneve civile dhe donatorëve të ndryshëm. Edhe institucionet qeveritare tashmë janë më afër këtyre problemeve, dhe tashmë janë duke treguar se e kanë kuptuar peshën e tyre: kanë akorduar buxhet për disa nga aktivitetet që dalin nga strategjia si dhe për përkrahje të procesit të riatdhesimit. Besojmë fort se tashmë jemi duke i parë shenjat e para të një vetëdije të ngritur në Europë, Ballkan dhe Kosovë, për nevojën emergjente që komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas të ju ofrohet një shansë serioz për tu integruar sa më shpejtë dhe më mirë në shoqëritë ku jetojnë.

*Luan Shllaku
Drejtor Ekzekutiv
Fondacioni i Kosovës për
Shoqëri të Hapur*



Revista është inicuar dhe realizuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur. Opinionet e autorëve të artikujve të publikuar nuk përfaqësojnë qëndrimet e Fondacionit. • Bordi editorial: Luan Shllaku, Agron Bajrami, Venera Hajrullahu, Iliriana Kaçaniku, Fatmir Curri, Ilir Deda e Alban Zogaj. Koordinator i këtij edicioni: Vera Pula, Design & Layout: Sami Kçiku. • Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur - Adresa: Ulpiana, Imzot Nikë Prela, Villa Nr. 13, 10000 Prishtinë; tel.: +381 38 542 157; e-mail: info@kfos.org

NË KËTË NUMËR

ROMËT, ASHKALINJTË & EGJIPTIANËT

BE-JA NDËRMERR VEPRIM LIDHUR ME INTEGRIMIN E ROMËVE: A DO TA BËJNË TË NJËJTËN GJË EDHE SHTETET ANËTARE?

Bernard Rorke

Faqe 4

POLITIKAT E BE-SË PËR PËRFSHIRJEN E ROMËVE

Martin Demirovski

Faqe 6

KORNIZA E BE-SË PËR STRATEGJITË NACIONALE PËR INTEGRIMIN E ROMËVE – NJË MUNDËSI PËR RIORGANIZIMIN E PËRPEKJEVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE PËR TA TRASUAR RRUGËN PËRPARA

Blerinda Idrizi

Faqe 10

ANTI-CIGANIZMI: PARAGJYKIMI QË E NXJERR PROGRESIN NGA BINARËT

Bernard Rorke

Faqe 13

PARA SE TË BËHET TEPËR VONË – DEKADA E PËRFSHIRJES SË ROMËVE NË BALLKANIN PERËNDIMORË

Stephan Müller

Faqe 16

E ARDHMJJA PËRTEJ SIMBOLIKËS: PJESËMARRJA, PËRFAQËSIMI DHE EMANCIPIMI I ROMËVE

Željko Jovanović

Faqe 19

PA ATDHE – TË VËRTETAT LIDHUR ME RIATDHESIMIN NË KOSOVË SOT

Verena Knaus

Faqe 21

RISTRUKTURIMI I DEBATIT: RIATDHESIMET E DETYRUESHME SHIKUAR NGA PRIZMI I TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Chelsey Lepage

Faqe 24

KOSOVA: RIATDHESIMI I POPULLATËS MË TË CENUESHME TË EVROPËS

Shkruar nga Qendra për Dokumentim të romëve dhe ashkalinjëve – RADC

Faqe 28

NJË VËSHTRIM PRAPA, DHE TË SHIKOSH VJEDHURAZI NË TË ARDHMEN

Strategjia për Integrimin e Komuniteteve Roma, Ashkali dhe Egjiptase në Republikën e Kosovës.

Muhamet Arifi dhe Rand Engel

Faqe 31

ROMËT, ASHKALIJËT DHE EGJIPTASIT SFIDA EVROPIANE

Vera Pula

Faqe 35



SFIDAT GJATË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR INTEGRIMIN E KOMUNITETEVE ROMA, ASHKALI DHE EGJIPTASE 2009-2015

Cairan O'Toole

Faqe 37

DYZETË MASA PËR TË NXITUR ZBATIMIN E STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR KOMUNITETET ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN

Faqe 39

PROJEKTET PËR MBËSHETJE TË IMPLEMENTIMIT TË STRATEGJISË PËR INTEGRIMIN E KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTAS

Faqe 41

PËRKRAHJA E BE-SË PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË RAE

Përkrahja e BE-së për procesin e integrimit

Faqe 42

SOROS FONDI PËR IMPLEMENTIM TË RAE STRATEGJISË

Rebeka Qena

Faqe 45

KULTURA ROME

Kujtim Paçaku

Faqe 47

ROMËT – KULTURA DHE IDENTITETI I TYRE

Ibrahim Elshani

Faqe 51

ARTI NË VEPRIM, IMAGJINATA I SHTYN TË RINJTË ROM, PLEMETINA I DREJTOHET PLANETIT

Faqe 55

ROLLING FILM FESTIVALI: KINEMATOGRAFIA ROME, RROKULLISJA PËR NDRYSHIM

Filma të krijuar nga & për romët

Charlotte Bohl

Faqe 57

Romët, Ashkalijët & Egjiptianët

BE-JA NDËRMERR VEPRIM LIDHUR ME INTEGRIMIN E ROMËVE: A DO TA BËJNË TË NJËJTËN GJË EDHE SHTETET ANËTARE? Bernard Rorke



Miratimi i 'Kornizës së BE-së për Strategjitë Kombëtare për Integrimin e Romëve deri më 2020' nga ana e Këshillit Evropian më 24 qershor shtyu Komisioneren Vivien Reding të deklarojë që:

"Marrëveshja e sotme është një hap i madh përpara për miliona romë anëmbanë Evropës. BE-ja po dërgon një sinjal të fuqishëm: përjashtimi i romëve nuk është në pajtueshmëri me vlerat tona shoqërore dhe me modelin tonë ekonomik."

Një hap gjigant për zyrtarët e BE-së ndoshta, por një hap gjigant për njerëzimin, një hap i madh përpara për miliona romë? Ende duhet të punohet shumë për ta realizuar hiperbolën sepse sfida me të cilën ballafaqohet korniza evropiane është e zymtë. Si i përkufizojmë 'vlerat shoqërore' përkundër suksesit zgjedhor anëmbanë Evropës të partive politike ekstreme të djathta që përhapin urrejtje dhe të mohimit koherent gjithnjë e më të zëshëm të multikulturalizmit që buron nga rryma qendrore e të djathtës? Çka është gjithëpërfshirëse lidhur me 'modelin tonë ekonomik' në një union ku aq shumë shtete përbërëse anëtare mbeten të skllavëruara nga zbatimi i bindjeve të pranuar të neo-liberalizmit? Ekziston një perspektivë shumë reale që Evropa e vitit 2020 do të mund të përbëhej nga gjithnjë e më tepër shoqëri të mbyllura dhe demokraci jo-liberale ku pabarazia dhe varfëria lulëzojnë në masë të madhe dhe romët dhe pakicat e tjera të dallueshme vazhdojnë të denigrohen dhe të poshtërohen si viktimat dhe shtresë e ulët. Megjithatë, korniza aludon në një mundësi tjetër: një perspektivë me shanse për sukses të shoqërive që shikojnë përpara dhe që janë plotësisht gjithëpërfshirëse të

cilat e nxitin ndërmjet qytetarëve një ndjenjë të përkatesisë së përbashkët, të kohezionit dhe të respektit reciprok, pavarësisht nga përkatesia e tyre etnike. Për këtë arsye dhe pavarësisht nga paralajmërimet, kornizën duhet ta mirëpresin të gjithë ata që janë të përkushtuar ndaj thellimit të demokracisë. Pa dyshim që korniza është shprehja më e çiltër dhe më e hollësishme e qëllimit nga ana e Komisionit Evropian deri më tani lidhur me përfshirjen e çështjes së romëve. Ndërsa konkluzionet e Këshillit të cilat e miratojnë kornizën, të nxjerra më 19 maj, paraqesin nivelin më të lartë të pranimi politik që integrimi i romëve ka lëvizur nga margjinat drejt rrjedhës së përgjithshme të shqetësimeve të politikave brenda dhe përtej Bashkimit Evropian.

Kërkesa e Komisionit që të gjitha shtetet anëtare të zhvillojnë dhe të zbatojnë strategji të planifikuara dhe të kushtojnë burime të mjaftueshme për përkrahjen e integritit në katër fusha me prioritet siç është ajo e shëndetësisë, e strehimit, e arsimit dhe e punësimit, merr shembull drejtpërdrejt nga Dekada e Përfshirjes së Romëve 2005-15, e filluar nga Fondacionet për Shoqëri të Hapur dhe Banka Botërore. Është shumë inkurajuese perspektiva e një mekanizmi të fuqishëm mbikëqyrës me raportim vjetor nga Komisioni Evropian për të garantuar që do të zbatohen strategjitë, do të arrihet përparim i prekshëm dhe që paratë e dedikuara për integrimin e romëve do të arrijnë tek përfuturit e duhur.

Korniza është e qartë në përkushtimin e saj për t'iu ndihmuar shteteve aspiruese të Evropës Juglindore, në nivel rajonal dhe nacional që t'i rrisin përpjekjet e tyre për

përfshirjen e romëve në tri mënyra: ta përmirësojnë ofrimin e mbështetjes sipas Instrumentit të ndihmës për paraanëtarësim; ta fuqizojnë përfshirjen e shoqërisë civile; dhe ta mbikëqyrin nga afër përparimin e arritur nga secili vend. Përkushtimi i tillë jep shpresë që, për dallim nga valët e mëhershme të zgjerimit të BE-së, çështja e të drejtave të romëve dhe përfshirja e tyre mund të kenë rëndësi dhe që Kriteret e Kopenhagës do të merren para sysh kur është në pyetje çështja e anëtarësimit të shteteve të reja në Bashkimin Evropian.

Ngjashmëritë ndërmjet Dekadës dhe Kornizës janë aq të mëdha sa që është e arsyeshme të sugjerohet që Korniza nuk ka mundur të krijohet pa kontekstin e ofruar nga Dekada që nga viti 2005, kur një duzinë e qeverive nacionale u zotuan ta plotësojnë boshllëkun ndërmjet romëve dhe pjesës tjetër të popullsisë në katër fushat me prioritet, u zotuan ta luftojnë diskriminimin dhe ta përkrahin barazinë gjinore. Pra, ajo që është aprovuar dhe që është ratifikuar zyrtarisht në nivelet më të lartë të BE-së është shenjë e përparimit të Dekadës. Ngjashmëria është e tillë sa që ka mësim të dobishme që duhet të mësohen të cilat mund të kursejnë shumë kohë. Pas pesë vjetëve të kornizës nuk duhet të flasim për boshllëqet lidhur me zbatimin, për mungesën e objektivave real në fushat me prioritet, për buxhetet e papërshtatshme, për mungesën e bashkërendimit ndërmjet ministrive të linjës në lidhje me Strategjitë Nacionale për Integrimin e Romëve. Pas pesë vjetëve të kornizës nuk dëshirojmë që të marrim pjesë në konferenca dhe në punëtori duke vajtuar për mungesën e të dhënave të zërthyer të besueshme, duke

menduar çfarë të bëjmë me bllokimet dhe pengesat lidhur me shfrytëzimin së më të madh të fondeve të BE-së për përfshirjen e romëve. Pas pesë vjetëve të kornizës nuk dëshirojmë të ballafaqohemi me situatën e përqesimit të kushteve të jetesës të miliona romëve që jetojnë në privim akut dhe që paragjykimi kundër-romëve të rritet ende. Për arsye se e kemi kaluar kufirin pesë vjeçar me kornizën dhe aktualisht gjendemi aty.

Kjo nuk bëhet për t'i minimizuar të arriturat e Dekadës të cilat kanë siguruar shabllona të punës lidhur me atë se çka duhet të bëhet për ta arritur integrimin, barazinë, kohezionin shoqëror dhe luftimin e diskriminimit dhe të paragjykimit. Që nga fillimi i Dekadës është nxjerrë një përvijë shumë e madhe dhe një praktikë e mirë e cila duhet të shfrytëzohet në mënyrë që të ketë efektin më të mirë dhe të rritet proporcionalisht. Ndërmjet tani dhe vitit 2020 ekziston nevoja për një mekanizëm bashkërendues që do të jetë i përpjesshëm me detyrat që shfaqen në të ardhmen. Në Komunikatë pranohet që duhet të përfordhet roli i Platformës së BE-së për Romët. Raporti që i drejtohet Komitetit për liritë civile, drejtësinë dhe punët e brendshme është i qartë kur thotë që metoda e hapur e bashkërendimit nuk e ka përmbushur detyrën e përkrahjes së përfshirjes së romëve. Ka pak gjasa që kjo të ndryshojë. Komisioni mund t'i shfrytëzojë më shumë mekanizmat e Dekadës, ta shfrytëzojë kompetencën për mbledhje, strukturat e tij dhe grupin unik të partnerëve, në të cilin përfshihen

agjencitë e Kombeve të Bashkuara, organizatat ndërkombëtare, shoqëria civile dhe qeveritë pjesëmarrëse, për ta mbajtur momentin e duhur për t'u siguruar që kjo Kornizë e BE-së do 'të bëjë ndryshim deri në vitin 2020', moto kjo e Komisionit.

Sfidat përpara janë të vështira. Sipas një raporti të paradokohshëm të Komisionit "shtetet anëtare nuk i shfrytëzojnë si duhet paratë e BE-së për qëllim të integritit shoqëror dhe ekonomik të romëve." Në të thuhej që mungesa e njohurisë dhe e kapacitetit për mënyrën e absorbimit të fondeve të BE-së kombinohet me strategjitë e dobëta të përfshirjes dhe pengesat në nivelin nacional, rajonal dhe lokal. Duhet të lavdërohet qëllimi i deklaruar në komunikatën e kornizës për "kapërcimin e problemeve të kapacitetit" dhe për të punuar me shtetet anëtare për ndryshimin e programeve operative në mënyrë që të trajtohen nevojat e reja, të thjeshtësohet realizimi dhe të përshpejtohet zbatimi i prioritetëve.

Komunikata po ashtu mirëpret me kënaqësi përmendjen e pjesëmarrjes dhe të konsultimit të romëve. Siç ka pohuar Komisioni gjetkë, "cilësia e politikave të BE-së varet nga sigurimi i pjesëmarrjes së gjerë përmes zinxhirit të politikave – nga konceptimi tek zbatimi." E në mënyrë që korniza të jetë e suksesshme, atëherë ajo duhet të sigurojë konsultime kuptimplota dhe të strukturuar dhe ta sigurojë pjesëmarrjen e romëve.

Ka kaluar koha kur romët mund të konsiderohen si popullsi e diskriminuar, pasive dhe e varur. Komisioni duhet të luajë

rol jetik në përkrahjen e pjesëmarrjes substanciale të romëve në këtë proces dhe t'i inkurajojë fuqishëm shtetet anëtare që ta përqafojnë idenë që qytetaria aktive është me rëndësi themelore për përfshirje sociale dhe e përfshinë tërë popullsinë pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike. Komuniteteve dhe përfaqësuesve romë duhet t'u jepet mundësia për të marrë pjesë në formësimin e politikave dhe të nismave të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e tyre.

Është e qartë nga komunikata e kornizës dhe nga konkluzionet e Këshillit që përgjegjësinë primare për të drejtat, mirëqenien dhe sigurinë e të gjithë qytetarëve e mbajnë qeveritë nacionale. Fundi i fundit, kjo është ashtu siç është përpjekur Komisioni të theksojë, një kornizë për strategjitë *nacionale* për integrimin e romëve. Megjithatë, përgjegjësia primare ndryshon nga përgjegjësia e vetme. Aktivistët e shoqërisë civile ka një kohë të gjatë që kanë insistuar që Bashkimi Evropian duhet të luajë një rol jetik në mbrojtjen e të drejtave të pakicave përfshirë romët dhe t'i bashkërendojë përpjekjet e shteteve anëtare për përkrahjen e barazisë dhe zbatimin e politikave për përfshirje efektive shoqërore. Siç ka deklaruar presidenti Barroso në samitin e parë të BE-së për romët më, 'nuk ka hapësirë për qasje të mosndërhyrjes apo të kryerjes së punës si zakonisht.' Korniza, e përkrahur nga konkluzionet e Këshillit ofron një udhërrëfyes për integrimin e romëve deri në vitin 2020. Po ashtu nënvizon pohimin se në mënyrë që të tejkalohet retorika, ashtu që integrimi të bëhet realitet për pakicën më të madhe etnike të Evropës, duhet të ketë pjesëmarrje aktive të vetë romëve. Detyra që gjendet para qeverive lokale është 'që të bëhet një ndryshim i tillë deri në vitin 2020' që do të ketë ndikim të prekshëm në vendbanimet, getot, qytetet dhe fshatrat ku romët rrojnë në kushte të pavarësisë së skajshme dhe përjashtimit.

(Autori është Drejtor i Hulumtimeve dhe Avokimit Nderkombëtarë, Roma Initiatives, Instituti për Shoqëri të Hapur Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë artikull janë të autorit dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht politikën dhe këndvështrimet e OSI-it.)



POLITIKAT E BE-SË PËR PËRFSHIRJEN E ROMËVE

Martin Demirovski



Korrik 2011

Në pesë vjetët e fundit është arritur përparim i madh në zhvillimin e një qasjeje të përbashkët të BE-së për rritjen e përfshirjes së romëve dhe përmirësimin e kushteve shoqëro-ekonomike në komunitetet rome. Megjithatë, ky mision dhe ai i sigurimit të të drejtave të barabarta për romët mbeten të papërfunduar. Ndonëse Korniza e BE-së për bashkërendimin e strategjive nacionale për romët është miratuar nga Këshilli Evropian më 24 qershor, duhet të bëhet edhe më shumë për ta siguruar respektimin e të drejtave të romëve dhe përfshirjen shoqërore në mbarë Evropën. Si mund të lëvizë BE-ja nga një kornizë dhe qasje e përgjithshme tek zbatimi në nivel nacional? Ky dokument i vlerëson zhvillimet e fundit në politikat e BE-së për romët dhe i nxjerr në pah përkushtimet e mëtejshmet cilat nevojiten për të arritur rezultate të qarta.

Zhvillimet e fundit në politikat e BE-së për romët

Parlamenti Evropian ngriti vëmendjen e shtuar lidhur me çështjen e romëve dhe kjo ishte arsyeja kryesore që nxiti Komisionin dhe shtetet anëtare të reagojnë. Gjatë mandatit parlamentar 2004-2009, grupet më të mëdha politike u bashkuan për të drejtat e romëve, e cila gjë përfundoi me një Rezolutë Parlamentare në të cilën kërkohej nga Komisioni dhe Këshilli që ta miratojnë një Strategji Evropiane për Romët.¹ Më 2011 u miratua një rezolutë e ngjashme me rekomandime dhe ambicie politike më konkrete.² Në rezolutën e dytë u përfshinë shtatë fusha me prioritet dhe mbi 30 objektiva për strategjinë për përfshirjen e

romëve. Vëmendja të cilën Parlamenti Evropian ia kushtoi romëve krijoi një moment politik drejt një politike të ardhme të BE-së për romët, edhe pse janë zhvilluar hollësitë dhe mekanika dhe ka pasur kundërshtime ndërmjet Komisionit dhe shteteve anëtare.

Komisioni Evropian ka bërë një hap të rëndësishëm përpara këtë vit me Komunikatën e tij "Korniza e BE-së për strategjitë nacionale për integrimin e romëve deri më 2020".³ Korniza e BE-së është prezantuar në prill 2011, është mirëpritur me konkluzionet e Këshillit në maj dhe është aprovuar nga Këshilli Evropian më 24 qershor.⁴ Korniza është dokumenti më gjithëpërfshirës i politikave të cilin e ka nxjerr Komisioni Evropian deri më tani për përmirësimin e përfshirjes shoqërore të 10-12 milionë evropianëve me origjinë rome. Ai ka për qëllim t'i përkufizojë dhe t'i bashkërendojë obligimet dhe përgjegjësitë e shteteve anëtare të BE-së dhe të vendeve kandidate ndaj popullsisë rome. Në kuadër të kësaj Kornize, Komisioni propozon që shtetet anëtare t'i zhvillojnë strategjitë e tyre nacionale, duke u bazuar në katër synimet kryesore nacionale të integritimit (strehimi, shëndetësia, shkollimi dhe punësimi). Dokumenti po ashtu i shfrytëzon 10 parimet themelore për përfshirjen e romëve⁵ dhe parimet e Dekadës së përfshirjes së romëve.⁶

Më 19 maj 2011, të gjitha 27 shtetet anëtare në **Këshillin** për punësim, politika sociale, shëndetësi dhe çështje të konsumatorëve (**EPSCO**) u pajtuan për një grup të konkluzioneve të cilat e miratojnë Kornizën e BE-së për bashkërendimin e strategjive nacionale për romët.⁷ Kjo marrëveshje ishte posaçërisht

inkurajuese kur e kemi parasysh kontekstin e diskutimeve përçarëse ndërmjet shteteve evropiane perëndimore dhe lindore lidhur me atë se kush ka përgjegjësi për politikat për romët dhe çfarë kompetencash ka BE-ja për formulimin e një agjende të përbashkët.

EPSCO mbështeti konceptin e strategjive nacionale për romët duke mundësuar ca fleksibilitet që vendet ta krijojnë grupin e tyre të masave të politikave rreth katër synimeve për integrim dhe të lidhura me programet nacionale për reforma si pjesë e Strategjisë 2020 të BE-së për "ritje të shpejtë, të qëndrueshme dhe përfshirëse". Konkluzionet i obligojnë shtetet anëtare ta "përmirësojnë zbatimin dhe ta fuqizojnë efikasitetin e fondeve të BE-së" dhe ta shfrytëzojnë më mirë ndihmën teknike. Ato janë shumë më të guximshme në përfshirjen e romëve në proceset vendimmarrëse se sa Korniza dhe përqendrohen shumë në dhënien e mundësisë romëve të marrin pjesë në

¹ <http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?type=MOTION&reference=P6-RC-2008-0050&language=EN>.

² <http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-//EP//TEXT+TA+P7-TA-2011-0092+0+DOC+XML+V0//EN>.

³ "Një Kornizë e BE-së për strategjitë nacionale për integrimin e romëve deri më 2020", COM(2011) 173, Bruksel, 5.4.2011, <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2011:0173:FIN:EN:PDF>.

⁴ Konkluzionet e Këshillit Evropian, 24 qershor 2011, http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/ec/123075.pdf.

⁵ 10 parimet e përbashkëta themelore: 1. Politikat konstruktive, pragmatike dhe jo-diskriminuese; 2. Qëllimi i hollësishëm por jo ekskluziv; 3. Qasja ndërkulturore; 4. Të synuarit e përfshirjes; 5. Vetëdijësimi për dimensionin gjinor; 6. Transferimi i politikave të bazuara në dëshmi; 7. Shfrytëzimi i instrumenteve të komunitetit; 8. Përfshirja e autoriteteve rajonale dhe lokale; 9. Përfshirja e shoqërisë civile; 10. Pjesëmarrja aktive e romëve. <http://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=761&langId=en>.

⁶ <http://www.romadecade.org>. Këshilli për punësim, politika shoqërore, shëndetësi dhe çështje të konsumatorëve (EPSCO) përbëhet nga ministra të punësimit, të mbrojtjes sociale, të mbrojtjes së konsumatorëve, të shëndetësisë dhe të mundësive të barabarta, të cilët takohen rreth katër herë në vit. Konkluzionet e majit 2011 mund t'i gjeni si vijon: http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_Data/docs/pressdata/en/lsa/122100.pdf.

⁷ Korniza e BE-së, COM(2011) 173.

diskutimin e politikave dhe në zbatimin e tyre. EPSCO e ftoi Komisionin "të ushtrojë mbikëqyrje rigoroze të zbatimit të Urdhërësës së Këshillit 2000/43/EC", ndoshta instrumentit më të fuqishëm të BE-së për luftimin e diskriminimit për shkak të prejardhjes etnike. EPSCO po ashtu nënvizoi nevojën për ta intensifikuar luftën kundër trafikimit të romëve dhe për t'i garantuar të drejtat ligjore të romëve që janë viktimë të trafikimit.

Konkluzionet e 24 qershorit nga **Këshilli për çështje të përgjithshme** paraqesin hapin e fundit në shkallën e krijimit të konsensusit në nivel të BE-së lidhur me çështjet të cilat së pari janë ngritur nga organizatat e shoqërisë civile me parlamentarët evropianë në fillim të 2000-ve (dhe më parë). Konkluzionet pranojnë rëndësinë e përfshirjes së romëve në nivel të BE-së dhe ftojnë për zbatim të shpejtë të konkluzioneve të Këshillit (EPSCO) të datës 19 maj 2011 mbi Kornizën e BE-së. Konkluzionet e EPSCO dhe vetë Korniza japin hollësi lidhur me qasjen e BE-së ndaj romëve por teksti përfundimtar i Këshillit i qershorit përcakton një afat të fundit për "përgatitjen, përditësimin ose zhvillimin e strategjive nacionale të përfshirjes", ose për "grupe të integruara të masave të politikave në kuadër të politikave të tyre më të gjera për përfshirje shoqërore", deri në fund të vitit 2011. Ndonëse ka hapësirë për ndryshime të politikave në qasjet nacionale, së paku ekziston një datë e caktuar për përparimin lidhur me strategjitë.

Një kornizë e re dhe e mirëpritur e politikave

Komunikata e Kornizës paraqet një ndryshim të rëndësishëm të qasjes së BE-së ndaj politikave për romët. Deri tani Komisioni ka pohuar që zgjidhjet për romët duhet të gjenden në zbatimin më të mirë të politikave ekzistuese përfshirëse, madje edhe nëse ato politika janë zhvilluar pa i marrë parasysh gjërat specifike të gjendjes së romëve. Pranimi se qasja e planifikuar për romët nuk e minon "strategjinë më të gjerë kundër varfërisë dhe përjashtimit" ose "nuk i përjashton grupet e tjera të cënueshme dhe të privuara nga mbështetja" dhe "është në pajtueshmëri me parimin e mosdiskriminimit si në nivelin e BE-së po ashtu



edhe në atë nacional" e ka mundësuar pjesën më të madhe të zhvillimi të fundit të politikave.⁸

- **Mbikëqyrja:** Njëri prej propozimeve më të vlefshme që e paraqiti Komisioni në Kornizën e BE-së është ajo që ai e quan "një mekanizëm i fuqishëm mbikëqyrës" i cili do ta bëjë matjen e përparimit individual të secilit shtet anëtar. Rezultatet, si të mirat ashtu edhe të këqijat, lidhur me zbatimin e strategjisë nacionale për romët do t'i raportohen Komisionit dhe më vonë Këshillit dhe Parlamentit Evropian. Kjo thirrje për mbikëqyrje të fuqishme duhet të konsiderohet si mundësi unike për shpërndarjen e rregullave për përfshirjen e duhur të romëve, për mësimin nga kritikët dhe iu shërben shteteve anëtare për ta ndarë praktikën më të mirë. Megjithatë, mënyrat e mbikëqyrjes ka mundësi të jenë të komplikuar. Për këtë do të nevojitet një kontribut i përzier nga Agjencia për të Drejtat Themelore (ADTH) së bashku me "organet e tjera relevante", duke e përfshirë në mes tjerash, Fondacionin evropian për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të atyre të punës, mekanizmat mbikëqyrës të vetë shteteve anëtare dhe procesin e mbikëqyrjes dhe të shqyrtimit të barabartë të Strategjisë 2020 të BE-së. Roli i ADTH që të punojë me shtetet anëtare për të zhvilluar metoda mbikëqyrëse të cilat prodhojnë të dhëna krahasuese do të jetë me rëndësi vendimtare për tërë qasjen evropiane.

- **Zgjerimi:** Anëtarësimi i Ballkanit Perëndimor dhe i Turqisë në BE do të sillte

edhe 3.8 milionë romë të tjerë në BE. Komisioni që një kohë të gjatë e ka nënvizuar përmirësimin e trajtimit të romëve në këto vende si kusht kryesor politik për zgjerim dhe jep fonde të konsiderueshme për barazinë dhe përfshirjen e romëve përmes Instrumentit të tij për para-anëtarësim (IPA). Komisioni ka njoftuar se do ta përmirësojë dhe do ta bashkërendojë më mirë shfrytëzimin e fondeve të IPA-s për romët dhe do t'i orientojë fondet drejt politikave më strategjike të orientuara drejt rezultateve.⁹ Pajoja e Zgjerimit 2010-2011 nga Komisioni (në të cilën vlerësohet përparimi i vendeve kandidate dhe të atyre që janë kandidate potenciale për anëtarësim) ka nënvizuar rrezikun e shtuar ndaj romëve si "një pakicë posaçërisht e cënueshme" nga ndikimet e krizës ekonomike. Zgjerimi DG, që e zëvendëson dokumentin e Kornizës, i ka inkurajuar vendet e zgjerimit që të punojnë në zvogëlimin e varfërisë dhe të përjashtimit shoqëror, në harmoni me Strategjinë 2020 të Evropës, dhe ta shfrytëzojnë Dekadën e përfshirjes së romëve, dhe iu rekomandoi këtyre vendeve që të marrin parasysh "caktimin e objektivave të qartë për punësimin, shkollimin dhe zvogëlimin e varfërisë të komuniteteve të dëmtuara, në veçanti të romëve."¹⁰ Faktikisht, BE-ja iu ka ofruar

⁸ Korniza e BE-së, po aty.

⁹ Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2010-2011, Bruksel, 9.11. 2010 COM(2010) 660: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/strategy_paper_2010_en.pdf.

¹⁰ <http://europa.eu/rapid/pressReleasesAction.do?reference=IP/10/1097&format=HTML&aged=1&language=EN&guiLanguage=fr>.



vendeve të zgjerimit një rast që t'i lënë pas shtetet anëtare në trajtimin dhe përfshirjen e romëve.

• **Grupi punues për romët:** Grupi punues për romët i Komisionit Evropian është themeluar për ta shqyrtuar mënyrën e përmirësimit të shpenzimit të fondeve të BE-së. Në fund të dhjetorit 2010, grupi punues e publikoi një studim lidhur me shfrytëzimin e fondeve të BE-së për përfshirjen e romëve.¹¹ Në studim tregohet që shtetet anëtare ende nuk i shfrytëzojnë si duhet paratë e BE-së për qëllim të integritimit efektiv shoqëror dhe ekonomik të romëve dhe arsytet për këtë mund të ishin mungesa e njohurisë dhe e kapacitetit administrativ për tërheqjen e fondeve të BE-së. Në studim po ashtu identifikoheshin problemet lidhur me ofrimin e bashkëfinancimit nacional dhe vullneti i pamjaftueshëm politik në disa shtete anëtare. Prandaj, Korniza e BE-së i pasqyroi rezultatet e grupit punues, duke rekomanduar që fondet e BE-së për përfshirjen e romëve të shfrytëzoheshin më mirë dhe në mënyrë më efikase nga shtetet anëtare gjatë periudhës aktuale të planifikimit dhe asaj të ardhmes. Grupi punues tani do të bëhet organ i përhershëm i brendshëm për diskutime të përqendruara ndërmjet drejtorëve në

Drejtoritë përkatëse të përgjithshme të Komisionit.¹²

Elementi që mungon: kundër-diskriminimi

Komunikata e Kornizës së BE-së ka qëllim të qartë që ta drejtojë përfshirjen shoqërore dhe asaj i mungon elementi kryesor i luftimit të paragjykitimit dhe të sjelljes diskriminuese ndaj romëve. Qëllimet e mira në nivel të BE-së nuk janë as për së afërmi të harmonizuara me politikën dhe deklaratat individuale në shtetet anëtare. Evropa vuan nga ndjenja e rënjosur thellë kundër romëve. "Kundër-Gabelizmi" është i dukshëm në një numër të shteteve anëtare përmes medieve, politikave shtetërore dhe sjelljes së qytetarëve individualë – që nga dëbimet me dhunë dhe spastrimet e kampeve në baza etnike, deklaratat raciste, gjuha e urrejtjes dhe nxitja e dhunës.¹³

Dhuna racore shpesh ushtrohet nga anëtarët e grupeve ekstremiste, të cilat nganjëherë mbrohen politikisht nga politikanët e rrymave qendrore. Një jo-tolerancë në rritje po ashtu mund të shihet në veprimet e disa qeverive. Është me rëndësi thelbësore që Komisioni të ndërmarrë veprime të shpejta dhe të qarta ndaj sjelljes së tillë të shteteve anëtare.

Instrumentet dhe masat ekzistuese ligjore në nivel të BE-së kanë mundur të futen në listën e komunikatës së Komisionit për t'ua përkujtuar shteteve anëtare që përfshirja dhe respektimi i romëve shkojnë paralel me luftën kundër diskriminimit. Një përqendrim më i fuqishëm në elementet legjislative dhe në politikën kundër-diskriminimit dhe nevoja për zbatim më të mirë në nivel nacional do ta bënin Kornizën e BE-së një dokument më të plotë. Fatmirësisht, konkluzionet e EPSCO-s lidhur me komunikatën e bëjnë një hap drejt kësaj duke kërkuar nga Komisioni që të ushtrojë mbikëqyrje të rreptë të zbatimit të Urdhërësës së Këshillit 2000/43/EC.¹⁴ Romët e cënueshëm në Evropë llogarisin në Komisionin që ai të jetë aktiv në thirrjen e shteteve anëtare për shpjegime kur qeveritë e shkelin ligjin e BE-së gjatë diskriminimit të romëve.

¹¹ Kjo përfshin Drejtorinë e përgjithshme për drejtësi, të drejta themelore dhe shtetësi; Punësim; Çështje të brendshme; Arsim, Kulturë, Shumë-gjuhësi dhe Rini; Politika rajonale; Kërkim, Zbulim dhe Shkencë; Bujqësi dhe zhvillim rural; Shëndetësi dhe politika të konsumatorit; Planifikim financiar dhe buxhet; Politika të zgjerimit dhe të fqinjësisë evropiane; dhe zyrën e sekretarit të përgjithshëm të Komisionit Evropian).

¹² Për shembuj, shih: <http://www.romadecade.org/files/downloads/News/CSCE%20Presentation%20-%20Stanislav%20Daniel.pdf>.

¹³ <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32000L0043:en:HTML>

¹⁴ http://siteresources.worldbank.org/INTRROMA/Resources/Po-licy_Note_Fact_Sheet.pdf.

Fushat kryesore në të cilat nevojitet angazhimi i mëtijshëm i shteteve anëtare

• **Shkollimi i romëve:** Arsimi është njëri prej elementeve më thelbësore në Kornizën e BE-së. Qëllimi i caktuar nga Komisioni lidhur me arsimin (për të siguruar që të gjithë fëmijët romë e kryejnë së paku shkollën fillore) fton për mundësinë e shfrytëzimit të shkollimit cilësor pa diskriminim ose ndarje; përfundim të shkollimit fillor; mundësi të shkollimit dhe kujdesit cilësor në fëmijërinë e hershme; një numër më të vogël të atyre që e braktisin shkollimin e mesëm herët dhe një inkurajim të fuqishëm për romët e rinj që të marrin pjesë në shkollimin e mesëm dhe të lartë. Këto janë elemente të rëndësishme por sidoqoftë qëllimit i mungon ambicia. Nëse BE-ja arrin që të gjithë fëmijët romë ta përfundojnë shkollimin e përgjithshëm fillor deri më 2020, prapë se prapë ata do të mbeten pesë vjet pas popujve në zhvillim të cilët përpiqen t'i plotësojnë Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit të caktuara për vitin 2015. Në mënyrë më specifike, Korniza e BE-së e humb shansin që të bëjë thirrje për eliminimin jo vetëm të ndarjes në shkolla por edhe të vendosjes së papërshtatshme të fëmijëve romë në shkolla të posaçme, të ndihmojë në zvogëlimin e boshllëkut në arritjen arsimore ndërmjet romëve dhe qytetarëve të tjerë të BE-së në nivelin e mesëm dhe të lartë. Përkrahja e diplomimit të romëve në nivel universitar është me rëndësi kryesore për fuqizimin e romëve. Nëse kanë shkollim të mirë të rinjtë romë do të jenë në pozitë shumë më efektive që ta arrijnë përfshirjen shoqërore.

• **Pjesëmarrja e romëve:** Pjesëmarrja aktive e romëve në formësimin e politikave për romët dhe në zbatimin e tyre ka mundur të shënohet në Kornizë si qëllimi i pestë për integrim. Politikat për romët nuk mund të zhvillohen larg nga komunitetet të cilat ato synojnë t'i ndihmojnë. Pjesëmarrja e konsiderueshme e profesionistëve romë në formulimin dhe në zbatimin e politikave për romët është me rëndësi thelbësore për suksesin e tyre, për ta ushqyer një ndjenjë të pronësisë dhe të përgjegjësisë. Për fat të mirë, në konkluzionet e EPSCO-s është përfshirë ky element thelbësor. Përfshirja nuk është e

mundur pa pjesëmarrje.

• **Mbikëqyrja efektive:** Ndonëse mbikëqyrja e fuqishme është përvijuar në Kornizë, ende duhet të zhvillohen edhe më tej mekanizmat për sigurimin e saj. Elementi i domosdoshëm është një sistem mbikëqyrës i cili e tregon në hollësi përparimin, turpëron ata që nuk kanë arritur sa duhet dhe përkrahë praktikën e mira. BE-ja do të mund të mësonte nga metodologjitë të cilat tashmë janë shfrytëzuar nga Mbikëqyrja e Dekadës, i cili është një instrument mbikëqyrës i zhvilluar për ta ndjekur përparimin në Dekadën e përfshirjes së romëve. Kjo iu ka ndihmuar vendeve anëtare të Dekadës duke i nënvizuar të arriturat e tyre dhe duke treguar për cilat gjëra nevojitet më tepër vëmendje.

Mbikëqyrja efektive do të ishte më e lehtë po të ishte më i qartë roli i institucioneve kontaktuese nacionale për romët. Sipas Kornizës së BE-së këto institucione kontaktuese kanë rol bashkërendues dhe zhvillimor por konkluzionet e EPSCO-s përmendin vetëm rolin mbikëqyrës. Zgjidhja do të ishte që një komision tjetër i pavarur ta bëjë vlerësimin. Në bazë të përvojës së disa vendeve të Evropës Lindore nëse i njëjti organ e bën zbatimin, mbikëqyrjen dhe zhvillimin e politikave, është e mundshme që kjo të ketë si rezultat zbatimin e dobët të politikave.

Konkluzion: Faktori politik

Secili komunitet rom përkufizohet nga konteksti i tij vendor, sidomos nivelet e vijueshmërisë së shkollimit, përfshirja shoqërore, standardet e jetesës dhe punësimi. Standardet, ligjet dhe kompetencat të cilat nevojiten për t'i kundërshtuar këto realitete vendase gjenden në nivelin lokal, nacional dhe evropian, por çelës për ndryshimin efektiv është vullneti politik. Strategjive të shteteve anëtare për romët ende iu mbetet ta mbushin boshllëkun ndërmjet marrëveshjeve për politikën në Bruksel dhe zbatimin e tyre në shtetet anëtare. Në Kornizën e Komisionit citohen shifrat e Bankës Botërore të cilat tregojnë sa iu kushton shteteve anëtare përjashtimi i romëve.¹⁵ Në disa raste përfshirja do të mund ta rriste bruto prodhimin vendor (GDP) nacional edhe për 4%, ose sa i

përket përfitimit nga tatimi romët do të mund të kontribuonin edhe me 175 milionë euro për vend. EPSCO përsëri nënvizoi "koston ekonomike për shoqërinë si tërësi, duke përfshirë shpërdorimin e kapitalit njerëzor dhe humbjen e prodhueshmërisë".¹⁶ Krahës kësaj, BE-ja po i inkurajon shtetet anëtare t'i shfrytëzojnë fondet e BE-së dhe ndihmën teknike për t'iu ndihmuar atyre të merren me problemet e romëve. Përfitimet ekonomike, në vend të kundërshtimit të përjashtimit shoqëror, varfërisë dhe paragjykit, mund të jenë motivim efektiv. Nëse hartuesit nacionalë të politikave, parlamentarët dhe qytetarët e kuptojnë që përfshirja e romëve çon deri te të hyrat shtesë në buxhetet e shtrënguara nacionale duke i shfrytëzuar fondet shtesë të BE-së dhe duke i përmirësuar tregjet e punës, (si edhe duke e zvogëluar varfërinë dhe përjashtimin shoqëror), shtohen gjasat që deklaratat politike në nivel të BE-së të shndërrohen në strategji nacionale efektive dhe të zbatuara mirë. Ngjashëm, nëse papajteshmëria lidhur me përfshirjen nuk mund të arsyetohet më me shpenzimet financiare, ajo duhet të mbrohet nga akuzat për diskriminim të qëllimshëm. Rezolutat e Parlamentit, Korniza e Komisionit, konkluzionet e EPSCO-s dhe të Këshillit Evropian së bashku paraqesin një grup të mirë të rekomandimeve për politikën për shtetet anëtare që ta luftojnë përjashtimin e romëve. Këto baza të politikave tani kërkojnë veprim të fuqishëm nga shtetet anëtare deri sa ato janë duke i përgatitur, përditësuar apo zhvilluar strategjitë e tyre. Për ta çuar përpara këtë proces do të nevojiten burime të shtuara njerëzore dhe financiare, presion politik për zbatim efektiv dhe një reagim i qartë i Komisionit nëse zotimet nuk përmbushen.

(Martin Demirovski, Personi kontaktues për çështjet e romëve në OSI-Bruksel Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë artikull janë të autorit dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht politikën dhe këndvështrimet e OSI-it.)

¹⁵ Konkluzionet e EPSCO, po aty.

KORNIZA E BE-SË PËR
STRATEGJITË NACIONALE
PËR INTEGRIMIN E
ROMËVE – NJË MUNDËSI
PËR RIORGANIZIMIN
E PËRPPJEKJEVE NË
BALLKANIN PERËNDIMOR
DHE PËR TA TRASUAR
RRUGËN PËRPARA
Blerinda Idrizi



Para njëzet vjetëve, Václav Havel në simpoziumin e dytë të vitit 1991 për "Pakicat në politikë" në Bratisllavë, Sllovaki, tha: "Ndryshimet themelore të cilat ndodhën pas rënies së të gjitha sistemeve totalitare – liria e shtypit, liria e të shprehurit, arsimi, mendimi, liria e ushtrimit të fesë, të gjitha këto liri civile e hapin rrugën për grupe të ndryshme etnike, pakica nacionale dhe grupe nacionale në mënyrë që këto grupe të fillojnë ta krijojnë pavarësinë e tyre në mënyrë të caktuar të natyrshme dhe të krijojnë raportet e tyre vetjake reciproke jo artificiale dhe të kontrolluara. Në fillim të pjesës përkatëse të dokumentit të Kopenhagës të procesit të Helsinkit jepet një ide e rëndësishme, domethënë fakti që pakicat mund t'i gjejnë të drejtat e tyre dhe t'i realizojnë ato më së miri në një mjedis demokratik, në kushte demokratike ku institucionet demokratike dhe juridiksioni i pavarur funksionojnë si duhet, ku kompetencat ekzekutive, legjislativë dhe gjyqësore janë të ndara, ku lejohet liria e të shprehurit."

Njëzet vjet më vonë, Komisioni i BE-së ka filluar një nismë të re, Kornizën e BE-së për Strategjitë nacionale për integrimin e romëve, si mjet "...për plotësimin dhe fuqizimin e legjislativës dhe të politikave të BE-së për barazi duke i trajtuar nevojat specifike të romëve lidhur me mundësinë e barabartë për punësim, shkollim, strehim dhe kujdes shëndetësor, në nivel nacional, rajonal dhe lokal por po ashtu edhe përmes dialogut dhe pjesëmarrjes së romëve." ¹

Rënia e murit të Berlinit na dha shpresë

që shekulli 21 do të jetë shekull i shpresës, i të ardhmes më të mirë, përparimit, bashkëpunimit, demokracisë, humanizmit, bashkëjetesës dhe respektimit të diversitetit dhe multikulturalizmit. Megjithatë, në dy dekadat e kaluara kemi mësuar se pavarësisht sa të vështira duken dhe mund të jenë këto parime, pavarësisht sa dëshirë e zjarrtë mund të ekzistojë në ne për të gjitha këto, pavarësisht sa korniza për politika dhe konventa ndërkombëtare janë hartuar, ende nuk është realizuar përkushtimi i shprehur politik dhe aktiviteti udhëheqës i aktorëve të të drejtave të njeriut, rruga drejt tolerancës dhe pranimi për ta mirëpritur "të huajin" në mesin tonë. Muret e paragjykitimit dhe të keqkuptimit ende mbeten të larta, komuniteti rom ende mbetet i padëshiruar dhe mbahet në margjinat të shoqërisë.

Nisma e re e BE-së, ndonëse detyruese për shtetet anëtare të BE-së, nuk i përjashton vendet e zgjerimit (Ballkani Perëndimor dhe Turqinë) dhe do të jetë pjesë e agjendës së zgjerimit të Komisionit Evropian në dialogun e tij me këto vende, ashtu siç thuhet në dokument: "Qëllimet e BE-së për integrimin e romëve vlejnë njëlloj për këto vende. Strategjitë e tyre për integrimin e romëve dhe planet e veprimit (të zhvilluara në shumicën e rasteve në kornizën e Dekadës për përfshirjen e romëve 2005-2015) duhet të shqyrtohen në pajtim me këto qëllime." ² Më tej në dokument thuhet që do të mbështeten përpjekjet e këtyre vendeve përmes Instrumentit për ndihmë para anëtarësimit, me fjalë të tjera duke vënë

në dispozicion fonde shtesë për t'i mundësuar dhe për t'i plotësuar përpjekjet e qeverive dhe të OJQ-ve vendase dhe ndërkombëtare në vendet e zgjerimit të cilat punojnë për çështjet e romëve.

Megjithatë, mbetet e paqartë dhe e diskutueshme çështja nëse kjo nismë e re do ta përmirësojë gjendjen e romëve në këto vende dhe do të orientohet drejt ndryshimeve të planifikuara të cilat konsiderohen të domosdoshme nga Korniza. Dokumenti i Kornizës, në mënyrë të lëvdueshme, i ka vlerësuar dhe i ka shfrytëzuar disa prej mësimave kryesore të mësuara gjatë nismës së Dekadës për romët dhe nga të arriturat dhe dështimet e nxjerra nga raundi i parë i strategjive nacionale dhe i planeve të veprimit. Në mënyrë specifike, dokumenti i Kornizës i identifikon sektorët me prioritet, të cilët kanë nevojë për intervenim, siç është *shkollimi, punësimi, strehimi dhe shëndetësia*, kërkon hartim të politikave nacionale, krijimin e sistemit të mbikëqyrjes të organeve të bashkërendimit dhe ndarjen e buxheteve të mjaftueshme dhe sistemet pro-aktive për mbledhjen e të dhënave si në nivel vendi po ashtu edhe në atë të BE-së dhe po ashtu i veçon në mënyrë të qartë mekanizmat dhe institucionet e BE-së për financim të cilat do të luajnë dhe kryejnë role dhe përgjegjësi specifike.

¹ KOMUNIKATË E KOMISIONIT PËR PARLAMENTIN EVROPIAN, KËSHILLIN, KOMITETIN EVROPIAN EKONOMIK DHE SHOQËROR DHE PËR KOMITETIN E RAJONEVE, Një Kornizë e BE-së për Strategjitë nacionale për integrimin e romëve deri më 2020, f. 4, (Bruksel, 5.04.2011).

² Po aty, f. 11-12.



Ndonëse është një nismë për lëvdatë, për vendet e Ballkanit Perëndimor të cilat kërkojnë t'i bashkohen familjes së BE-së, kjo nismë rrezikon të mbetet e udhëhequr nga donatorët, një kërkesë e jashtme që mund të ndodhë se do ta përjetojë fenomenin e njëjtë si edhe 10 vendet që hynë në BE më 2007, ku strategjia për integrimin e romëve u bënë një praktikë e mbylljes së kësaj çështjeje, më tepër një proces kuptimplotë vetanak i vendit, i qëndrueshëm dhe i vazhdueshëm. Për ta tejkaluar këtë përvijë të pakëndshme, Bashkimi Evropian dhe institucionet e tij janë shumë të vendosur që ta ushtrojnë presionin dhe peshën e tyre mbi subjektet politike dhe institucionet shtetërore të këtyre vendeve dhe t'i shfrytëzojnë mekanizmat dhe instrumentet e tyre të asistencës në mënyrë përgjegjëse ndaj realiteteve komplekse të këtyre vendeve që nuk mendojnë vetëm në parashikueshmërinë, vlerën për qasjen në para dhe detyrat e planifikimit por që i marrin parasysh edhe dimensionet shoqëro-etnike dhe kulturore të komunitetit rom dhe të kontekstit në të cilin jetojnë ata. Në radhë të parë, sa i përket çështjet së pronësisë, institucionet e BE-së duhet ta ngritin çështjen me partitë politike në

Ballkanin Perëndimor, si me ato që janë në pushtet ashtu edhe me ato që janë në opozitë. Partitë politike në këto vende kanë dështuar në mënyrë të konsiderueshme në konsiderimin e komunitetit rom si zgjedhës të tyre të mundshëm dhe të krijojnë hapësirë për pjesëmarrjen e tyre dhe të kontribuojnë konkretisht drejt rritjes së pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të tyre përmes qasjes dhe mundësive të barabarta në sistemin politik. Në vend të bërjes së fotografive dhe organizimit të aktiviteteve vetëm një herë, partitë politike duhet t'i tejkalojnë veprimet e tyre të personallizuara dhe reaguese ndaj klientelës së tyre dhe të gjejnë mënyrë efektive për udhëheqjen e "politikës me zhvillim" dhe ta pranojnë varfërinë dhe përfshirjen shoqërore të pakicave romë si qëllim politik; si pasojë, të mos e vënë në dyshim efikasitetin dhe legjitimitetin e institucioneve shtetërore.

BE-ja gëzon pozitë të rëndësishme strategjike të ndikimit global, fuqi ekonomike dhe autoritetin politik të 25 shteteve të saj anëtare, që ka shumë ndikim në shtetet që kërkojnë lidhje me të ngushta me të apo që të bëhen pjesë e saj. Pozita e tillë e fuqisë do të mbetet e fortë dhe e papërkulur në përkrahjen

e të drejtave të romëve, të mos-diskriminimit dhe barazisë efektive në planifikimin e saj dhe në dialogun me vendet e Ballkanit Perëndimor si pjesë e plotësimit të standardeve dhe e respektimit të parimeve të agjendës së zgjerimit.

Duke qenë në pozitën e njërit prej donatorëve më të mëdhenj multilateral në këtë hapësirë gjeo-politike, BE-ja duhet ta marrë parasysh luajtjen e një roli aktiv në organet bashkërenduese brenda vendit, të përbëra nga shumë aktorë, lidhur me zbatimin e strategjive nacionale ose të planeve të veprimit për integrimin e romëve. Në rastet ku organi (organet) e tilla bashkërenduese të përbëra nga shumë aktorë mungojnë, BE-ja duhet ta inkurajojë formimin e të njëjtave, të cilat do t'i përfshijnë institucionet shtetërore, përfaqësuesit e OJQ-ve/komunitetit rom, donatorët kryesorë etj., por që nuk do të kufizohet vetëm në to. Pjesëmarrja në këto organe do ta lehtësojë mundësinë për të ushtruar ndikim pro-aktiv në zbatimin e strategjive nacionale, që nga përkrahja e parimeve për përfshirje, fuqizimi, përfaqësimi, pjesëmarrja dhe përgjegjësia për ndarjen e mjaftueshme të burimeve, propozimi i të drejtave duke u bazuar në qasjen e politikave,



bashkërendimi i donatorëve, përfshirja e çështjeve të romëve.

Në vendet e Ballkanit Perëndimor ndonëse kuota e ndihmës zyrtare për zhvillim ka qenë e paqëndrueshme dhe ka qenë më masë të madhe e varur nga situata e paqëndrueshme politike dhe vargu i konflikteve etnike që kanë ndodhur atje në njëzet vjetët e fundit, duhet theksuar që këto kuota ende mbesin substanciale. Prej vitit 2007 BE-ja e ka zbatuar Instrumentin e ndihmës para anëtarësimit si mekanizmin e saj kryesor për mbështetjen e vendeve të angazhuara në procesin e hyrjes në Bashkimin Evropian, "ai ka për qëllim rritjen e efikasitetit dhe të koherencës së ndihmës me anë të një kornize të vetme."³ Duke e shfrytëzuar përvojën e fituar përmes zbatimit të Instrumentit për para anëtarësim, në vendet ku bashkërendimi i donatorëve mbetet i dobët, përmes delegacionit të saj në atë vend dhe takimeve të herëpashershme me agjencitë bilaterale të ndihmës dhe përfaqësuesit diplomatik të shteteve anëtare të saj, BE-ja do të merret me çështjen e bashkërendimit të ndarjes së fondeve për programet për integrimin e romëve. Si kundërshtpërblim, ndarja e informatave dhe bashkërendimi më i

mirë ka shpresa se do të shndërrohet në efikasitet dhe në vazhdimësi të shpërndarjes së ndihmave.

Zbatimi i Kornizës së BE-së do të bëhet brenda një periudhe dhjetë vjeçare. Në një mjedis ku dallimet kanë çuar drejt viktimizimit dhe përjashtimit më parë se pranimit dhe respektimit të diversitetit, vetëm proceset e gjata do ta lehtësojnë krijimin e besimit, do t'i përforcojnë vlerat e përbashkëta dhe do ta shtojnë dinjitetin e të gjithëve. Në lidhje me këtë nismë dhe zbatimin e saj të suksesshëm do të merren parasysh disa aspekte të planifikimit. Për shembull, makro dhe mikro projektet luajnë rol të ndryshëm dhe arrijnë rezultate të ndryshme. Makro projektet kanë vlerë posaçërisht të madhe nëse nismat e tilla ndërmerren me qëllim që të ndryshohen qëndrimet, të luftohet diskriminimi institucional dhe të nxiten politikat dhe praktikatat që e ndryshojnë jetën. Në ndërkohë, mikro-projektet bëhen të rëndësishme për t'u marrë me nevojat e atyre që vazhdojnë të mbesin të padukshëm dhe trajtimin e tyre dhe me trajtimin e aspekteve që paraqesin mundësi për përmirësimin e jetës dhe bërjen e ndryshimeve. Kombinimet e të dy llojeve të projekteve, afatgjate dhe

me një vazhdim të duhur, që i nënvizojnë metodologjitë pjesëmarrëse dhe çështjet e fuqizimit, të cilat janë të vlerësuara mirë dhe të mbikëqyrura nga afër, të cilat merren me çështjet gjinore dhe të drejtat e fëmijëve, ku qasja e bazuar në të drejta mbetet parimi kryesor më parë se ofrimi i shërbimit dhe mbetet fleksibil ndaj ndryshimit të rrethanave dhe ku kompleksiteti ndër-etnik kuptohet mirë, është dëshmuar se japin rezultate të qëndrueshme që kanë jetë të gjatë. Kombinimi i tillë duhet të kërkohet dhe të mbështetet plotësisht. Dhjetë vjet mund të mos jenë shumë për të ndryshuar çdo gjë dhe për të përmirësuar atë që është bërë gabim me shekuj dhe si qenie njerëzore ne nuk kemi shkop magjik për ta bërë këtë, por gjithmonë ka diçka magjike të cilën e kanë njerëzit e ajo është gatishmëria! Ajo gatishmëri mund ta hapë dhe ta trasojë rrugën e ndryshimit dhe t'i mirëpresë "të huajt e sotëm në mesin tonë" si qenie njerëzore ashtu sikur do të jemi ne në të ardhmen.

(Autorja është konsulente për politika publike)

³ Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA), http://europa.eu/legislation_summaries/agriculture/enlargement/e500_20_en.htm

ANTI-CIGANIZMI: PARAGJYKIMI QË E NXJERR PROGRESIN NGA BINARËT

Bernard Rorke



Anti-ciganizmi është i rrënjësuar aq thellë në tërë Evropën, paragjykimi dhe jotoleranca ndaj romëve është aq i përhapur sa asnjë strategji kombëtare për integrim nuk mund të ketë sukses pa veprim të vendosur dhe të qartë për luftimin e racizmit dhe diskriminimit. Shkalla e diskriminimit dhe përjashtimit që e përjetojnë romët, pakica etnike më e madhe në Evropë, është paraqitur qartë në rezultatet e EU-MIDIS Hulumtimit mbi Pakicat dhe Diskriminimin në Bashkimin Evropian në vitin 2009. Raporti gjeti se mesatarisht, në nëntë fushat e jetës së përditshme, romët diskriminohen për shkak të përkatësisë etnike më shumë se çdo grup tjetër që ishte pjesë e hulumtimit EU-MIDIS, si afrikanët e subsaharës apo afrikanët veriorë. Çdo i dyti rom i pyetur tha se është diskriminuar në bazë të etnisë së paku një herë gjatë 12 muajve paraprak.¹

Nuk ka asgjë të re për anti-ciganizmin: ai është alotropik dhe i ndryshueshëm si shumica e formave të paragjykimit, e nuk është statik as në lidhje me përmbajtjen e tij. Në shtete të ndryshme paragjykimi ndaj romëve është më pak apo më shumë i përhapur, më pak apo më shumë i dukshëm, manifestohet në shkallë të ndryshme dhe në forma shumë specifike direkte apo indirekte ndaj romëve dhe e ka zanafillën në rrjedhat dhe vorbullat e zhvillimeve më të gjera politike. Mu vërejtja parashikuese e Presidentit çek Vaclav Havel në Lety, në vendin ku dikur gjendje kampi i koncentrimit në vitin 1995, gjatë zbulimit të monumentit për kujtimor për viktimat rome të Holokaustit, jehon me ngulmim edhe më të madhe sot:

“Nëse nuk ballafaqohemi me të keqen raciste në momentin e parë të

manifestimit, në dukje e padëmshme, ajo do të kthehet në fenomen që është me të vërtetë i rrezikshëm, serioz dhe kërcënues për tërë shoqërinë... Ndonjëherë edhe në ditët e sotme i dëgjojmë njerëzit duke i ftuar ‘Ciganët në komorat e gasit’. Edhe sot mund ta shohim indiferencën ndaj këtyre thirrjeve, përkrahjen e heshtur për ata që u thërrasin, spektatorë qyqarë, përsëritjen e ndarjes në mes njerëzve në bazë të origjinës së tyre etnike. Me gjithë këtë duhet të ballafaqohemi vazhdimisht, sepse ky është territori i provuar dhe i njohur i racizmit.”²

Në vendin e njëjtë komemorativ, gjashtëmbëdhjetë vite më vonë në ditën e njëjtë, 13 maj 2011, udhëheqësi i Partisë së Gjellbër Çeke Ondřej Liška e ftoi shoqërinë Çeke ta nderojë në mënyrë dinjitoze kujtimin për ata që u torturuan dhe u zhdukën në kampin Lety dhe e përshkroi fermën e afërt të derrave si një fyerje për të gjallët dhe të vdekurit. Ai deklaroi se “një pjesë e madhe e shoqërisë çeke ose nuk di si ta pranojë pjesën e vet të fajit historik për fatin e romëve këtu, ose nuk dëshiron ta pranojë atë ... Përkundër polakëve, të cilët sot diskutojnë haptazi fajin e paraardhësve të vet për fatin e çifutëve polak gjatë Luftës së Dytë Botërore, ne çekët nuk jemi të aftë të bëjmë asgjë të ngjashme në lidhje me romët tanë”. Ai e përshkroi elitën politike si bashkëfajtorë thellë në këtë ‘qyqari’ dhe i ka qortuar për ndihmesën në kalimin drejt racizmit, të ngjyrosur me populizëm në skenën kombëtare politike: “Ne kemi hasur në manifestime të hapura të racizmit dhe ksenofobisë në të gjitha – e përsëris, të gjitha – partitë që janë momentalisht të ulura në Parlament”. Liška insistoi se

rreziku më i madh për pakicat nuk paraqitet nga skinhedsat, por nga njerëzit në dukje të parrezikshëm në moshë të shtyer në majë të elitës politike të cilët flasin me aq entuziazëm për rreziqet që i kanosen kombit nga socialistët multi-kulturor në Bruksel:

“Ata, përmes aktiviteteve të tyre publike po i kontribuojnë faktit të hidhur që një pjesë e madhe e shoqërisë çeke nuk e konsideron 13 majin dhe kampin e koncentrimit në Lety të denjë për përkujtim në çfarëdo mënyre të mundshme. Këtu ka diçka për të përkujtuar: Një e kaluar e hidhur, dhe një e tashme e hidhur. Nuk kanë kaluar as katër vite kur Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg mori vendim kundër Republikës Çeke për segregimin e fëmijëve romë në edukim, këta fëmijë ende nuk gëzojnë qasje të barabartë dhe të drejtë në edukim e as mundësi në jetë.”³

Shumë gjëra kanë ndryshuar gjatë gjashtëmbëdhjetë viteve nga fjalimet e Havel dhe Liška, megjithatë rreziku që i kanoset romëve nga racizmi ende nuk është zbehur. Disa gjëra kanë ndryshuar për të mirë, pasi që në njërin anë që nga 1990-tat, thirrjet nga romët dhe militantët e aktivistët pro-romë për njohje, përfaqësim dhe respekt për pakicën etnike më të madhe në Evropë kanë jehonë shumë më të madhe se kurdo më parë. Pa dyshim se ka pasur

¹ Agjencia për të Drejtat Fundamentale, ‘EU-MIDIS Raporti i Rezultateve Kryesore, 2009’. http://fra.europa.eu/fraWeb-site/eu-midis/eumidis_main_results_report_en.htm

² František Kostlán, ‘† 13. 5. 1995: Vrasja e Tibor Berkí’, ROMEA http://www.romea.cz/english/index.php?id=detail&detail=2007_2486

³ Ondřej Liška, Komentari: Udhëheqësi i Partisë së Gjellbër Çeke i bën thirrje qeverisë ta largojë fermën e derrave nga Lety, ROMEA http://www.romea.cz/english/index.php?id=detail&detail=2007_2465

shenja inkurajuese që institucionet Evropiane dhe qeveritë kombëtare kanë filluar t'i kushtojnë vëmendje këtyre thirrjeve. Megjithatë aty ku çon peshë më së shumti, në bazë shumë pak ka ndryshuar për komunitetet thellësisht të varfra dhe të përjashtuara në aspekt social. Në fakt, ajo që është më alarmuesja është se këto ndryshime nga lart që mezi vërehen mund të ngecin apo me të vërtetë të ndryshohen nga rrjedha në rritje e anti-Ciganizmit: paragjykimi helmues dhe i shpërndarë gjithandej që rrezikon përmbyshjen e progresit. Përkundër Dekadës për Përfshirjen e Romëve, dy Samiteve të BE-së për Romët, një Platforme të BE-së për Romët, një grumbulli të Rezolutave të Parlamentit Evropian dhe Kornizës së BE-së për Strategjitë Kombëtare për Integrimin e Romëve, anti-Ciganizmi është bërë edhe më toksik.

Anti-Ciganizmi i orkestruar politikisht, dëshmitarë të së cilit jemi sot, ka rrjedhë të ndryshme nga grumbulli i pazhvilluar i paragjykimeve tradicionale e të rëndomta të fshehura nga shumica e popullatës në qytete dhe shtete në tërë kontinentin. Paragjykimi është bërë forcë mobilizuese për partitë skajshmërisht të djathta, rojet e tyre paramilitare dhe transmetimet mediale në lidhje me ta. Dhe paragjykimi anti-rom i papenguar dhe i pa ndaluar e ka zaptuar skenën qendrore me ultra-nacionalizmin si përbërësin kryesor në sulmin e gjerë radikal të popullarizuar ndaj të ashtuquajturit konsensus liberal. Thomas Hammarberg e përshkroi urgjencën e klimës dhe mos-tolerancës ndaj romëve dhe pakicave tjera si një kalim nga paragjykimi "tradicional" në qëndrim të prera raciste, të predikuara nga grupet e vogla politike po megjithatë gjithnjë e më të dukshme dhe të lëna kryesisht pa kontroll nga pjesa më e madhe e shoqërisë". Ajo që është më shqetësuese për Hammarberg është se "sot as partitë më të mëdha nuk janë imune nga përdorimi i retorikës anti-rome për përfitim politik afat-shkurtë – diçka që nuk do të tolerohej një dekadë më parë."⁴

Politikanët udhëheqës nga shtetet më të reja anëtare të BE-së i kanë përshkruar romët si material i keq njerëzor, dhe pa ngurrim deklarojnë se romët janë



gjenetiksht të prirur ndaj aktiviteteve kriminale, dhe i përshkruajnë komunitetet rome si 'inkubatorë të krimi'. Kur flasim për krimin, si e ka vështruar së voni Salman Rushdie: krimi i vërtetë është yni, përderisa demokracitë tona e përjetësojnë përjashtimin, ato dështojnë t'i luftojnë nivelet shokuese të varfërisë, dhe i fllojnë romët për të gjitha të keqijat e shoqërisë, ne i dënojmë komunitetet rome, siç e përshkroi Rushdie si 'ankth i gjallë'.⁵

Në këtë ankth të gjallë fjalët toksike janë shoqëruar me vepra rrëqethëse. Siç e vështroi Hammerberg:

"Rritja e retorikës anti-rome shkon krah për krah me format e ndryshueshme të dhunës ndaj romëve dhe sintive. Përderisa në fillim të viteve 1990-ta ishim dëshmitarë të rasteve të dhunës së rastit nga komuniteti kundër romëve, sot shohim një numër në rritje të sulmeve ndaj romëve të kryera nga individë të mobilizuar nga ideologjia raciste anti-rome. Këto janë sulme me paramendim, me qëllim për të vrarë, që i synojnë individët apo familjet e rastit për shkak të etnisë së tyre".

Në Hungari, pas vrasjes së Jeno Kóka, të vrarë me revole përderisa dilte nga shtëpia për në punë në ndërrimin e natës në Tiszalok, famullesha e tij Agnesa e rënduar nga pikëllimi, një studente universiteti me mendje qytetare e cila kishte punuar në çështje për integrimin e romëve për shtatë vite shpjegoi: "Ne ndihemi mu si shënjestra të vërteta. Vdekja e nunit tim vërteton se çkado që

bëjmë ne, sado që mundohemi ta dëshmojmë veten para shumicës së popullatës dhe vetes gjithashtu – e vetmja gjë që vlen në fund është se jemi lindur për të qenë romë."⁶

Vargu i të shtënave dhe sulmeve me bomba ndaj vendbanimeve rome që morri jetën e burrave, grave dhe fëmijëve ndodhi si rezultat i raportimit paragjykses nga mediat, shpërndrja e anti-Ciganizmit dhe paramilitarizmit të djathtë u nxit nga partia ekstremiste Jobbik dhe *squadristi* të saj në uniformë. Lidhja në mes të fjalëve dhe veprave, në mes të retorikës anti-rome dhe dhunës raciste vdekjeprurëse u bë shumë e qartë me paditë që u bënë ndaj atyre që akuzoheshin për vrasje. Neo-nazistët e akuzuar kishin bindje të përbashkët se shteti, gjyqësori dhe policia nuk po e kryenin punën e tyre në lidhje me 'krimin e Ciganëve'. Padia thekson se në gusht 2007 të akuzuarit morën pjesë në inaugurimin e Magyar Gárda. Ata i vlerësuan si të paafte për ta zgjidhur 'situatën sociale', dhe vendosën të armatosen dhe të marrin rol aktiv në 'vënien e rendit'. Ata i zgjedhën shënjestrat e tyre në bazë të raportimit të

⁴ Thomas Hammarberg, 'Diskriminimi i romëve në Evropë: Perspektiva e të Drejtave të Njeriut', Fjalim nga Komisioneri për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës (Seminari për të drejtat e romëve i organizuar nga ABF – Shoqata e Punëtorëve Arsimorë) Stokholm, 30 shtator 2010

⁵ Bernard Rorke, 'Thirrje dëshmitarin: Rushdie për romët', <http://blog.soros.org/2011/06/call-the-witness-rushdie-on-roma/>

⁶ Szilvia Varró on Kisléta: Ne e kishim një ëndërr, e përkthyer nga *Népszabadság Online*, e hënë, 17 gusht 2009, nga Bernard Rorke, 'Nëse je rom mund të vrahesh si qen'

http://www.romadecade.org/if_you_are_roma

medieve, "vëmendja e tyre tërhiqej kurdo që kishte konflikt sinjifikant romë-hungarez."

Vrasësit mund të jenë kapur, por paragjykimi dhe frika ende mbizotërojnë. Më herët gjatë këtij viti, në qytetin hungarez Gyöngyöspata, paramilitarë të uniformuar neo-fashistë, të përkrahur nga ndihma e skinhedsave me kamxhikë dhe qen luftarak, përderisa policia qëndronte aty duarkryq.⁷ Në bazë të raporteve të dëshmitarëve okularë, policia vendore shikonte përderisa rojet i frikësonin gratë dhe fëmijët rom gjatë rrugës së tyre për dhe nga shkolla, dhe grindeshin me anëtarët e parlamentit të cilët kishin guxim ta kalojnë vijën dhe të takohen me udhëheqës rom. Rrethimi zgjati për dy javë e gjysmë. Kjo jep shenja për qëllimin e qartë të të djathtës së skajshme për të mbjellë frikë në mesin e qytetarëve rom. Reagimi i Kryeministrit Viktor Orban ishte se 'gjëra të këqija kanë mundë të ndodhin' dhe i jemi shmangur për shkak se policia veproji me përkushtim të sigurt të liruar nga vetëkënaqësia. Kjo është një gjë jashtëzakonisht e shëmtuar për demokracinë, me çerdhe në Bashkimin Evropian, kur monopoli i shteteve për përdorimin e forcës është i uzurpuar nga militantët fashist që veprojnë në emër të partisë Jobbik, përfaqësuesit e të cilës janë pjesë e Parlamentit Hungarez dhe atij Evropian. Është një gjë jashtëzakonisht e shëmtuar kur qytetarët e pakicës etnike janë të terrorizuar, keqtrajtuar dhe rrethuar në aso mënyre që ti kujton vitet e 1930-ta. Për shumicën e romëve, ky skenar duket më i mundshëm se sa agimi i një dite të re me përfshirje, barazi dhe respekt të ndërsjellë.

Reagimi i qytetarëve të Gyöngyöspata në korrik ishte zgjedhja e kandidatit të Jobbik Oszkár Juhász për kryetar gjatë zgjedhjeve ku 45% e elektoratit votuan për kandidatët e djathtë. Juhász deklaroi se ai do ta zbatojë ligjin dhe rendin duke prezantuar patrullat në terren dhe forcën policore 'vendore' të armatosur. Duke i hutuar kritikët e tij, Jobbik ka arritur ta rimarrë nivelin e përkrahjes që e ka pas gjatë zgjedhjeve të vitit 2010. Sipas Political Capital, kjo është meritë e riafirmimit publik të udhëheqësisë së Jobbik me një stil më radikal dhe më të

guximshëm në politikë: kthimi në politikat e rrugës, rritja e retorikës anti-rome dhe anti-semitike dhe përkrahja e organizatave të stilit të Gardës: "Është e qartë se nxitja e tensionit etnik është në interesin politik të Jobbik dhe organizatave tjera skajshmërisht të djathta me lidhje të ngushta me partinë".⁸ Ajo që nuk është e qartë është nëse udhëheqësia e Jobbik mund ta mbajë kontrollin mbi këto organizata paramilitare. Të trimëruara nga sukseset në rrugë, ekziston rreziku i mobilizimeve më radikale dhe më raciste të organizatave të stilit të Gardës, të dedikuara për të frikësuar si dhe pa përgjegjësi ndaj elektoratit dhe të parrezikuara nga votat në votimet e opinionit.

Ekstremizmi i tillë i kontaminon të gjitha fushat e jetës publike. Siç e theksoi Ambasadori Janez Lenar i (Drejtor i zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut) tash së voni, duke iu referuar Republikës Çeke, manifestimet e jotolerancës duke përfshirë retorikën anti-rome nga figurat publike në nivel kombëtar dhe lokal, dhe frikësimi ekstremist i komuniteteve rome i kontribuon një mjedisi armiqësor që ka ndikim negativ në përpjekjet për integrim.⁹

Më 8 mars, një rezolutë e Parlamentit Evropian i bëri thirrje Komisionit Evropian t'i lidhë prioritetet e përfshirjes sociale me një set të objektivave që përfshijnë mbrojtjen e qytetarëve nga diskriminimi në të gjitha fushat e jetës; nxitjen e dialogut shoqëror në mes të romëve dhe jo-romëve për ta luftuar racizmin dhe ksenofobinë; dhe për Komisionin, si roje e marrëveshjeve, të sigurohet se po zbatohet legjislati i relevant dhe sanksionet e përshtatshme ndaj krimeve të motivuara nga racizmi.¹⁰

Edhe pse kjo nuk ishte paraqitur qartë në Komunikimin e Kornizës së Komisionit, Konkluzionet e Këshillit të cilat pasuan e ripohuan rëndësinë thelbësore të kësaj ndërlidhje. Në pjesën e hyrjes në konkluzione, Këshilli i Bashkimit Evropian thekson se është i autorizuar të marrë masa të përshtatshme për ta luftuar diskriminimin, dhe i ka zbatuar këto fuqi 'kur e ka miratuar Udhëzimin 200/43/EC që e zbaton principin e trajtimit të barabartë në mes personave pa dallim race apo etnike dhe e fton

Komisionin "të ushtrojë monitorim rigoroz të zbatimit të Udhëzimit të Komisionit 200/43/EC i cili është instrument i fuqishëm për luftën kundër diskriminimit të bazuar në origjinë etnike".¹¹

Komisioni ka plotësisht të drejtë në insistimin e tij që përgjegjësia primare për mbrojtjen e të drejtave, mirëqenien dhe sigurinë e qytetarëve bie mbi qeveritë kombëtare. Megjithatë, nëse Korniza dëshiron ta arrij synimin e vet "10 vite për të bërë ndryshim", atëherë Komisioni duhet të bëjë çdo gjë që është në fushën dhe kompetencat e tij për ta inicuar ftesën e Këshillit dhe për t'i sinjalizuar shteteve anëtare dhe shteteve kandidate se asgjë më pak se qasja zero-tolerancë do të jetë e mjaftueshme kur bëhet fjalë për anti-Ciganizmin dhe të gjitha format e diskriminimit ndaj romëve.¹² Por a do të dëgjojnë qeveritë? Të dhënat e tyre deri më tash japin pak arsye për optimizëm. Megjithatë, pas masakrës në Norvegji, as edhe udhëheqësi politik më i mpirë nuk mund të mbetet indiferent ndaj rreziqeve nga ekstremizmi i skajshëm i djathtë. Bile edhe mund të jetë e dukshme për ta se nxitja e popullatës ndaj racizmit është lojë me zjarr; se racizmi është, ashtu si tërhoqi vërejtjen Havel shumë vite më parë, një fenomen me të vërtetë i rrezikshëm, që i bën dëm tërë shoqërisë.

(Autori është Drejtor i Hulumtimeve dhe Avokimit Nderkombëtarë, Roma Initiatives, Instituti për Shoqëri të Hapur Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë artikull janë të autorit dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht politikën dhe këndvështrimet e OSI-it.)

⁷ Richard Field, Thirrje për lëmoshë, Budapest Times, 26 mars 2011 http://www.budapesttimes.hu/index.php?option=com_content&task=view&id=17156&Itemid=223

⁸ Political Capital Institute Budapest, *Analiza e thellë: Perspektiva politike e të drejtave radikale në Hungari*, 26 korrik 2011

⁹ OSCE Komunikatë për Shtyp, 'Shefi i OSBE-së për të drejtat e njeriut bën thirrje për t'i dhënë fund segregimit dhe diskriminimit ndaj fëmijëve romë në shkollat çeke', 17 maj 2011 <http://www.osce.org/odihr/78815>

¹⁰ Presidenca Hungareze në Këshillin e Bashkimit Evropian, EU2011.hu, 'Parlamenti Evropian për krijimin e strategjisë për romët 2011', 9 mars <http://www.eu2011.hu/news/european-parliament-roma-strategy>

¹¹ Këshilli i Bashkimit Evropian (2011) *Konkluzionet e Këshillit mbi Kornizën e BE-së për Strategjitë për Integrimin Kombëtar të Romëve deri në vitin 2020*.

¹² Bernard Rorke, *Përtej Retorikës: Rruga për Integrimin e Romëve për vitin 2020*, Dekada e Përfshirjes së Romëve 2005-15. http://www.romadecade.org/beyond_rhetoric

PARA SE TË BËHET TEPËR VONË – DEKADA E PËRFSHIRJES SË ROMËVE NË BALLKANIN PERËNDIMORË

Stephan Müller



Më 2005, Instituti për Shoqëri të Hapur dhe Banka Botërore e filluan Dekadën e përfshirjes së romëve. Vendet pjesëmarrëse u zotuan se do ta mbushin boshllëkun ndërmjet popullsisë shumicë dhe romëve.

Në Ballkanin Perëndimor, Kroacia, Serbia, Maqedonia dhe Mali i zi ishin në mesin e vendeve që e themeluan Dekadën e përfshirjes së romëve ndërsa Shqipëria dhe Bosnja dhe Hercegovina iu bashkëngjitën Dekadës vetëm më vonë. Megjithatë, Kosova dhe Greqia janë vendet e vetme të Ballkanit Perëndimor të cilat nuk janë duke marrë pjesë në Dekadën e përfshirjes së romëve.

Dekada shkaktoi pritje të mëdha në mesin e popullsisë rome dhe të shoqërisë civile në vendet e Ballkanit Perëndimor. Romët janë duke jetuar në margjina apo thënë ndryshe në fund të shoqërive duke u ballafaquar me shkallë të lartë të papunësisë, me shkallë të ulët të vijueshmërisë në shkollë, me gjendje të keqe shëndetësore dhe duke pasur kushte të papranueshme të jetesës. Paragjykimet dhe diskriminimi, madje edhe dhuna kundër romëve janë të përhapura. Në këtë aspekt, gjendja në Ballkanin Perëndimor është e ngjashme me gjendjen në vendet e tjera evropiane të cilat kanë numër më të madh të popullsisë rome.

Megjithatë, varfëria e përgjithshme në Ballkanin Perëndimor dhe në veçanti pasojat e luftërave në të nëntëdhjetat e kanë bërë më komplekse gjendjen e tyre shoqëro-ekonomike. Përveç kësaj, me përjashtim të Maqedonisë dhe të Serbisë, në asnjërin prej vendeve të Ballkanit Perëndimor nuk ekziston një shoqëri civile rome e madhe dhe e fuqishme..

Dekada e përfshirjes së romëve ka filluar në një periudhë kur u bë e qartë që përkundër investimeve financiare gjendja e romëve u përkeqësua edhe më shumë dhe u rrit edhe më shumë distanca etnike ndërmjet romëve dhe jo-romëve. Politikanët përkatës mund ta kenë kuptuar gjendjen por ose nuk ishin të gatshëm ose nuk ishin në gjendje të merreshin me përjashtimin shoqëror të romëve në vendet e tyre.

Shumë përfaqësues të shoqërisë civile e perceptuan Dekadën (dhe ende e perceptojnë) si mbështetje kryesore që do të mund ta ndalte procesin nga përkeqësimi i mëtejshëm si i kushteve të jetesës të romëve po ashtu edhe të marrëdhënieve ndërmjet romëve dhe grupeve të tjera etnike.

Megjithatë, a ishte (ose a është) Dekada në të vërtetë mbështetja kryesore që do të mund t'i ndalte të gjitha zhvillimet negative dhe t'i kthejë politikën ngadalë në drejtimin e duhur? A ka çuar Dekada në krijimin e politikave gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme në vendet pjesëmarrëse? Dhe a ka ndryshuar gjendja shoqëro-ekonomike e romëve në ato vende?

Me Fondin për arsimimin e romëve, Dekada e ka krijuar një institucion i cili investon në mënyrë të suksesshme në përkrahjen e arsimit cilësor për fëmijët romë dhe në mundësinë e tyre për ta shfrytëzuar arsimin cilësor.

Nuk ka kurrfarë dyshimi që Dekada e ka ngritur vetëdijen për gjendjen e romëve dhe për më tepër e ka rritur të kuptuarit për domosdoshmërinë e politikave urgjente gjithëpërfshirëse për përmirësimin e gjendjes së romëve. Në njëfarë mënyre, Dekada mund të ketë pasur

ndikim madje edhe në krijimin e Kornizës së re Evropiane për Politikën Nacionale për Romët.

Korniza Evropiane vlen po ashtu edhe për vendet që janë në procesin e anëtarësimit. Në Komunikatën përkatëse të Komisionit thuhet që "synimet e BE-së për integrimin e romëve janë njësoj të rëndësishme për këto vende. Strategjitë e tyre nacionale për integrimin e romëve dhe planet e veprimit (të krijuara në shumicën e rasteve në kornizën e Dekadës së përfshirjes së romëve 2005-2015) duhet të shqyrtohen në pajtim me këto synime."¹

Komiteti ndërkombëtar drejtues i Dekadës së përfshirjes së romëve iu përgjigj kësaj sfide dhe, në seancën e tij të mbajtur më 28 qershor 2011 në Pragë, miratoi një zotim në të cilin *në mes tjerash* thuhet:

"Ne do t'i përditësojmë dhe do t'i zhvillojmë edhe më tutje planet tona nacionale të veprimit të Dekadës për ta plotësuar thirrjen e konkluzioneve të Këshillit që shtetet ta zhvillojnë një qasje plotësisht gjithëpërfshirëse për përfshirjen e romëve. Ne do të caktojmë synime të arritshme nacionale në fushat me prioritet si arsimi, punësimi, kujdesi shëndetësor dhe strehimi; ne do të krijojmë mekanizma mbikëqyrës për ta matur përparimin e arritur dhe për të raportuar çdo vit lidhur me këtë; dhe do t'ua mundësojmë romëve t'i shfrytëzojnë më lehtë fondet ekzistuese të BE-së për

¹ Komisioni Evropian, Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Shoqëror dhe për Komitetin e Regjioneve – Një Kornizë e BE-së për Strategjitë Nacionale për Integrimin e Romëve deri në vitin 2020, COM (2011) 173 përfundimtar, Bruksel 5. prill 2011, mund ta gjeni në http://ec.europa.eu/justice/policies/discrimination/docs/com_2011_173_en.pdf (përdorur më 29 korrik)



projektet për përfshirjen e romëve ashtu që ata "t'i trajtojnë nevojat e reja, ta thjeshtojnë realizimin dhe ta shpejtojnë zbatimin e prioriteteve" në mënyrë efektive".²

Me këtë zotim, vendet që marrin pjesë në Dekadë i kanë pranuar tërthorazi dobësitë e Dekadës:

- Pjesa më e madhe e planeve të veprimit të hartuara në kornizën e Dekadës nuk e pasqyrojnë një qasje gjithëpërfshirëse të politikave; përkundrazi ato pasqyrojnë një listë të dëshirave të intervenimeve të mundshme të cilat është e pamundur të zbatohen në kornizat e caktuara kohore të planeve të veprimit.
- Për më tepër, shumica e planeve të veprimit nuk përmbajnë as "synime të arritshme nacionale" as tregues SMART dhe as buxhetin që nevojitet për zbatimin e tij (ose buxheti i propozuar nuk mund të mbështetet kurrë).
- Nga aspekti metodologjik shumica e planeve të veprimit duhet të korrigjohen tërësisht.
- As vendet as Bashkimi Evropian nuk kanë ofruar burime të mjaftueshme financiare për ta trajtuar gjendjen në

mënyrë serioze.

- Në asnjërin prej vendeve nuk ekziston ndonjë mekanizëm mbikëqyrës apo i përshtatshëm i raportimit.
- Ndikimi në terren është shumë i kufizuar.

Lista do të mund të vazhdonte:

- Përfshirja e romëve në zhvillimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e politikave mbetet shumë e dobët.
- Kushti i Dekadës që gjinia duhet të jetë çështje që prekë të gjithë sferat nuk është trajtuar pothuajse aspak.
- Institucionet e nivelit nacional të cilat janë përgjegjëse për zbatimin ose bashkërendimin e politikave që kanë të bëjnë me romët nuk kanë ndikim të mjaftueshëm në qeveritë për të përkrahur politika gjithëpërfshirëse dhe në përgjithësi nuk kanë personel të mjaftueshëm.

Ky vlerësim i përgjithshëm vlen edhe më shumë për vendet e Ballkanit Perëndimor. Megjithatë, raporti për mbikëqyrjen e Dekadës i vitit 2010, duke u bazuar në studimin e ekspertëve, ka zbuluar një vlerësim pozitiv të ndikimit të Dekadës në

vendet e Ballkanit Perëndimor.³

Ndikimi i programeve të qeverisë në "arsim" është vlerësuar më së miri në Rumani, në Serbi dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, ndërsa "strehimi" në Bosnjë dhe Hercegovinë, në Republikën Çeke dhe në Shqipëri, "punësimi" në Serbi, në Maqedoni dhe në Shqipëri, ndërsa "shëndeti" ka marrë vlerësimin më të mirë në Maqedoni, në Rumani dhe në Spanjë.⁴

Dy vlerësimet më të mira të përgjithshme janë dhënë nga dy vende, Shqipëria (4.00) dhe Spanja (3.92) që i janë bashkuar Dekadës së fundi. Në përgjithësi, vendet e Ballkanit Perëndimor (dhe vendet që i janë bashkuar Dekadës së fundi) janë prirur të bëjnë vlerësim më pozitiv të ndikimit të Dekadës.

Sa i përket ndryshimit të integritetit dhe të diskriminimit gjatë pesë vjetëve të kaluar, studimi ka treguar rezultate të ngjashme

² Zotimi i aprovuar për Dekadën e përfshirjes së romëve për mbështetjen e Kornizës së BE-së për strategjitë nacionale për integrimin e romëve deri në vitin 2020 mund të gjendet në http://www.romadecade.org/20th_isc_meeting_eu_roma_framework_pledge (përdorur më 4 korrik 2011)

³ Mbikëqyrja e Dekadës, rezultatet e Studimit 2009. Budapest 2010

⁴ Është përdorur vlerësimi si vijon: shumë pozitiv 5 pikë; pozitiv 4 pikë; neutral 3 pikë; negativ 2 pikë; shumë negativ 1 pikë; nuk e di 0

me vlerësime më të mira në Ballkanin Perëndimor dhe në vendet që i janë bashkuar Dekadës së fundi.

Si mund të sqarohet ky vlerësim relativisht pozitiv i ekspertëve në Ballkanin Perëndimor duke i pasur parasysh dobësitë e Dekadës dhe mungesën e rezultateve të vërteta në terren?

Në njërën anë, duhet ta pranojmë që pikënisja për vendet e Ballkanit Perëndimor ishte më e ulët se sa për vendet që janë anëtare të Bashkimit Evropian.

Shtetet anëtare të BE-së kanë mundësi të shfrytëzimit të më shumë burimeve financiare dhe shtetet e reja anëtare kanë marrë shuma të konsiderueshme në vitet e fundit para se të hyjnë në Bashkimin Evropian. BE-ja e ka paraqitur zhvillimin e strategjive nacionale për integrimin e romëve si kusht për anëtarësim dhe si rrjedhojë shtetet e reja anëtare të BE-së i kanë zhvilluar këto strategji gjatë viteve të nëntëdhjeta.

Vlerësimi relativisht negativ i ekspertëve nga shtetet anëtare të BE-së me sa duket e pasqyron më shumë zhgënjimin që dokumentet ekzistuese si strategjitë nacionale dhe planet e veprimit të Dekadës dhe burimet e shtuara financiare nuk kanë pasur ndikim më të mirë. Në anën tjetër, vlerësimi pozitiv i ekspertëve nga vendet e Ballkanit Perëndimor duket që bazohet në zhvillimet pozitive në vende siç është miratimi i planeve të veprimit dhe formulimi i politikave nacionale, që nënkupton se politika dhe politikanët kanë filluar ta marrin seriozisht nevojën për ta trajtuar gjendjen e romëve, por të bëjnë më pak për përmirësimin e vërtetë të gjendjes shoqëro-ekonomike të romëve.

Edhe pse Kosova ende nuk është anëtare e Dekadës së përfshirjes së romëve, ajo mund të mësojë nga përvoja e vendeve të Dekadës në Ballkanin Perëndimor.

Kosova e ka miratuar edhe Strategjinë për integrimin e romëve, të ashkalinjëve dhe të egjiptianëve dhe planet përkatëse të veprimit tashmë para një kohe dhe duhet t'i shfrytëzojë ato për zbatimin e një politike gjithëpërfshirëse, të integruar dhe të qëndrueshme.

Njëra nga mësimet e mësuara nga vendet e tjera në Ballkanin Perëndimor është që



qeveria, në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e romëve, të ashkalinjëve dhe të egjiptianëve, duhet të jetë në ballë të zbatimit të dokumenteve të politikave dhe ta integrojë komunitetin ndërkom-bëtar të donatorëve në këtë proces.

Në Kosovë ende ekzistojnë pasojat e konfliktit – po ashtu edhe në mesin e komunitetit të romëve, të ashkalinjëve dhe të egjiptianëve. Qeveria duhet ta pranojë këtë mendim dhe të marrë rol më pro-aktiv në përkrahjen e integritit të tri komuniteteve në shoqërinë e Kosovës.

Në veçanti sa i përket procesit të integritit evropian, integrimi i të tri komuniteteve do të bëhet temë gjithnjë më e rëndësishme.

Një mësim shumë të rëndësishëm të cilin qeveria do të mund ta mësonte nga përvojat e vendeve të tjera në Ballkanin Perëndimor është që shtyrja e trajtimit të përjashtimit dhe të diskriminimit të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve nuk shpaguehet. Shtyrja e problemit do të rritet dhe do ta vështirësojë gjithnjë e më shumë gjetjen e zgjidhjeve.

Një përkushtim i shtuar që po ashtu i

trajton rrethanat specifike të komuniteteve në Kosovë mund të kontribuojë në lehtësimin e integritit të Kosovës në Dekadë.

P.S. Për fat të keq, nuk ekziston një "vend model" për përfshirjen e romëve në Ballkanin Perëndimor edhe pse duke e pasur parasysh nivelin e ulët të përfshirjes në rajon do të ishte relativisht lehtë të shndërrohet në një vend të tillë model. Do të nevojitej një udhëheqje politike që e pranon se vetëm zbatimi i përkushtuar i një politike gjithëpërfshirëse, të integruar dhe afatgjate mund ta ndryshojë gjendjen për romët dhe që të gjithë qytetarët, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike do të përfitonin nga ky ndryshim.

(Autori është shkencëtar politik. Ka punuar në Kosovë në mes tjerash si ekspert i lartë për zhvillimin e Strategjisë për integrimin e romëve, të ashkalinjëve dhe të egjiptianëve (2006-2008) dhe si këshilltar për çështje të pakicave në misionin e OSBE-së në Kosovë (2000-2002))

E ARDHMJJA PËRTEJ SIMBOLIKËS: PJESËMARRJA, PËRFAQËSIMI DHE EMANÇIP- IMI I ROMËVE

Željko Jovanović



"Kur njerëzit janë të zhytur në shtypje, ata e përjetojnë çlirimin vetëm atëherë kur kanë akumuluar fuqi për ta imponuar ndryshimin."

Fjalët e Dr. Martin Luther King-ut në vitin 1967 për shtypjen, çlirimin dhe fuqinë për të bërë ndryshim jehojnë me po aq fuqi sot dhe fuqizimi mbetet principi ynë udhëheqës në Iniciativat për Romë të Shoqërisë së Hapur për ta sfiduar shtypjen, dhunën, diskriminimin dhe segregimin me të cilin ballafaqohen romët në tërë Evropën.

Shpesh herë tregimet individuale demonstrojnë më fuqishëm se si romët mbeten 'të zhytur në shtypje' dhe sa vështirë mund të jetë për ta thyer ciklin e përjashtimit. Një nga shembujt është ai i tetë-vjeçarit Danijel Stepanovic dhe nënës së tij që u larguan nga Valjevo për në Vjenë në vitin 2002. Nëna e Danijelit nuk shihte perspektivë për një të ardhme më të mirë dhe më të ndritshme për vete dhe djalin e saj poqese mbeten në Serbi. Shumë shpejt u vendosën në Vjenë; Danijeli u regjistrua në shkollë dhe nëna e tij gjeti punë. Atje jetuan për shtatë vite deri sa erdhi koha që Danijeli të regjistrohet në shkollë të mesme. Pasi që statusi i tij ligjor ende nuk ishte zgjidhur, edhe pse nëna e tij kishte të drejtë të qëndrojë në Austri, Danijeli u deportua. Të dy, nëna dhe djali u kthyen në Valjevo. Të ngjuar në Serbi për një vit, Danijeli mbeti jashtë shkollës, dhe nëna e tij mbeti pa punë. Menjëherë pas liberalizimit të vizave në janar 2010, ata u kthyen në Vjenë.

Për shumicën e romëve në Serbi e ardhmja duket e zymtë. Përveç nivelit të lartë të varfërisë dhe papunësisë që është më i lartë se për pjesën tjetër të popullatës, ata ballafaqohen edhe me

shumë forma të diskriminimit direkt dhe indirekt. Me shpresa të vogla për një të ardhme më të mirë në Serbi, është e pashmangshme që mijëra romë do të zgjedhin të emigrojnë, mu si Danijeli dhe nëna e tij. Ata janë të lodhur nga pritja që qeveritë t'i mbajnë premtimet e tyre, të lodhur nga pritja që politikatat abstrakte të prodhojnë ndryshim të vërtetë. Kjo përvojë nuk është e veçantë e Serbisë. Është realiteti i zymtë i situatës së romëve në tërë Ballkanin Perëndimor.

Jemi rreth një milion romë në Ballkanin Perëndimor. Rreth 700,000 mbeten të papunësuar, dhe rreth 300,000 të rinisë tonë janë analfabetë. Për të gjithë ne, anëtarësimi eventual i shteteve tona në Bashkimin Evropian mban shpresën për një jetë më të mirë dhe një të ardhme më të ndritur. Në ndërkohë ne e pyesim veten: a të mbetemi në shtëpi, apo të migrojmë dhe të provojmë ta bëjmë shtëpi tonën ndonjë vend tjetër në Bashkimin Evropian?

Ndërsa tani për tani, zgjedhjet janë: rri në shtëpi, ballafaqohu me diskriminimin, varfërinë dhe mungesën e mundësive; apo migro në kërkim të një jete më të mirë. Nuk ka dyshim se komunitetet tona do të ballafaqohen edhe jashtë me diskriminimin, por shumica konsiderojnë se e vlen ky çmim për të krijuar një të ardhme për fëmijët e tyre.

Siç e ka bërë të qartë 'komponenta e zgjerimit' e Kornizës së BE-së për Strategjitë Kombëtare për Integrimin e Romëve, BE-ja ka rol vital në ngritjen e fondeve dhe monitorimin e ndikimit të tij progresiv në kohezionin social, mundësitë e barabarta dhe përfshirjen e romëve në këtë proces të zgjidhur të anëtarësimit. Ai nevojitet të sigurojë se Shtetet Anëtare të reja në të ardhmen i përkrahin Kriteret e Kopenhagës

për anëtarësim në BE. Ai nevojitet t'i mbajë këto shtete përgjegjëse nëse dështojnë në përkushtimet dhe obligimet detyruese të tyre për qytetarët e tyre më të cenueshëm, të mohuar dhe të përjashtuar.

Bashkimi Evropian ka gjithashtu rol vital në asistimin e qeverive dhe komunave po ashtu në ndërtimin e kapacitetit dhe koordinimit të përpjekjeve ekzistuese dhe të ardhme për ta promovuar përfshirjen e romëve. Nga kjo anë, Bashkimi Evropian duhet të sigurohet se instrumentet momentale të financimit janë të shpërndara në atë mënyrë që të kenë ndikim sa më të mirë në tërë Ballkanin Perëndimor. BE-ja duhet të sigurohet se principi udhëheqës i "synimit eksplicit po jo përjashtues" krijon bazën për politikë strategjike për romët në tërë rajonin. Përdërisa po hyjmë në gjysmën e dytë të Dekadës së Përfshirjes së Romëve nën Presidencën e Maqedonisë, është e qartë se edhe shumë duhet të bëhet për ta luftuar varfërinë dhe përjashtimin shoqëror në atë mënyrë që të ketë ndryshim në jetët e njerëzve, të ofrojë së paku një çikë shpresë për të ardhmen.

Anëtarësimi i shteteve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian është një rast për progres për të gjithë qytetarët. Edhe Danijel dhe nëna e tij janë pjesë e shpresës që do të sjell zgjerimi, në mesin e të tjerave, mundësi më të mëdha punësimi, perspektivë më të mirë arsimore dhe kujdes shëndetësor të përmirësuar. Ekziston nevoja për të mbetur vigjilent për të siguruar se kjo mundësi historike për ta promovuar kohezionin shoqëror, për ta luftuar përjashtimin, dhe për ta rrënjësuar ndjenjën e shpresës për të ardhmen që të mos humbet, dhe se gjatë këtij tranzicioni historik, romët nuk do të jenë humbës.

Nëse na duhet të mësojmë ndonjë mësim nga e kaluara, kjo është se kur vije puna te konsultimi me rom, fuqitë që janë duhet të shkojnë përtej simbolikës, që qeveritë ta përqafojnë idenë se 'qytetaria aktive është bazë për përfshirje shoqërore, dhe i përfshin të gjithë qytetarët pa dallim etnie. Komuniteteve dhe përfaqësuesve rom duhet tu akordohet mundësia për të marrë pjesë në hartimin e politikave dhe iniciativave që kanë ndikim direkt në jetën e tyre.'¹

Është premtim i demokracisë se çdo person do të përfaqësohet në vendim-marrje. Vetëm atëherë personi mund të ndihet përgjegjës dhe t'i përmbushë rregullat e përbashkëta që e lidhin një shtet. Thomas Hammarberg, Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, e përshkroi përfaqësimin e vogël të rreth dhjetë milion romëve si dështim serioz të demokracisë sot.² Kështu që kur flasim për strategji integrimi duhet ta kemi parasysh se vetëm kur romët të jenë të përfaqësuar dhe të njohur plotësisht si qytetarë, vendimet që kanë të bëjnë me jetën e tyre do të kenë legjitimitet dhe relevancë. Në të kundërtën, intervenimet politike nga lart-poshtë – të manifestuara në mënyrën më skandaloze në fuqinë shtazarake të buldozerëve duke i shkatërruar shtëpitë e romëve – do të vazhdojë ta gërryjë nocionin e romëve si qytetarë.

Gjatë pesëmbëdhjetë viteve të kaluara, romët dhe organizatat pro-rome u bënë jashtëzakonisht të zhurmsëm në kërkesat e tyre për pjesëmarrje të romëve. Gjatë viteve, qeveritë kombëtare, organizatat ndërkombëtare dhe agjencitë ndërqeveritare arritën ta përqafojnë retorikën e pjesëmarrjes së romëve. Për shembull, deklarata e vizionit dhe vlerave të Dekadës për Përfshirjen e Romëve i vë theks të veçantë pjesëmarrjes së romëve: *Asgjë për ne pa ne*: Pjesëmarrja e romëve do ta krijojë apo shkatërrojë Dekadën. Përfaqësuesit e romëve dhe organizatat e shoqërisë civile janë të përfshirë në çdo fazë të Dekadës. Romët e kanë hartuar dhe definuar vizionin që nga fillimi. Grupet rome të shoqërisë civile dhe ekspertët rom i kanë identifikuar prioritetet e politikave dhe kanë luajtur rol kryesor në definimin e qëllimeve dhe synimeve të Dekadës. Pjesëmarrja e romëve do të jetë qendrore në vizitat e



rregullta dhe monitorimin e procesit gjatë dhjetë viteve të ardhshme.

Kështu që, retorika është përmirësuar ndjeshëm gjatë viteve të fundit. Megjithatë, mbetet një zbrazëti dhe sfida jonë është të shkojmë përtej thjeshtë bërjes gjoja se në nocionin e pjesëmarrjes së romëve. Nuk është e mjaftueshme për romët që disa prej tyre janë të punësuar në institucionet shtetërore, që një grusht përfitimesh nga takimet simbolike politike, apo që qeveritë ndonjëherë i ftojnë OJQ-të dhe ekspertët rom për konsultime. Pjesëmarrja nënkupton shumë më shumë se kaq.

Në mënyrë ideale, partitë politike duhet ta përfaqësojnë elektoratin e tyre, duke përfshirë qytetarët romë. Megjithatë, realiteti nuk është kështu. Partitë kryesore politike ofrojnë hapësirë jashtëzakonisht të limituar për kandidatët me origjinë rome dhe i përfaqësojnë shumë ultë nevojat e komuniteteve rome. BE-ja nuk bën të qëndrojë dhe të presë që partitë politike të ndryshojnë. Ajo vetë duhet të ndërmarrë veprime.

Bashkimi Evropian duhet ta gjejë një model për ta stimuluar përfaqësimin e romëve. Rregulloret mbi kuotat gjinore duhet të miratohen si zgjidhje afatmesme për numrin e ngritur të përfaqësuesve të zgjedhur romë në parlamentin Evropian dhe ato kombëtare. Prej tash deri në vitin 2020, komisioni duhet ta shtyjë konceptin e qytetarisë aktive në krye të Kornizës së vet për Strategjitë Kombëtare për Integrimin e Romëve. Duhet të hartohen dispozita për të siguruar se çdo qytetar

me origjinë rome është i regjistruar për të votuar, ka qasje në votim, dhe mund të marrë vendime të informuara kur e jep votën e vet.

Romët duhet të bëhen një elektorat i njohur politik i qytetarëve që kanë të drejta. Ne duhet të akumulojmë fuqi politike dhe civile në proporcion me numrin tonë. Vetëm atëherë do të dëgjohet zëri ynë, vetëm atëherë do t'i dëgjojnë qeveritë kërkesat tona dhe vetëm atëherë, sipas fjalëve të Dr. King, mund ta 'përfetojmë çlirimin'.

Në demokracitë e sotme, vota e secilit qytetar individual, të arsimuar apo analfabet, të pasur apo të varfër, rom apo jo-rom duhet të bartë njëlloj peshë të barabartë. Rrethanat tona shoqërore dhe politike sot janë në mënyrë të pakrahasueshme më të mira se ato të afrikanëve amerikan nën skllavëri apo Jug-afrikanët e zinj nën aparteid. Ne jemi shumë, e edhe pse mund të jemi të varfër, analfabetë, apo të shtypur, ne mund të zotërojmë fuqi në proporcion me numrin tonë; fuqi për ta krijuar një të ardhme më të mirë për fëmijët tanë.

(Autori është Drejtor i Roma Initiatives, Open Society Institute, Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë artikull janë të autorit dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht politikën dhe këndvështrimet e OSI-it.)

¹ Bernard Rorke, *Përtej Retorikës: Rruga e Integritit të Romëve për 2020. Dekada e Përfshirjes së Romëve 2011*, f. 7.

² Audio clip at <http://www.osce.org/item/26769.html>.

PA ATDHE – TË VËRTETAT LIDHUR ME RI- ATDHESIMIN NË KOSOVË SOT

Verena Knaus



Ka kaluar një vjet prej kur UNICEF-i botori për herë të parë raportin e tij *'Integrimi i varur nga kushtet: raport për gjendjen e fëmijëve romë, ashkalinjë dhe egjiptianë të Kosovës në Gjermani dhe pas riatdhesimit të tyre në Kosovë'*. Gjendja e përshkruar në raportin e vitit të kaluar ishte alarmuese. Në Gjermani, fëmijët të cilët nuk kishin leje qëndrim përjetuan kufizime serioze në mundësinë e shfrytëzimit të shkollimit, kujdesit mjekësor dhe pjesëmarrjes shoqërore. Në Kosovë, tre nga katër fëmijë të riatdhesuar romë, ashkalinjë apo egjiptianë nuk e vijonin shkollimin më për shkak të pengesave gjuhësore, mungesës së dëftesave shkollore dhe varfërisë. Dyzet për qind e fëmijëve të riatdhesuar nga Gjermania nuk kishin dokumente civile dhe përfunduan de fakto 'pa shtetësi'.

Shumë familje të riatdhesuara kishin shëndet të dobët psikologjik dhe fizik; fëmijët që vuanin nga depresioni dhe sëmundjet e tjera u lanë që vetë të ballafaqohen me to. Çdo i dyti fëmijë romë, ashkalinjë apo egjiptianë i riatdhesuar nga Gjermania jetonte në shtëpi të rrënuara në varfëri të plotë; nëntë prej tyre përfunduan që të jetojnë në kampet në Mitrovicë dhe në Leposaviq. Të çorientuar dhe të zhvendosur, këta fëmijë – sidomos ata që ishin lindur, rritur dhe shkolluar në Gjermani – u përpoqën ta pranojnë Kosovën si 'atdheun' e tyre. Programet ekzistuese për riintegrim të financuara nga Gjermania dështuan në masë të madhe t'iu ndihmojë familjeve më të lëndueshme që të riintegrohen në mënyrë të qëndrueshme. Para një viti qeveria në Prishtinë dhe institucionet komunale përgjegjëse thjeshtë i mbyllën sytë ndaj nevojave të këtyre fëmijëve; u

ndanë vetëm 100,000 euros për të ofruar strehim të përkohshëm për familjet e riatdhesuara.

Në gusht të këtij viti, UNICEF-i publikoi një raport të përditësuar të titulluar *'Pa atdhe: riatdhesimi nga Gjermania në Kosovë ashtu si është parë dhe përjetuar nga fëmijët romë, ashkalinjë dhe egjiptianë'*. Rezultatet përsëri janë bazuar në rreth 310 intervista sy më sy me fëmijët e riatdhesuar romë, ashkalinjë dhe egjiptianë dhe në më shumë se 40 intervista me zyrtarët përgjegjës në institucionet qendrore dhe komunale në Kosovë. Raporti më fundit paraqet përvojat personale të çdo të dytit fëmijë romë, ashkalinjë dhe egjiptianë të riatdhesuar nga Gjermania ose Austria më 2010. Veç Gjermania vitin e kaluar ka riatdhesuar 133 fëmijë romë, ashkalinjë dhe egjiptianë, përfshirë 94 fëmijë të moshës shkollore. Shumica e këtyre fëmijëve ishin lindur dhe rritur në Gjermani; mesatarisht familjet e riatdhesuara sot kishin jetuar në Gjermani rreth 15 vjet.

Raporti i përditësimit përpiqet të japë përgjigje në tri çështje specifike: A janë autoritetet përkatëse të Gjermanisë dhe të Kosovës duke i marrë parasysht rekomandimet e vitit të kaluar lidhur me praktikën e riatdhesimit? A ka pasur përmirësime në lidhje me politikën dhe burimet buxhetore që i kushtohen riintegrit? A ka arritur ndihma e premtuar tek familjet nevojtare dhe a iu ka ndihmuar atyre të riintegrohen në Kosovë?

Nëse shikojmë pas, shumë gjëra janë arritur gjatë dymbëdhjetë muajve të kaluar. Duke bërë përpjekje mbresëlënëse për t'i plotësuar kushtet e Komisionit

Evropian për fillimin e dialogut për vizat, qeveria e Kosovës i ka rritur fondet e ndihmës për riintegrim nga 100,000 euro në 3.4 milionë euro (për dyzet herë më shumë), ka aprovuar një Strategji të re për riintegrim dhe një plan të hollësishëm të veprimit, ka krijuar një fond për riintegrim të mbikëqyrur nga një bord ekzekutiv i përbërë nga shtatë ministritë e linjës, ka trajnuar rreth 190 zyrtarë komunalë për riintegrim dhe ka filluar të paguajë ndihma. Në krahasim me vitin e kaluar tani ekzistojnë fondet, procedurat dhe politikën e riintegrit.

Në ndërkohë, disa lande (*Länder*) gjermane po ashtu kanë marrë veprim në pajtim me rekomandimet e UNICEF-it. Çka është më e rëndësishmja, në shtator 2010, qeveria e sapo zgjedhur e Rhine Westphalia Veriore nxori një vendim i cili kufizonte dëbimin e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve të Kosovës për arsye humanitare dhe në të cilin kërkohej nga të gjitha autoritetet që në radhë të parë ta marrin para sysh interesin më të mirë të fëmijëve. Më tej autoritetet udhëzoheshin që ta shqyrtojnë secilin rast individualisht dhe t'iu shmangeshin mundimeve të tepruara. Si rezultat, numri i të miturve romë dhe ashkalinjë të riatdhesuar nga Rhine Westphalia Veriore u zvogëlua nga 30 në gjysmën e parë të vitit 2010 në 4 në gjysmën e dytë të vitit. Qeveritë e Saxony-Anhalt dhe Bremen-it nxorën vendime të ngjashme. Prej 1 korrikut të këtij viti, një paragraf i ri (25a) në *Aufenthaltsgesetz* (ligji që i rregullon të drejtat e banimit) ua mundëson të rinjve 15-21 vjeç të integruar mirë, të cilët janë lindur në Gjermani ose kanë ardhur para moshës katërmëdhjetë vjeçare që ta fitojnë të drejtën e banimit. Raporti pasues *'Pa atdhe'*, megjithatë,

dëshmon se ka shumë pak apo aspak përmirësime për pjesën më të madhe të atyre fëmijëve romë dhe ashkalinjë të cilët janë "kthyer" tashmë. Përkundrazi, kushtet e jetesës për shumicën e familjeve në të vërtetë janë përkeqësuar. Shumë familje të cilat u vizituan sërish e kishin humbur të drejtën për asistencë sociale; shumë syresh të vizituara sërish këtë vit mezi ia dilnin mbanë të blejnë bukë të mjaftueshëm për një shujtë në ditë. Të vetmit që 'fitonin' ca të ardhura të rregullta ishin ata që ishin aq të varfër sa të marrin asistencë sociale. Pesë familje, duke i përfshirë pesëmbëdhjetë fëmijë, e kanë braktisur Kosovën përsëri.

Gjëja më zhgënjyese është se, me përjashtim të dy vajzave, asnjëri prej 49 fëmijëve të moshës shkollore të portretizuar vitin e kaluar nuk kishin pasur mundësi të regjistrohen sërish në shkollë në Kosovë apo ta vazhdojnë atë. Gjendja mbetet dramatike: tre nga katër fëmijë romë dhe ashkalinjë të moshës shkollore, të cilët janë riatdhesuar në Kosovë, nuk e vijnë shkollimin.

Kjo është veçanërisht zhgënjyese duke pasur parasysh që në bazë të planit të veprimit për riintegrim janë ndarë

181,000 euro posaçërisht për ofrimin e kurseve të gjuhës, për trajnimin e mësimeve dhe për orë plotësuese. Me një Urdhëresë Administrative (17/2010) madje parashihet emërimi i një zyrtari që do të merret vetëm me regjistrimin e fëmijëve të riatdhesuar. Prej muajit qershor të këtij viti, nuk është shpenzuar asnjë cent për kurse të gjuhës ose për masat e tjera për riintegrimin e fëmijëve të riatdhesuar. Drejtorët e shkollave dhe të departamenteve komunale për arsim kanë vazhduar t'ua mohojnë fëmijëve të riatdhesuar romë, ashkalinjë dhe egjiptianë mundësinë e shkollimit.

Fusha e vetme ku ka pasur ndryshim të matshëm dhe pozitiv ka të bëjë me regjistrimin civil. Më 2010, 48 prej 116 fëmijëve të anketuar nuk ishin regjistruar. Këtë vit, të gjithë, me përjashtim të tetë fëmijëve (të cilët nuk mund të regjistrohen për shkak se iu mungojnë certifikatat e lindjes nga jashtë vendit), tani janë regjistruar. Duket që ka funksionuar qasja e zbatuar që të informohen familjet e riatdhesuara në mënyrë të hollësishme lidhur me procedurat dhe kushtet e regjistrimit dhe përcjellja e rasteve të tyre

tek OJQ-të dhe zyrat e regjistrimit civil në komunat përkatëse.

Në anën tjetër, procedurat për mundësinë e shfrytëzimit të ndihmës për riintegrim, të parapara me fondin e riintegrit, nuk kanë funksionuar siç është shpresuar. Përgjegjësinë për identifikimin e familjeve dhe përgatitjen e aplikacioneve për ndihmë e kanë zyrtarët komunalë për kthim. Vendimin përfundimtar lidhur me aprovimin apo refuzimin e kërkesave individuale e merr bordi i fondit për riintegrim. Zyrtarët komunalë për kthim janë përpjekur t'i identifikojnë dhe t'i gjejnë familjet që kanë më shumti nevojë. Në të vërtetë shumë pak aplikacione i janë përcjellë fondit për riintegrim dhe centralizimi i krejt vendimarrjes në bord është dëshmuar si i pavolitshëm dhe merr shumë kohë. Sistemi i tanishëm e bën pothuajse të pamundur gjurmimin dhe mbikëqyrjen e fondeve, të përfituesve ose të shërbimeve të ofruara. Përpjekjet e fundit nga qeveria, të cilat kanë pasur për qëllim rritjen e numrit të aplikacioneve dhe të përfituesve, ende nuk kanë dhënë rezultate.

Gjatë vitit të kaluar, Ministria e brendshme u përpoq ta marrë mbi vete





pjesën më të madhe të përgjegjësisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar; por në mënyrë që riintegrimi të jetë i suksesshëm duhet të ketë ndarje të përgjegjësisë ndërmjet institucioneve qendrore dhe të decentralizuara, qeverive në vendet dërguese dhe të vetë të kthyerve. Po ashtu edhe aktorët ndërkombëtarë siç është Bashkimi Evropian duhet ta luajë një rol të rëndësishëm.

Edhe pritjet duhet të jenë reale. Fondi për riintegrim i krijuar së fundi me siguri që nuk mundet t'i kthejë dekadat e përjashtimin shoqëror ose të ofrojë kompensim për dështimet e drejtorëve të shkollave, për tregun e punës të Kosovës ose për politikat gjermane të imigrimit. Edhe sikur të zbatohen të gjitha dispozitat e planit të veprimit për riintegrim dhe e gjithë shuma prej 3,4 milionë eurosh të shpenzohet në mënyrë efikase për ndihmën e riintegrit, shumë familje të riatdhesuara rome, ashkali dhe egjiptiane do të vazhdonin të jetonin një jetë në margjina.

Me ritmin aktual, Gjermanisë do t'i duhen edhe 37 vjet të tjera që t'i riatdhesojë të gjithë romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët që ende banojnë në Gjermani pa ndonjë

të drejtë ligjore. Ka ardhur koha për një zgjidhje politike që do t'u jap atyre fëmijëve sigurinë që mund të mbesin në Gjermani dhe më në fund t'i lëshojnë rrënjët atje.

Po ashtu nuk ka më arsye për mosveprimin e autoriteteve të Kosovës në nivel qendror dhe në atë lokal. Sidomos sa i përket regjistrimit në shkollë, ekzistojnë fondet për ofrimin e kurseve të gjuhës, lidhjen e klasave dhe masat e tjera për ta lehtësuar riintegrimin e të gjithë fëmijëve të riatdhesuar në sistemin shkollor të Kosovës, përfshirë fëmijët me nevojë të veçanta të edukimit. Vetëm duhet të shpenzohen fondet ekzistuese dhe duhet të zbatohen politikat e parapara në planin e veprimit për riintegrim.

Më tej, në mënyrë që të rritet efikasiteti dhe ndikimi i fondit për riintegrim duhet të krijohet një sistem bashkëkohor i menaxhimit të lëndëve i cili është në gjendje t'i identifikojë nevojat e të kthyerve, ta bashkërendojë ofrimin e shërbimeve ndërmjet agjencive dhe ta mbikëqyrë përparimin e arritur. Për ta mbështetur integrimin afatgjatë të familjeve më të lëndueshme, duhet po ashtu të fuqizohet sistemi i asistencës sociale i Kosovës me

para të gatshme dhe duhet të rishikohet kriteri për të drejtën e shfrytëzimit të asistencës dhe proceset e aplikimit. Gjatë viteve të ardhshme, fëmijët më të lëndueshëm romë, ashkalinjë dhe egjiptianë do të vazhdojnë të mbështeten në skemën e asistencës sociale me para të gatshme si burim i tyre kryesor i jetesës. Investimi në riintegrimin e qëndrueshëm të këtyre fëmijëve është një investim në të ardhmen e Kosovës. Prandaj, mundemi vetëm të shpresojmë që përkushtimi ndaj riintegrit, të cilin e ka treguar qeveria vitin e kaluar, do të vazhdojë edhe pas fillimit të dialogut për viza.

(Autorja është autore e raportit të përditësuar 'Pa atdhe: riatdhesimi nga Gjermania në Kosovë ashtu siç është parë dhe përjetuar nga fëmijët romë, ashkalinjë dhe egjiptianë, gusht 2011, ©UNICEF Kosovë & autorja e pjesës për Kosovën në raportin e vitit të kaluar 'Integrimi i varur nga kushtet, raport mbi gjendjen e fëmijëve romë, ashkalinjë dhe egjiptianë të Kosovës në Gjermani dhe pas riatdhesimit të tyre në Kosovë', qershor 2010, ©UNICEF Kosovë dhe Komiteti Gjerman për UNICEF-in.)

RISTRUKTURIMI I DEBATIT: RIATDHESIMET E DETYRUESHME SHIKUAR NGJA PRIZMI I TË DREJ- TAVE TË FËMIJËVE

Chelsey Lepage



Të drejtat e fëmijëve, njëloj si të gjitha të drejtat e njeriut, janë të panegociueshme. Çdo fëmijë në çdo cep të botës i gëzon këto të drejta. Të gjithë ne kemi për detyrë t'i ndihmojmë fëmijëve t'i gëzojnë të drejtat e tyre dhe vendim-marrësve t'i përmbushin detyrimet që ndërlidhen me këto të drejta. Natyrisht, këtë e shoqëron debati politik se "si të arrihet kjo". Mirëpo nuk duhet politizuar fakti që të gjithë fëmijët duhet t'i gëzojnë këto të drejta. Kjo është çështje humanizmi.

(Sebastian Sedlmayr, Udhëheqës i Avokimit dhe Edukimit për të Drejtat e Fëmijëve, UNICEF Gjermani)

Hyrje

Kur shefi i zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Johannes Wedenig, u nis për vizitë në terren në një mëngjes nëntori në vitin 2009, atij nuk i kishte shkuar ndërmend se do të takonte dy motra, tregimi i të cilave do t'ia merrte pjesën dërrmuese të dy viteve të ardhshme të jetës së tij. Dy motrat, 9 dhe 14 vjeçare, jetonin në gjendje të vazhdueshme të shokut dhe mohimit. Ato refuzonin çdo përpjekje për t'u integruar në komunitetin romë, ashkali dhe egjiptas ku jetonin, dhe nuk shfaqnin fare interesim për të komunikuar me të rinjtë e komunitetit të tyre apo për të dal nga shtëpia. Asnjëra nuk vijonte mësimet në shkollë, dhe as që kishin qenë ndonjëherë në klasë që kur ishin kthyer në Kosovë tri vite më herët. Kur i pyesnin pse, përgjigja e tyre ishte e thjeshtë: "Wir warten darauf, wieder nach Hause zu fahren." Po presim që të kthehemi në shtëpi.

Historiku

"Meqë jam nga Austria dhe flas gjermanisht, u befasova shumë kur gjatë takimit me fëmijët e këtyre komuniteteve dëgjova se flisnin rrjedhshëm gjuhën gjermane. Filluam t'i pyesim fëmijët dhe familjet e tyre prej nga vinin, dhe kuptuam që ishin kthyer me forcë nga Gjermania," thotë shefi i zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Johannes Wedenig. "Duke qenë se jemi organizata globale përgjegjëse për monitorimin universal të Drejtave të Fëmijëve, e kishim shumë të qartë se duhej të intervenonim menjëherë". Zyra e UNICEF-it në Kosovë kontaktoi Komitetin Kombëtar të UNICEF-it në Gjermani (NatCom) për ta mësuar numrin e njerëzve që do të riatdhesoheshin me forcë në Kosovë. Përgjigja të cilën e morën ishte alarmante. Numri i përgjithshëm i personave që jetonin me 'status të toleruar' të pasigurt – duke qenë kështu në rrezik të drejtpërdrejt për riatdhesim – kapte shifrën 12.000!¹ Afro gjysma prej tyre ishin fëmijë, shumica e të cilëve kishin lindur ose kishin kaluar pjesën më të madhe të jetës së tyre në Gjermani.

Ishte e pamundur të injorohej gjendja e dëshpëruar e këtyre fëmijëve dhe jeta e tyre në izolim për shkak të barrierave gjuhësore, kulturore, ekonomike dhe arsimore. Kështu lindi aleanca jokonvencionale në mes të një zyre të UNICEF-it në terren dhe Komitetit Kombëtar me qëllim të aktualizimit të të Drejtave të Fëmijëve në fushën përplot bujë mbi politikën e migrimit të Bashkimit Evropian.

Personat që punonin në terren në Kosovë menjëherë e kuptuan që nuk do të ishte në interesin e tyre më të mirë që në këto rrethana të deportonin fëmijë në një vend i cili akoma po luftonte të çlirohej nga

trashëgimia e konfliktit, varfërisë dhe korrupsionit. "Menjëherë e kuptuam që ky proces do të mund të përfshinte me mijëra fëmijë të cilët natyrshëm identifikoheshin dhe e konsideronin veten 'gjerman'. Ata e flisnin gjuhën, ishin integruar në shkallë të ndryshme në shoqërinë gjermane dhe e konsideronin Gjermaninë vendin e tyre," shpjegon zyrtari për monitorim dhe vlerësim në UNICEF, Beate Dastel. "Shumica prej tyre nuk kishin qenë kurrë në Kosovë, prandaj në sytë e tyre 'riatdhesimi' nënkuptonte deportim në një mjedis të cilin e njihnin fare pak dhe ku nuk dëshironin të shkonin. Por ç'është më e rëndësishme, kjo nënkuptonte edhe fundin e mundësive për shkollim dhe zhvillim social e profesional të cilat i kishin gëzuar në Evropën Perëndimore – gjë që ishte thjesht e papranueshme."

Kosova sot është rajoni më i varfër në Evropë me shkallë të ndjeshme të varfërisë së skajshme. Në mesin e komuniteteve pakicë në Kosovë, komunitetet roma, ashkali dhe egjiptas (RAE) janë më të marginalizuara. Sipas një raporti të Bankës Botërore në vitin 2007, më tepër se gjysma e popullsisë jeton në varfëri absolute dhe kjo gjendje i prek më së tepërmi fëmijët. Përderisa nuk ka të dhëna të sakta mbi popullsinë RAE në Kosovë, në rrethanat aktuale, aftësia për pranimin e një numri të madh të personave të kthyer me forcë është pothuajse inekzistente. Në momentin që janë kthyer në Kosovë, shumica e familjeve të riatdhesuara u lanë në pamundësi që të sigurojnë edhe nevojat e tyre më themelore. Në mungesë të regjistrave civil, këto familje nuk kishin

¹ Verena Knaus, Peter Widmann, *Integrimi i Varur nga Kushtet – raport mbi gjendjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptas nga Kosova në Gjermani dhe pas riatdhesimit të tyre në Kosovë*. UNICEF Kosovë dhe Komiteti Gjerman për UNICEF-in, 2010.

qasje as në shërbimet ekzistuese sociale, përfshirë këtu regjistrimin e fëmijëve të tyre në shkollë, marrjen e ndihmave sociale e as qasje në sistemin publik të shëndetësisë.

“Është e pamundur të mbivlerësohet ndikimi që procesi i deportimit ka pasur në jetën e këtyre fëmijëve,” thotë eksperti për monitorim në terren i UNICEF-it, Hil Nrecaj. “Së pari, ata janë ndarë nga shkollimi, moshatarët e tyre dhe aktivitetet e tyre të ndryshme jashtëshkollore. Në Kosovë ata nuk kanë shokë e shoqe. Nuk shkojnë në shkollë. Nuk marrin pjesë në aktivitete të lira (jashtëshkollore). Madje nuk e flasin as gjuhën. Ata thjesht janë të mbyllur në shtëpitë e tyre – punojnë, lajnë, pastrojnë dhe presin të martohen.”

Të vetëdijshëm për nevojën e intervenimit në terren, zyra e UNICEF-it në Kosovë kuptoi që nevojitej edhe një zgjidhje politike e cila do të pasqyronte interesat më të mira të fëmijëve. NatCom në Gjermani dhe zyra në Kosovë vendosën të zhvillojnë një hulumtim të përbashkët. Palët u pajtuan që mënyra më efektive për inkuadrin e të Drejtave të Fëmijëve në agjendën e politikave do të ishte mbledhja e të dhënave të besueshme dhe zbulimi i efekteve që procesi i riadhesimit kishte në jetën e këtyre fëmijëve në të dyja anët e kufirit.

“Për të zhvilluar një hulumtim të mirëfilltë, ju duhet të angazhoni njerëz dhe duhet të jeni në gjendje që në fund t’i prekni zemrat e njerëzve. Në të njëjtën kohë, duhet të respektoni standardet më të larta të hulumtimit në mënyrë që të jeni të besueshëm,” thotë Johannes Wedenig. “Kjo bëhet edhe më e rëndësishme kur është fjala për fëmijët. Politikbërësve dhe hisedarëve duhet t’i ofroni dëshmi të prekshme të cilat poashtu ngërthejnë dimensionin njerëzor në mënyrë që t’i angazhoni ata në aspektin intelektual dhe atë emocional. Duhet të prezantoni shembuj që ilustrjnë në mënyrë të qartë hulumtimet tuaja dhe të përfaqësoni në mënyrë të bindshme trendin në të dhënat tuaja sepse në fund të fundit është aspekti njerëzor ai i cili bart fuqinë për ndryshimin e debatit.”

Pastaj në të dy vendet u identifikuan institucionet partnere hulumtuese dhe në shkurt të vitit 2010 u promovua një fushatë e gjerë tejkufitare. Faza e parë e



fushatës përfshinte lokalizimin e familjeve të cilat ishin kthyer me forcë në Kosovë. Sipas hulumtuesve kryesor, në fillim askush nuk e dinte ku ishin këto familje dhe nuk dihej numri i saktë i tyre. Kështu ata filluan detyrën e vështirë të kontaktimit të të gjitha OJQ-ve dhe udhëheqësve të komuniteteve dhe gjetjen e secilës familje një nga një, duke dëgjuar dhe dokumentuar tregimet e tyre individuale. Vetëm pas përfundimit të raportit ata kuptuan që në fakt kishin mbuluar shumë më tepër sesa një mostër reprezentative të familjeve të riadhesuara. Duke intervistuar 40 familje dhe 173 individë, hulumtuesit kishin lokalizuar dhe intervistuar afro 40 përqind të popullatës së ndikuar.

Hollësitë e konkluzioneve u përfshin në raportin e parë i cili u botua në tetor të vitit 2010 me titullin *'Integrimi i Varur nga Kushtet: Raport mbi gjendjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptas nga Kosova në Gjermani dhe pas riadhesimit të tyre në Kosovë'*. Raporti, i cili balanconte një gamë të gjerë të dhënash me portrete prekëse mbi jetën e përditshme të fëmijëve dhe familjeve të tyre, ofroi një bazë solide për avokim të mëtejshëm.

Trasimi i rrugës për avokim të bazuar në dëshmi: prizmi i të Drejtave të Fëmijëve

Duke u mbështetur fuqishëm në studimin e përfunduar, të dyja ekipet filluan raundet e takimeve me vendimmarrësit kyç në Kosovë dhe jashtë vendit. “Që nga fillimi

ishte e qartë që pjesa kyçe do të ishte procesi që do të vijonte pas raportit,” thotë udhëheqësi i të Drejtave të Fëmijëve dhe Edukimit (UNICEF Gjermani) Sebastian Sedlmayr. “Gjetjet e hulumtimit duhej të shërbenin si bazë për vendimet e marra pas promovimit të raportit dhe duhej të dëgjoheshin rekomandimet.”

Pas takimeve me ministritë dhe politikbërësit relevant në Kosovë, u zhvilluan takime edhe me Komitetin Kombëtar Gjerman dhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Gjermanisë. Gjetjet e hulumtimit pastaj u prezantuan në Komisionin Parlamentar Gjerman për Punë të Brendshme, ku u mbajt takimi me ekspertë mbi çështjen e riadhesimit të romëve. Gjatë tërë procesit, ekipi vazhdon ta trajtoj këtë çështje nëpër forume të ndryshme evropiane, përfshirë këtu edhe Konferencën për të Drejtat Themelore në Bruksel dhe Këshillin e Evropës në Strasburg. Në të gjitha rastet, hulumtimi u prit shumë mirë. “UNICEF-i është në pozitë të veçantë për shkak të prezencës globale të organizatës. Organizata ka ekspertizë dhjetëra-vjeçare në vendet në zhvillim e sipër - nëpërmjet Komiteteve Kombëtare – si dhe në vendet e industrializuara,” shton Sebastian Sedlmayr. “Kjo është arsyeja pse UNICEF-i është në gjendje të tregoj të gjitha fazat e udhëtimit të fëmijës nga jugu në veri, dhe kthimin prapa nëse fëmija riadhesohet.”

Duket se disa faktorë kanë çuar në pranimin e suksesshëm të raportit – dhe

në mesin e të cilëve jo më pak e rëndësishme është edhe aftësia për të ndikuar në retorikën e lartë të riatdhesimit për ta pasqyruar përqendrimin e qartë tek fëmija. Meqë të gjitha vendet anëtare janë nënshkruese të *Konventës për të Drejtat e Fëmijëve*, në kombinim me Traktatin e Lisbonës, të Drejtat e Fëmijëve janë të përfshira në mënyrë të hollësishme në legjislacionin e Bashkimit Evropian. Duke pasur parasysh këtë, ekipi tejkuftar i UNICEF-it vendosi të hetoj se sa u morën parasysh interesat më të mira të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptian, gjatë procesit të riatdhesimit. Duke dokumentuar komprometimin e këtyre interesave, raporti i UNICEF-it për vitin 2010 hapi rrugë për hartimin relativisht të shpejtë të një porositë të fuqishme avokuese.

"Në fund, duhej të shikonim ku janë mundësitë, si t'i konceptojmë ato sipas vizionit tonë dhe pikën që donim ta arrinim me çështjen e të Drejtave të Fëmijëve, dhe pastaj si t'i gjejmë dhe përdorim rrjetet e ndryshme në dispozicion për t'i mbrojtur sa më mirë të drejtat e këtyre fëmijëve në Gjermani dhe Kosovë," shton Johannes Wedenig.

Koordinimi i mirë kohor u dëshmuar shumë i rëndësishëm. Aspirata e Kosovës për integrim në Bashkimin Evropian u tregua të jetë rast i veçantë për ta çuar përpara çështjen e të Drejtave të Fëmijëve (brenda Vendeve Anëtare të BE-së dhe më tej) nëpërmjet trekëndëshit specifik Kosovë-Gjermani-BE. Si njëra ndër pikat e dobëta brenda kornizës së sigurisë të Bashkimit Evropian, emigrimi mbetet çështje kyçe në procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën. Duke ofruar dëshmi për lobim strategjik prej suazave të një çështjeje e cila tashmë figuronte lartë në agjendën politike evropiane, u krijua edhe mundësia për ndikim më të madh politik në favor të drejtave të fëmijëve.

Rezultatet e arritura i tejkaluan të gjitha pritjet e para të stafit të UNICEF-it të përfshirë në këtë proces, përfshirë këtu edhe stafin e NatCom-it gjerman, të cilët kishin avokuar në partneritet të ngushtë me kolegët e tyre nga Zyra Rajonale për Evropën Qendrore Lindore me seli në Gjenevë për të drejtat e fëmijëve romë qysh nga viti 2006. "Qeveria Federale ka bërë hapa serioz në parandalimin e shkeljeve të drejtave të fëmijëve drejt dhe



në Kosovë dhe ka përkrahur ligjin e cili iu ofron leje të qëndrimit të përhershëm fëmijëve me status të toleruar mbi moshën 14 vjeçare me nivele të larta të integritit. Shtetet kryesore federale (*Länder*) kanë shpallur dekrete për t'i marrë parasysh interesat më të mira të fëmijëve para se ata të riatdhesohen në Kosovë, duke zvogëluar kështu dukshëm numrin e fëmijëve të riatdhesuar nga familjet rome nga Gjermania në Kosovë, dhe ndërkohë përkrahja për këta fëmijë në Kosovë është rritur lehtë," thotë Sebastian Sedlmayr. "Deri më tani, prizmi i të drejtave të fëmijëve ka qenë pikë e verbër në politikën gjermane të emigrimit. Gjendja e fëmijëve dhe e drejtave të fëmijëve sigurohet ka shërbyer si udhërrëfyes për debatin mbi praktikën e riatdhesimit, lejeve të qëndrimit në Gjermani dhe nevojës për përkrahjen e vendeve që nuk janë pjesë e Bashkimit Evropian."

Është e qartë që këto rezultate nuk mund t'i atribuohen vetëm fushatës avokuese të UNICEF-it, ato pasqyrojnë bashkimin e mundësive dhe partneritetit politik në mes shumë grupeve të interesit rreth një çështjeje të përbashkët. Megjithatë, UNICEF-i ka dhënë kontribut domethënës dhe konkret. Në fillim të përfshirjes së tyre në debatin rreth riatdhesimit, çështja e fëmijëve thjesht nuk shihej fare dhe ishte e zhytur në diskursin teknik i cili përqendrohej në aspektin e sigurisë. Sot, interesat

më të mira të fëmijëve përfaqësohen në mënyrë të barabartë në tavolinën e politikbërësve të Parlamentit Evropian.

Qëndrueshmëria e debatit

Përderisa në nivelin e politikave janë arritur disa suksese, shumë pak gjëra kanë ndryshuar në jetët e përditshme të fëmijëve dhe familjeve më të lëndueshme të cilat tashmë janë kthyer me forcë në Kosovë. Një vit pas botimit të raportit të parë, një numër jashtëzakonisht i vogël i fëmijëve të intervistuar vijojnë mësimet në shkollë. Shumica e familjeve ende jetojnë në kushte të mjerueshme të varfërisë dhe nuk kanë qasje në shërbime publike dhe në punësim në mënyrë që të mund ta sigurojnë mbijetesën e fëmijëve të tyre. Këto rrethana mbase theksojnë si kur më parë nevojën për qëndrueshmërinë dhe zgjerimin e përpjekjeve për avokim të mëtutjeshëm. "Roli ynë si zyre në terren nuk është vetëm të hulumtojmë. Këto janë familje dhe fëmijë jetët e të cilëve i kemi dokumentuar dhe portretizuar në raportin tonë të parë. Ne e dimë saktësisht se kush dhe ku janë, e njohim shumë mirë gjendjen e tyre. E kemi të pamundur t'ua kthejmë shpinën dhe të themi 'kaq ishte, mbaruam punë dhe tash duhet të largohemi'. Kjo thjesht nuk është e drejtë. Prandaj, aspekti etik i hulumtimit – përkthimi i tij në veprime konkrete dhe të qëndrueshme – mbetet shumë i rëndë-

sishëm për ne. Nëse nuk veprojmë mbi gjetjet tona atëherë do të dështojmë në ushtrimin e mandatit tonë për mbrojtjen e fëmijëve më të ndjeshëm në mesin tonë,” shpjegon Johannes Wedenig.

Të gjitha palët e përfshira në procesin e hulumtimit pohojnë që botimi i raportit të parë kurrë nuk është menduar si përfundim i procesit por më tepër si pedanë kërcimi për një fushatë të qëndrueshme të avokimit. “Zakonisht nevojitet së paku një vit për t’u parë ndikimet e politikave,” shpjegon hulumtuesja kryesore Verena Knaus. “Kjo poashtu nënkupton që duhet t’i vazhdoni përpjekjet e avokimit së paku për të njëjtën periudhë nëse dëshironi të keni rezultate konkrete.”

Një aspekt i strategjisë avokuese të udhëhequr nga UNICEF-i parasheh angazhimin e një këshilltari në terren i cili gjatë tërë vitit iu ndihmon familjeve të riatdhesuara të lidhen me ofruesit e shërbimeve dhe e ndjek për së afërmi gjendjen e tyre, si dhe avokon në baza individuale në emër të tyre sa herë që të jetë e nevojshme. Në shumë raste, këshilltari është dashur të trokas vazhdimisht në dyert e zyrave komunale, shkollave dhe institucioneve tjera dhe të ndjek për së afërmi çdo hap, derisa janë arritur rezultate konkrete për fëmijët dhe familjet e caktuara. Edhe pse në disa momente ky proces është jashtëzakonisht i ngadalshëm ai megjithatë mbetet shumë i rëndësishëm për ta monitoruar zbatimin e politikave në praktikë dhe mbrojtjen e shtresave më të lëndueshme. Një aspekt tjetër i strategjisë së UNICEF-it përqendrohet në dokumentimin e vazhdueshëm të gjendjes në të dy anët e kufirit, dhe përkushtimin për të ofruar mjete avokuese të mbështetura në dëshmi publike. Kjo përfshin kërkimin e vazhdueshëm të kanaleve të reja për ta aktualizuar këtë çështje anembanë Evropës, me synim të ngritjes së vazhdueshme të debatit publik mbi çështjen e riatdhesimeve të detyrueshme.

“Në këtë lloj të hulumtimit, gjithmonë duhet të punosh në dy nivele,” thotë Verena Knaus. “Së pari duhet të punosh drejtpërdrejt me politikbërësit e pastaj edhe me mediat. Mediat ngarendin pas storieve që mund t’i përdorin dhe shpërndajnë me lehtësi. Prandaj ju ia lehtësoni punën gazetarit nëse i ofroni pjesën kryesore të stories, në vend se ata të vijnë

tek ju për të marrë informata dhe pastaj ta kërkojnë storien. Hulumtimi u përcjell me bujë të jashtëzakonshme në media dhe mendoj se kjo i ka forcuar shumë përpjekjet tona.”

Grupet e gazetarëve dhe fotografëve ndërkombëtarë vazhdimisht ftohen të raportojnë për këtë çështje në Gjermani dhe Kosovë, me ç’rast UNICEF-i iu ofron atyre qasje dhe informata paraprake. Organizata partnere, *One Minute Juniors*, është angazhuar për të zhvilluar një punëtori (workshop) njëjavore me disa fëmijë dhe të rinj që janë kthyer me forcë në Kosovë. Në fund të punëtorisë, këta të rinj prezantuan videot e tyre mbresëlënëse prej 60 sekondash, duke pasur rastin kështu të shkëmbejnë storiet e tyre personale, përvojat dhe idetë me publikun e gjerë. Videot e tyre pastaj u shfaqen në disa forume, u postuan në YouTube dhe në disa faqe tjera të internetit.

Të Çrënjësor, dokumentari 22-minutash i zhvilluar në bashkëpunim me Fondacionin Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), do të transmetohet për publikun në Kosovë. Në dokumentar bëhet fjalë për një tregim prekës rreth çështjes së riatdhesimit të detyrueshëm dhe sfidave aktuale, dhe planifikohet të shfaqet në disa ngjarje dhe festivale për të drejtat e njeriut anembanë Evropës gjatë muajve të ardhshëm. Ndërkohë, një producent anglez po punon në një dokumentar tjetër për jetët e të rinjve që janë riatdhesuar dhe jetojnë në Kosovë si dhe jetët e shokëve të tyre të dikurshëm të shkollës dhe të komuniteteve në Gjermani. Të dy emisionet dokumentare pastaj do të shfaqen për të rinjtë që jetojnë në mjedise të kundërta – duke i lidhur kështu edhe një herë moshatarët e dikurshëm nëpërmjet videos. Krahësimi i mënyrës së jetesës dhe mundësive para dhe pas riatdhesimit pa dyshim do të sjell një pamje të zymtë.

“Për ne, kjo vërtetë ka të bëjë me kërkimin e vazhdueshëm të mënyrave kreative se si ta mbajmë këtë çështje të hapur dhe në mendjen e opinionit publik në mënyrë që të bëjmë presion edhe më të madh politik mbi vendimmarrësit, përveç përpjekjeve tona më të drejtpërdrejta të avokimit,” thotë Beate Dastel. “Rrethanat aktuale na dëshmojnë që mbetet akoma shumë për t’u bërë për të siguruar mbrojtjen e interesave

më të mira të fëmijëve si në aspektin e politikave ashtu edhe në praktikë. Prandaj, detyra jonë kryesore mbetet të hedhim dritë dhe ta aktualizojmë këtë çështje kudo dhe sa herë që është e mundshme.”

Përfundim

Një vit pas botimit të raportit të parë, UNICEF-i po e boton edhe raportin pasues, *Integrimi i Varur nga Kushtet: Raport mbi gjendjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptas nga Kosova në Gjermani dhe pas riatdhesimit të tyre në Kosovë, Pjesa 2*. Raporti, i cili koïncidon me transmetimin e dokumentarit të KFOS-it, flet për progresin e arritur si dhe për sfidat e mbetura dhe rekomandimet e politikave. Botimi i raportit, pa dyshim, lë shije sa të ëmbël po aq edhe të hidhur. Është arritur shumë në këtë drejtim, megjithatë mbetet akoma shumë për t’u bërë. Shtresa më e lëndueshme, sa herë që bëhet fjalë për çështjen e migrimit dhe riatdhesimit në veçanti, gjithnjë do të jenë fëmijët.

Përkundër sfidave në të ardhmen, UNICEF-i ka qëndrim të prerë. “Sipas mendimit tim, ne si UNICEF nuk mund të mos avokojmë për të drejtat e fëmijëve, kudo që janë. Çdo gjë tjetër na bën të mos jemi të besueshëm. Çdo gjë tjetër në fund të fundit do të jetë shkelje e mandatit tonë,” këmbëngul Johannes Wedenig. “Andaj, çështja kryesore është si ta funksionalizojmë këtë, apo si të sigurohemi që po e bëjmë këtë çdo herë dhe kudo që është e nevojshme, pa bërë dallime në mes të shteteve ku këta fëmijë jetojnë. Nëse ekziston një çështje në një vend të caktuar e cila në mënyrë të drejtpërdrejt dhe negative ndikon në interesat e fëmijëve që jetojnë në një vend tjetër, atëherë ne duhet të veprojmë bashkërisht për ta trajtuar këtë çështje. Në këtë drejtim, mandati ynë universal mbetet i qartë.”

(Autorja është Eksperte për avokim, UNICEF.

Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë punim janë të autores dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën apo qëndrimet e UNICEF-it. Teksti i dokumentit nuk është redaktuar sipas standardeve të botimeve zyrtare dhe UNICEF-i nuk mban përgjegjësi për gabime eventuale.)

KOSOVA: RIATDHE SIMI I POPULLATËS MË TË CENUESHME TË EVROPËS

Shkruar nga Qendra për
Dokumentim të romëve
dhe ashkalinjëve – RADC



R. B. ka jetuar në Gjermani që nga viti 1991. Fëmijët e tij shkonin në shkollë dhe ishin qytetarë shembullorë, që kurrë nuk shkaktuan probleme për qeverinë gjermane apo ligjin. Por ai ishte atje nën statusin *Duldung*, leje e përkohshme "E toleruar" për të jetuar në atë shtet e që ishte subjekt i përtrirjes çdo tre muaj. Më 12 prill 2011, ai u kthye me forcë në Kosovë.

"Policia arriti në orën shtatë të mëngjesit pa paralajmërim paraprak. Nuk më është dhënë kohë as për t'i mbledhur plaçkat e mia; nuk e mora as xhaketen time. Më kthyen me forcë në Kosovë, duke mi dhënë tetëdhjetë euro në aeroplan, tridhjetë për muai, pesëdhjetë për vajzën time", Z. B. i tregoi RADC-së përderisa rrinim në tarracën e tij në Gjakovë, të rrethuar nga familja e tij.

Të jesh në kontakt të afërt me komunitetet romë, ashkalinjë dhe egjiptas (RAE) në Kosovë, të jesh dëshmitar i kushteve të tyre të jetesës dhe të dëgjosh tregimet e tyre të dëshpërimit do të thotë të përkujtohesh se çka jemi në gjendje t'i bëjmë njëri-tjetrit. Vërtet, raca njerëzore vazhdon të gjejë mënyra për t'i nënshtruar popujt thjesht për shkak se janë ata që janë.

Unë kam pas fatin të takohem me disa anëtarë të komuniteteve romë, ashkalinjë dhe egjiptas gjatë kohës së shkurtër në Kosovë gjatë verës dhe kam mësuar nga dora e parë për vështirësitë me të cilat ballafaqohen.

Por nuk janë vetëm të rriturit që vuajnë për shkak të Marrëveshjeve për Ripranim të qeverisë së Kosovës, marrëveshje bilaterale që e rregullojnë procesin e riatdhesimit për ata që nuk kanë arritur ta

marrin shtetësinë në vendet e Evropës. Fëmijët romë, ashkalinjë dhe egjiptas, të lindur dhe të integruar në aspekt shoqëror në Gjermani, që e flasin rrjedhshëm gjuhën gjermane, janë kthyer me forcë për tu ballafaquar me një pengesë të madhe gjuhësore, shoqërore dhe të përjashtimit, si dhe me fundin e shkollimit të tyre.

"Vajza ime ishte në shkollë fillore, djali në klasën e nëntë. Të dy e flasin gjuhën gjermane. Djali im e kupton gjuhën shqipe, por nuk di të flasë", tha Z. B. kur e pyeta për fëmijët të cilët nuk kanë qenë në gjendje ta vazhdojnë shkollimin në Kosovë.

Z. B. dhe familja e tij jetojnë me vëllanë e tij me familje, vetëm një shembull i kushteve të jetesës në bashkësi me të cilat duhet të ballafaqohen romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit e kthyer me forcë në Kosovë. Shumica e të kthyerve i kanë shitur pronat e tyre për ta financuar emigrimin e tyre në vende si Gjermania. Të kthehesh me forcë në Kosovë do të thotë të jetosh me të afërmit, një ofertë e paqëndrueshme për shumicën.

"Ne jemi gjashtë persona që jetojmë në një shtëpi të vogël pa tualet. Ne duhet t'i ngrohim shishet me ujë për tu pastruar", tha Sh. B., një zotëri rom që po lufton për mbijetesë në Gjakovë.

A jeni kthyer të gjithë me forcë? pyeta unë.

"Jo," u përgjigj Z. B., "gruaja ime u kthye vullnetarisht për shkak të një deklarate të bërë nga një anëtar i mëparshëm rom i Parlamentit. Ai tha se ata që kthehen në mënyrë vullnetare do të pranojnë benefite. Kanë kaluar më shumë se dy vite dhe ajo nuk ka pranuar asgjë."

Në Pejë, P. R., i cili njëjtë si Z. B. u kthye më

12 prill 2011, vuan nga psikoza paranoike, një gjendje e diagnostifikuar nga një mjek gjerman i cili i përshkroi medikamente.

"Policia gjermane arriti në katër të mëngjesit më 12 prill të këtij viti. Nuk kam pranuar asnjë letër paralajmëruese. Pasi që arrita në Kosovë, shkova te një mjek i cili nuk desh të më trajtojë pasi që, siç tha, mbiemri im tingëllon serbisht. Nuk kam mundësi t'i marr medikamentet që më nevojiten për ta trajtuar këtë sëmundje", tha Z. R.

Shumica e atyre që janë kthyer, të papunë e me shpresa shumë të vogla për të gjetur punë, nuk marrin asnjë ndihmë sociale nga qeveria. Gjatë një interviste me Etem Arifin, përfaqësuesi i ashkalinjëve në Parlament, dhe Qazim Rahmanin, këshilltar politik në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, më është thënë se mbledhja e bordit të drejtorëve në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që e ka përgjegjësinë për marrjen e vendimit për kërkesat për asistencë sociale nga romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit e kthyer me forcë, takohet një herë në tre muaj, duke ia mohuar familjeve që kanë nevojë urgjente për asistencë por që u nevojitet aq shumë për jetën e tyre të përditshme. "Ne jemi pakicë këtu. Ne jemi të shtypur dhe të lënë anash. Qeveria e Kosovës nuk i jep prioritet romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve sepse dëshirojnë që ta bëjnë Kosovën shtet të barabartë me Evropën", tha Z. Rahmani.

Por Islam Caka, drejtor i Departamentit për Azil, Qytetarë dhe Migrim dhe anëtar i Bordit për Riatdhesim në Ministrinë e Punëve të Brendshme, e mohon faktin se bordi i drejtorëve takohet një herë në tre muaj.



"Nëse kërkesa kompletohet, rishikimi i dosjes nuk merr shumë kohë. Takimet e bordit mund të mbahen në çdo kohë dhe mund të merren veprime të menjëhershme," tha Z. Caka.

Janë disa nga ata që janë kthyer nga Gjermania të cilët i plotësojnë kushtet për të pranuar asistencë të kufizuar financiare, por kjo nuk vjen nga qeveria e Kosovës. Projekti URA 2, degë e qeverisë Gjermane, u ofron atyre që kthehen nga rajone të selektuara të Gjermanisë asistencë të para-caktuar financiare posa të arrijnë në Prishtinë.

"Secili ka të drejtë për këshillim social pa marrë parasysh prej cilës pjesë të Gjermanisë janë kthyer. Ata që kthehen vullnetarisht marrin pak më shumë asistencë se ata që deportohen. Përndryshe, ekziston buxheti për person për ata që kthehen nga katër rajonet specifike të Gjermanisë. Fakti që janë vetëm ato katër rajone është vendim politik për të cilin nuk kam njohuri për të folur", tha Birgit Budde, këshilltar banimi në zyrën e URA-s të bazuar në Prishtinë.

Me ardhjen e *Planit të Veprimit të Republikës së Kosovës për Implementimin e Strategjisë për Integrimin e Komuni-*

teteve Romë, Ashkalinjë dhe Egjiptas, 2009-2015, të nënshkruar më 2 mars, 2010 nga Kryeministri Thaqi, ata që janë pjesë e shoqërisë civile e që punojnë për avancimin e interesave të komuniteteve rome, ashkalinje dhe egjiptase mezi presin t'i shohin fjalët në letër të bëhen realitet në tërë Kosovën. Por intervistat në terren me ata që janë kthyer me forcë paraqesin një proces plot burokraci, pak komunikim në mes të ministrive apo në mes të ministrive dhe komunave, dhe pak apo aspak përkrahje të qëndrueshme, financiare apo tjetër, nga qeveria e Kosovës pasi që përdoret asistencë e URA-s deri në fund.

"Kosova nuk ka fonde për t'i përkrahur kthimet," tha Shpresa Agushi, e cila e udhëheqë OJQ-në e vet që avokon për të drejtat e romëve, "Banimi dhe papunësia janë çështje kryesore dhe nuk po shohim ndryshime të mëdha."

Xhevahire Dervishi-Rexhepi është zyrtare komunale për komunitete në Ferizaj. Kur një anëtar i kthyer nga komunitetet romë, ashkalinj dhe egjiptas i drejtohet zyrës tonë për ndihmë, ajo është përgjegjëse për mbledhjen e dokumenteve të nevojshme nga individët që të mund ta dërgojë

kërkesën për asistencë teknike në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

"Unë nuk mund ta dërgoj kërkesën në Ministri pa i pas të gjitha dokumentet e nevojshme. Unë jam e përkushtuar për t'i përkrahur njerëzit që kërkojnë ndihmë, por pa regjistrim civil dhe dokumentet ligjore si certifikata e lindjes apo dokumentimi i pronës, unë vetëm mund ta mbaj kërkesën deri sa individ i ta sjell dokumentacionin e plotë", tha Znj. Dervishi-Rexhepi pasi që u takuam me disa individë romë kërkesat e të cilëve për ndihmë nuk kanë marrë përgjigje në Ferizaj.

Kur e pyetëm për procesin e riatdhesimit si tërësi, Z. Caka theksoi se edhe pse qeveria po ballafaqohet me disa sfida, ai beson se Plani i Veprimit po zbatohet me sukses.

"Momentalisht, lidhja më e dobët në proces është në nivel komunal. Ne duhet të intervenojmë atje dhe t'i bëjmë disa përmirësime. Me të thënë këtë, ne e kuptojmë se jemi përgjegjës për qytetarët e Kosovës; ne i trajtojmë të gjithë në mënyrë të barabartë. Ekziston mekanizmi për reintegrimin e këtyre njerëzve në mënyrë të shpejtë për shkak se nuk dëshirojmë popullatë pasive," tha Z. Caka.

Siç e theksoi me të drejtë Z. Caka, qeveria e Kosovës është qeveria e parë dhe e vetme në Evropë që e ka implementuar planin për ta adresuar përfshirjen e komuniteteve romë, ashkalinjë dhe egjiptas. Kjo është sinjifikante duke pasur parasysh se çështjet e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve me të cilat ballafaqohet Evropa nuk janë të reja. Ta marrim për shembull *Dekada e Përfshirjes së Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptasve, 2005-2015*, një iniciativë me synim të mirë por pa financim të mjaftueshëm dhe me afro 12 shtete pjesëmarrëse. Edhe pse nuk është nënshkruese e Dekadës, qeveria e Kosovës, e armatosur me përkushtimin për ta krijuar një shtet ku vizionet për prosperitet dhe demokraci nuk janë vetëm fjalë të kota por principe në bazë të së cilave jetohet, mund ta kapin këtë mundësi për tu bërë model i asaj se si integrohen më së miri popujt e cenuar. Me të vërtetë, qëllimet dhe objektivat e Planit të Veprimit janë fisnike dhe mund të jenë transformuese nëse zbatohen dhe bëhen me kujdes. Shoqëria civile e lavdëron qeverinë e Kosovës për parashikimin dhe zhvillimin e Planit me shpresë për krijimin e një shoqërie të drejtë dhe gjithëpërfshirëse. Me të thënë këtë, përkundër pohimit të Z. Cakaj se mekanizmi është funksional, intervistat e mia sugjerojnë se ekzistojnë dy zbrazëtira në procesin e riatdhesimit që mund të adresohen menjëherë vetëm me një masë të vogël të vullnetit politik dhe shpenzimeve financiare.

Së pari, pasi të aterojnë në Kosovë, të kthyerve duhet tu epet një faqe në gjuhën e tyre amtare; në atë faqe duhet të listohen të gjitha dokumentet ligjore dhe të regjistrimit civil që kërkohen nga Ministria e Punëve të Brendshme për ta proceduar kërkesën për asistencë sociale. Kjo do t'i zvogëlonte, nëse jo eliminonte, të gjitha befasishtë në lidhje me kërkesat e Ministrisë, kështu që do ta shpejtonte kërkesën dhe do ta sillte më shpejt në duart e duhura.

Së dyti, e ftojme Ministrinë e Punëve të Brendshme për t'i rishikuar proceset e tyre momentale dhe për t'i alokuar fondet e nevojshme në mënyrë që zbatohet një proces gjithëpërfshirës e kujdestar i riatdhesimit, duke filluar nga momenti kur



familja ateron në aeroport. Secila familje apo individ duhet të pritët nga një përfaqësues i informuar i cili mund tu ofrojë udhëzime për procesin e riatdhesimit, ta përkujtojë familjen për dokumentet që ju nevojiten për kërkesën për asistencë dhe i cili mund të jetë i gatshëm për konsultime shtesë në të ardhme nëse familja ka nevojë për ndihmë shtesë.

Unë nuk jam naiv. E di se Kosova po ballafaqohet me shumë sfida komplekse, çështja e komuniteteve RAE është vetëm njëra nga to. Por unë i bëj thirrje të gjithëve që janë në pozitë për të bërë ndryshim pozitiv ta bëjnë mu atë. Unë ju bëj thirrje ta shfrytëzoni këtë mundësi për

t'i treguar pjesës tjetër të Evropës se qeveria dhe njerëzit e Kosovës mund të sjellin ndryshim transformues ku të gjithë që jetojnë brenda kufijve të saj, pa marrë parasysh etninë, mund të kontribuojnë për zhvillimin e shtetit dhe mund të krijojnë mundësi për ta ndërtuar prosperitetin e tyre individual.

Ashtu siç e sheh me të drejtë Znj. Agushi, "Ne jemi qytetarë të Kosovës. Ne duhet të shihemi së pari si kosovarë, jo si romë, ashkalinjë apo egjiptas."

(Ky artikull është nxjerrë nga raporti i fundit i RADC-së "Kosova: Riatdhesimi i Popullatës më të Cenueshme të Evropës", të botuar në korrik 2011)

NJË VËSHTRIM PRAPA, DHE TË SHIKOSH VJEDHURAZI NË TË ARDHMEN

Strategjia për Integrimin
e Komuniteteve Roma,
Ashkali dhe Egjiptase në
Republikën e Kosovës.

Muhamet Arifi
dhe Rand Engel



Procesi i hartimit dhe zbatimit të “strategjisë” për përfshirjen e komuniteteve roma, ashkali dhe egjiptase po zgjat më tepër se gjashtë vite, prandaj, është mirë të flitet për progresin e arritur si për dhe sfidat e mbetura. A po përfitojnë këto komunitete kosovare nga strategjia në fjalë – a janë në gjendje këto komunitete të marrin pjesë në mënyrë më të barabartë në jetën, politikën dhe ekonominë kosovare? A po përmbushen premtimet direkte dhe ato të nënkuptuara të Kosovës dhe akterëve ndërkombëtarë, të mishëruara në “Strategjinë për Integrimin e Komuniteteve Roma, Ashkali dhe Egjiptase në Republikën e Kosovës”¹? Në vijim do të përqijemi të ofrojmë së paku disa përgjigje në këto pyetje.

Historiku i Strategjisë, 2005-2008

Hapi i parë drejt hartimit të strategjisë ishte iniciativa e shoqërisë civile, më konkretisht konferenca e mbajtur më 17 korrik 2005 nën organizimin e Forumit të Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve mbi zhvillimin e Sektorëve Prioritar të Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve, nëpërmjet Strategjisë Specifike. Në konferencë morën pjesë përfaqësues politik, Zyra Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit, përfaqësues të shoqërisë civile nga radhët e komunitetit roma, ashkali dhe egjiptian, OSBE-ja, Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS/SOROS) si dhe hisedarë të tjerë.

Palët më aktive në procesin e nisur ishin Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit, OSBE-ja, KFOS-i dhe tri komunitetet. Ministrinë e ndryshme poashtu dhanë kontributin e tyre. U theme-

luan grupet punuese të cilat u përquenduan në 11 aspekte të jetës që do të trajtoheshin në dokumentin strategjik: anti-diskriminimi, arsimit, kultura, mediat dhe informimi, strehimi dhe vendbanimet joformale, punësimi dhe fuqizimi ekonomik, shëndetësia dhe çështjet sociale, kthimi dhe reintegrimi, regjistrimi dhe dokumentacioni, çështjet gjinore, pjesëmarrja dhe përfaqësimi në politikë, dhe siguria. Me synim të inkurajimit të pjesëmarrjes, grupet punuese zhvilluan takime me komunitetet në mbarë Kosovën. Shumicës së grupeve punuese iu deshën dy vite për ta përfunduar detyrën e tyre, edhe pse grupi punues për arsimin i kryesuar nga Qendra për Arsim e Kosovës, ishte në gjendje ta hartoj Strategjinë e Arsimit më shpejt se të tjerat dhe e prezantoi atë së bashku me planet e veprimet dhe buxhetin në nëntor të vitit 2007.

Drafti përfundimtar i Strategjisë u diskutua më 29 nëntor 2008 në konferencën e mbajtur në Grand Hotel, në Prishtinë. Strategjisë i mungonte plani i veprimit dhe buxheti. Disa OJQ dhe individë nga tri komunitetet ishin të pakënaqur dhe pohonin që nuk kishin pasur kohë të mjaftueshme për të komentuar në draftin përfundimtar madje as në mënyrë elektronike. Në versionin përfundimtar të draftit nuk ishin përfshirë shumë komente të hisedarëve, posaçërisht ato të pjesëtarëve të komuniteteve roma, ashkali dhe egjiptase. Në përgjithësi, në atë fazë të procesit, shoqëria civile dhe partitë politike të tri komuniteteve ishin në favor të Strategjisë, përveç partisë politike egjiptiane Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK).

Më 24 dhjetor 2008, Qeveria e Kosovës e

miratoi Strategjinë për Integrimin e Komuniteteve Roma, Ashkali dhe Egjiptase 2009 – 2015.

Plani i veprimit² i Qeverisë së Kosovës për zbatimin e Strategjisë u prezantua në mars të vitit 2010. Në hyrje të dokumentit, Kryeministri Hashim Thaçi shkroi, “Plani i Veprimit duhet të shihet si mjet i fuqishëm për arritjen e qëllimeve fundamentale, të cilat janë kyçe për përmbushjen e të drejtave të pakicave – pjesëmarrja, përfshirja dhe përmbushja e obligimeve. Me këtë rast, i ftoj institucionet publike të Kosovës, akterët e shoqërisë civile, komunitetet roma, ashkali dhe egjiptase dhe bashkësinë ndërkombëtare ta shfrytëzojnë këtë rast, dhe të punojnë së bashku për uljen e varfërisë, për qeverisje më demokratike dhe më përfshirëse dhe për stabilitet më të madh në shoqërinë kosovare.”

Konteksti Ligjor dhe Politik

Kushtetuta e Republikës së Kosovës u hartua, duke marr parasysh edhe masat specifike që u propozuan në Pakon e Ahtisaarit. Përveç përfshirjes së dokumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në Kushtetutë, Qeveria e Kosovës poashtu u përkushtua se do të përdorte masa afirmative për ta përmirësuar më shpejt gjendjen e këtyre tri komuniteteve. Nga këndvështrimi i Bashkimit Evropian, zbatimi i Strategjisë paraqet element kyç të kriterëve të BE-së të cilat Kosova duhet t’i përmbush për të hyrë në procesin e anëtarësimit në BE. Strategjia mund të shihet edhe si pasqyrim i kornizës së BE-

¹ http://www.roma-kosovainfo.com/index.php?option=com_docman&task=doc_download&gid=66&Itemid=

² <http://www.aktion302.de/fileadmin/aktion302/Kosovo-Integration-RAE-2009-2015.pdf>

së për të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e pakicave, si dhe e rezolutave dhe marrëveshjeve themelore të OKB-së për të Drejtat e Njeriut. Konteksti i Bashkimit Evropian bart në vete edhe implikime të tjera, posaçërisht financiare – përfshirjen në Dekadën e Romëve, fondet e BE-së, fondet nga Fondi Arsimor Roma (REF), etj. Poashtu mund të thuhet që qëllimi themelor i disa vendeve anëtare është riatdhesimi i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në Kosovë, dhe ata janë veçanërisht të interesuar që Strategjia ta lehtësoj procesin e kthimeve.

Konferenca me titullin *BE-ja dhe Përfshirja e Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve – Rruga përpara për Kosovën*³, u mbajt më 11 maj në Prishtinë, nën kryesimin e Pierre Mirel, Drejtorit për Ballkan Perëndimor në Komisionin Evropian. Sa i përket mangësive të perceptuara në zbatimin e Strategjisë, BE-ja ka botuar 40 veprime të propozuara për ta rritur procesin e zbatimit.

Përgjegjësitë

Meqë Qeveria e Kosovës ka marr përsipër përgjegjësinë e plotë për integrimin e komuniteteve roma, ashkali dhe egjiptian, atëherë është e logjikshme që agjencitë e caktuara të qeverisë do të merrnin përsipër detyra për përmbushjen e këtij qëllimi. Në fakt, disa hisedarëve të qeverisë u janë caktuar këso detyra⁴. Përgjegjësitë specifike poashtu mund të ndahen në mes nivelit qendror dhe komunave. Në nivelin qendror, përgjegjësia e parë është tek qeveria e Kryeministrit dhe kjo është nën kompetencën e Zyrës Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore (ZKQM). Grupi Punues Teknik për Planin e Veprimit (GPT), i emëruar nga ZKQM-ja, duhet të bashkërendoj zbatimin, të shkëmbej informata me hisedarët, ta mbikëqyr dhe vlerësoj zbatimin, dhe të hartoj e prioritetizoj politikat. Këto qëllime përfshijnë edhe harmonizimin e investimeve të qeverisë dhe ato të donatorëve, zgjidhjen e çështjeve buxhetore, dhe përgatitjen e raportit mbi zbatimin e strategjisë dy herë në vit. Pika e fundit është e trajtuar më poshtë. GPT-ja përbëhet nga 11 anëtarë dhe kryesohet nga drejtori i ZKQM-së, shërbyesit e lartë

civil nga ministri dhe agjenci të ndryshme, KFOS-i, Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian, USAID-i, dhe një anëtar i Këshillit Konsultativ të Komuniteteve (KKK).

Komiteti Drejtues i nivelit të lartë u emërua për ta rishikuar procesin e punës. Komiteti Drejtues kryesohet nga Zëvendës Kryeministri, përfshin disa ministra, përfaqësues të tri komuniteteve, dhe një përfaqësues nga KKK-ja. Komiteti takohet çdo gjashtë muaj për ta vlerësuar procesin e zbatimit dhe për të miratuar raportet mbi procesin e zbatimit. Deri tani janë mbajtur dy takime. Këshilli Konsultativ për Komunitete (KKK) përbëhet nga përfaqësues të të gjitha grupeve jo-shumicë në Kosovë. Këshilli vepron nën patronazhin e Presidentit të Kosovës. KKK-ja krijoi Grupin Punues (GP) për çështjet e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve. Agjencitë tjera qeveritare që mund të përfshihen janë Ministria për Kthim dhe Komunitete (MKK), Zyra për Çështjet e Komuniteteve (ZÇK) pranë Zyrës së Kryeministrit, Njësitë Ministrore për të Drejtat e Njeriut, Ombudspersoni, etj.

Në nivel komunal, Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete (ZKKK), ish-Zyra Komunale për Komunitete (ZKK), duhet ta bashkërendoj procesin e zbatimit të Strategjisë. Departamentet tjera komunale, siç janë departamenti i arsimit, i shëndetësisë, i punës e të tjerë, mund të përfshihen sipas nevojës.

Pengesat në Procesin e Zbatimit

Asnjë pjesëmarrës në procesin e Strategjisë nuk mund të ketë pritur një proces të rrjedhshëm e të shpejtë të zbatimit, dhe nuk mund të thuhet që do të befasoheshin nga realiteti aktual. Edhe pse flitet për një qasje proaktive me diskriminim pozitiv, për ata të cilët presin të përfitojnë nga këto ndryshime, procesi i zbatimit është jashtëzakonisht i ngadalshëm. Në realitet, shumica e komponentëve të planit të veprimit akoma nuk janë financuar nga qeveria, nuk janë përkrahur me plane të veprimit, janë plotësisht të panjohura për nivelin komunal, dhe (prandaj, natyrisht) nuk gëzojnë asnjë linjë buxhetore komunale apo buxhet në çfarëdo forme, për përmbushjen e tyre. Në vijim kemi paraqitur disa pengesa serioze në procesin e zbatimit:

- Planet e veprimit janë pothuajse plotësisht të pafinancuara. Me fjalë tjera, as ministritë dhe as zyrat komunale nuk kanë ndonjë linjë buxhetore për zbatimin e strategjisë.
- Komunitetet – një numër relativisht i vogël i aktivistëve – i kanë kushtuar energji të konsiderueshme grupeve të tyre punuese, konferencave për strategjinë, etj. Ata akoma po presin rezultate – dhe janë të lodhur. Ekziston përshypja që “premtimet” – reale apo të nënkuptuara – nuk po përmbushen.
- ZKKK-të kanë kapacitete tejet të kufizuara – kapacitete që të bëjnë çka nuk kanë bërë, të hartojnë linja buxhetore dhe të kërkojnë fonde. Shpeshherë ato nuk kanë përfaqësim adekuat të komuniteteve roma, ashkali dhe egjiptiane. Ndodh që ato janë plotësisht të përqendruara tek komuniteti serb.
- Në mesin e komuniteteve roma, ashkali dhe egjiptiane ekziston përshtypje mjaft e përhapur që pakica serbe ka më tepër gjasa të përfitoj çka të dojë nga Ministria për Kthim dhe Komunitete sesa këto komunitete.
- Departamentet komunale shpeshherë nuk janë të vetëdijshme që ekziston Strategjia për Komunitetet Roma, Ashkali dhe Egjiptiane. Si mund të dinë çka të bëjnë me të, kur nuk e dinë se “ajo” ekziston. Për shembull, OSBE-ja ka organizuar disa takime kohëve të fundit në pesë komuna në të cilat u pa qartë që drejtorët e departamenteve nuk kishin fare njohuri për Strategjinë.
- Disa drejtorë, kuadro dhe departamente të komunave mund të mos jenë të gatshëm të bëjnë atë që duhet për financimin e një Plani të Veprimit.
- Në shumë komunitete, ZKKK-ja nuk është funksionale. Në disa komunitete tjera ku ZKKK-ja është funksionale ajo mund të mos ketë fare përfaqësim të tri komuniteteve.
- Udhëheqësit politik të komuniteteve duhet t’i përdorin kapacitetet e tyre politike – votat dhe rrjetet – për të avokuar për buxhete për zbatimin e Strategjisë.

³ http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/press_corner/all_news/news/2011/20110621_01_en.htm

⁴ http://www.ecmi-map.com/map/index.php?option=com_content&view=category&layout=blog&id=35&Itemid=62&lang=en

- Qeveria e Kosovës ka prioritetet tjera dhe kufizime reale për financim. Në plan afatgjatë, qeveria mund të përkushtohet për përmbushjen e mandatit të saj kushtetues – mirëpo në planin afatshkurtër nuk ka fonde. Përveç kësaj, duke marr parasysh që kjo është agjendë e imponuar, disa nuk do të jenë aq të gatshëm ta trajtojnë këtë si prioritet.
- Deri në botimin e raportit të ZKQM-së, qeveria e ka monitoruar pak procesin, edhe pse ka pasur raporte të ndryshme nga OJQ-të ndërkombëtare dhe vendore.
- Buxheti i Kosovës për vitin 2012 – si në vitet e kaluara – nuk ka fonde të alokuara posaçërisht për zbatimin e Strategjisë.

Raporti i Parë

Rishikimi i parë i dokumentit strategjik,

Raporti Vjetor mbi Planin e Veprimit për Zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Roma, Ashkali dhe Egjiptase në Republikën e Kosovës 2009 – 2015, përgatitur nga Grupi Punues Teknik u botua për herë të parë në maj të vitit 2011. Synimi që një raport i tillë të botohej çdo gjashtë muaj nuk u realizua me gjasë për shkak të raportimit të vonshëm nga ministritë dhe hisedarët e tjerë. Raporti është i dobishëm dhe paraqet kontributin e parë për themelimin e rolit të qeverisë për ta monitoruar dhe çuar përpara Strategjinë. Me 210 faqe, raporti përfshin përmbledhje të shumë informatave, siç u mbledhën nga ministritë, departamentet dhe komunat. Informatat mund të jenë shumë të dobishme për bashkëpunim në mes hisedarëve, për përshtatjen e buxheteve dhe për caktimin e agjendave realiste.



Në të njëjtën kohë, siç edhe mund të pritet nga një raport i parë, janë evidencuar disa të meta. Edhe pse është shfrytëzuar kohë shtesë, në fund shumë komuna nuk kanë raportuar duke pohuar që nuk e kanë ditur këtë. Raporti iu prezantua Komitetit Drejtues më 5 maj 2011, me kërkesë për miratim të menjëhershëm. Kur KD-ja nuk u pajtua, atyre iu dha afat 24-orësh për të komentuar. Aktivistët e komuniteteve nuk ishin të kënaqur me kohën e lejuar për lexim, mendime dhe komente. Një problem tjetër ishte që në pjesën ku raporti përfshin informata për një numër të madh aktiviteteve për zbatimin e Strategjisë, ai nuk e bën dallimin e plotë në mes të aktiviteteve të qeverisë dhe atyre të shoqërisë civile. Kjo mund të krijoj përshtypjen që qeveria po e kryen tërë punën – derisa shumica e projekteve dhe investimeve bëhen nga ana e shoqërisë civile – donatorëve dhe OJQ-ve vendore dhe ndërkombëtare. Në raport nuk janë shënuar buxhetet. Nuk ekziston mënyra për të krahasuar se çka parashikojnë Strategjia dhe Planet e Veprimet për nevojat buxhetore për zbatimin e Strategjisë dhe çka shpenzohet në të vërtetë. Aty thuhet që pjesëtarët e komuniteteve marrin beneficione nga qeveria, siç është asistencë sociale. Por meqë të gjithë njerëzit e varfër që janë në gjendje të ngjashme përfitojnë nga kjo asistencë, atëherë kjo në të vërtetë nuk paraqet shembull për zbatimin e Strategjisë, pasi që procesi i Strategjisë përfshin në vete diskriminimin pozitiv. Për më tepër, disa aktivitete të raportuara nuk kishin fare të bënin me komunitetet roma, ashkali dhe egjiptian, duke lënë të kuptohet se jo vetëm që komunitetet nuk kishin kohë ta komentonin raportin, por as ZKQM-ja nuk kishte kohë të rishikonte se çka kishte pranuar para afatit përfundimtar për botimin e raportit.⁵ Poashtu duket që ka raste kur njësi qeveritare (Ministria, komuna, etj.) ka bërë më tepër sesa që është raportuar në Raport Vjetor.⁶

Këndvështrimi Aktual

Raporti i Grupit Teknik Punues pranë Zyrës Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë, i botuar në maj të këtij viti, edhe pse nuk është e kompletuar plotësisht,

mbetet pasqyra më e mirë deri më tani. Është vështirë të shihet se çka po shpenzohet dhe ku dhe si mund të krahasohet kjo me nevojat e projektuara. Programet më të mëdha përfshijnë kthimin e personave të zhvendosur nga kampet në pjesën veriore të Kosovë në lokacione tjera, në Mëhallën Rome në Mitrovicë, dhe në disa vende tjera. Si pjesë e këtij programi, deri më tani 200 familje janë rivendosur në pjesën jugore të qytetit të Mitrovicës, me ndihmën e OJQ-ve ndërkombëtare dhe vendore (Mercy Corps, Këshilli Danez për Refugjatë, RADC, KAAD) dhe donatorë tjerë duke përfshirë USAID-in dhe Komisionin Evropian.⁷ Përfshirja e komunës në legalizimin e risistemimit dhe lehtësimit të kthimeve është më e theksuara në qytetin e Mitrovicës, Gjilanit dhe Gjakovës (lagja Ali Ibra). Në arsim dhe kulturë, Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) vazhdon të ketë rol udhëheqës, siç ka pasur që disa vite, në përkrahje të zbatimit të Strategjisë, dhe në financimin e projekteve. Projektet kryesore arsimore kanë qenë Rrjeti i Qendrave të Mësimi i Balkans Sunflowers (BSF),⁸ projekti i iniciuar rishtazi i Qendrës për Arsim të Kosovës (KEC) – KFOS për qendrat e mësimi dhe komunitetit, përkrahur nga Bashkimi Evropian, dhe programet arsimore të Zërit të Romëve, Ashkalijve dhe Egjiptianëve me përkrahje nga Swiss Development dhe HEKS (Swiss Interchurch Aid), Bethany Christian, Iniciativa 6, dhe Caritas. Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji (MASHT) ka hartuar programin e gjuhës rome i cili u promovua në Prizren në shtator të vitit 2011. Yekhipte dhe Durmish Aslano kontribuojnë në pasurimin e mediave dhe kulturës. Programi për të Drejtat Civile Kosovë (CRPK) dhe Qendra për Dokumentimin e Romëve dhe Ashkalive (RADC), me përkrahje të UNICEF-it, ka disa vite që është përfshirë në procesin e regjistrimit civil. Disa projekte që gjenerojnë burime në Kosovë kanë bërë orvatje të veçanta për të përfshirë pjesëtarë të komuniteteve roma, ashkali dhe egjiptiane – mirëpo, shkalla e papunësisë në mesin e këtyre komuniteteve akoma mbetet mbi 90%. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) vazhdon të monitoroj



gjendjen e përgjithshme në fushën e drejtave të njeriut, si dhe në veçanti zbatimin e Strategjisë, përfshirjen e pakicave, dhe kontribuon në trajnime në arsim, media dhe politikë.

Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave (QEÇP) është dëshmuar agjencia udhëheqëse për trajnimin dhe këshillimin e ZKQM-së, KKK-së dhe komunave. QEÇP dhe BSF do të bashkëpunojnë, me përkrahjen e UNICEF-it, në përmirësimin e zbatimit të Strategjisë në Fushë Kosovë. Në partneritet me People in Need, dhe me përkrahjen e Agjencisë Çeke për Zhvillim, BSF po zhvillon një projekt në 10 komuna për zbatimin e mëtutjeshëm të Strategjisë nëpërmjet informimit, zhvillimit të grupeve punuese lokale, monitorimit dhe iniciativave që synojnë përmbushjen e përkushtimeve të qeverisë nëpërmjet planeve të komunale të veprimit dhe buxheteve të komunave. Edhe pse të gjitha këto përpjekje e përkrahin zbatimin e Strategjisë, ka shumë pak bashkërendim të këtyre përpjekjeve në mes donatorëve apo zbatuesve, nuk ka vlerësim të mjaftueshëm të ndikimit, duplikimeve apo përqendrimit tek prioritetet.

Të Shikosh Vjedhurazi në të Ardhmen

"Të shikosh vjedhurazi në të ardhmen" është sikur takimi i personazhit kryesor

me fantazmën e Krishtlindjeve të së ardhmes në tregimin e Charles Dickensit *"Një Histori Krishtlindjesh"*. Në këtë tregim, fantazma e paralajmëron personazhin kryesor se duhet ta ndryshoj sjelljen përndryshe në të ardhmen do të mbetet i vetmuar, i padobishëm dhe i humbur. "Çfarë duhet të bëjë për t'iu shmangur kësaj," pyet personazhi. Fantazma nuk flet, por përgjigja duket të jetë, "Varet nga ti se a do të përpiqesh të ndryshosh apo jo. Ti vendos". Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian do të zbatohet nëse ministritë dhe komunat i miratojnë planet e veprimit, i qasen me seriozitetin e duhur zbatimit të planeve të veprimit në praktikë dhe ndajnë fonde për këto aktivitete. Nëse këto fonde nuk figurojnë në linjat buxhetore, atëherë i tërë procesi, që nga viti 2005 e këtej, do të duket vetëm një premtim i zbrazët.

⁵ Për shembull, në fund të raportit të hollësishëm prej 3 faqesh për procesin e kthimit në Dragash thuhet se nuk ka pasur asnjë rast të kthimit të romëve, ashkalive apo egjiptianëve.

⁶ Kryetari i komunës së Lipjanit, në një takim rishtazi, i përmendi disa raste të kontributeve domethënëse të komunës në dokumentin strategjik të cilat fare nuk ishin përfshirë në Raportin Vjetor.

⁷ Raporti Vjetor për zbatimin, f 209, përmend afërsisht €15 milion të shpenzuara në projektet e kthimit dhe risistemimit por këto figura nuk përfshijnë të gjitha projektet e kthimit dhe risistemimit të përmendura në pjesët tjera të raportit.

⁸ Autorët e këtij artikulli janë drejtorët e Balkan Sunflowers. Ky projekt është përkrahur nga Fondacioni Sunshine Lady, UNICEF-i, KFOS-i, People in Need, Agjencia Çeke për Zhvillim, Ambasada Amerikane, Ambasada Norvegjeze, Agjencia Austriake për Zhvillim, OSBE-ja, Zyra e Luksemburgut, Ambasada Finlandeze, Ambasada Holandeze, Ambasada e Britanisë së Madhe, dhe të tjerë.

ROMËT, ASHKALIJËT DHE EGJIPTASIT SFIDA EVROPIANE

Vera Pula



Gjysma e parë e këtij viti filloi me zhvillime shumë pozitive për komunitetin rom në skenën Evropiane. Kërkesa e BE-së për të gjitha shtetet anëtare për t'i rishikuar përkushtimet e tyre për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe përfshirjes sociale të romëve përmes hartimit të rundit të dytë të strategjive kombëtare e vërteton këtë. Kjo kërkesë nuk i lë anash shtetet për zgjerim, rajonin e Ballkanit dhe Turqinë; me siguri se kjo do të jetë pjesë e agjendës së dialogut për zgjerim të Komisionit Evropian për këto shtete. Deklarata në Komunikatën e Komisionit të drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social të Rajoneve¹, dokument i cili thekson se marginalizimi, diskriminimi, jotoleranca, pozita e varfër socio-ekonomike dhe të tjera të romëve në Evropë nuk është e pranueshme në fillim të shekullit 21 në BE, dëshmon përkushtim të fortë të strukturave të BE-së për ta përmbyllur hendekun në mes të romëve, komunitetit pakicë më të madh në Evropë, dhe jo-romëve. Lëvizja rome në tërë Evropën çdo ditë është më e fortë dhe më e mobilizuar në kërkesat për pëmbushjen e të drejtave të njeriut, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe barazi për anëtarët e vet.

Iniciativa e re e BE-së e gjen Kosovën me një Strategji për Integritimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas, mirë të zhvilluar dhe në vitin e saj të dytë të zbatimit. Shumë donatorë janë të përfshirë momentalisht në zbatimin e Strategjisë dhe një numër i tyre i kanë shtuar përpjekjet e tyre dhe i kanë rritur kontributet duke i përkrahur sektorët specifik të Strategjisë dhe aktivitetet e saj përkatëse që synojnë përmirësimin e jetës së këtyre komuni-

teteve. Edhe pse buxheti i Kosovës është ndikuar nga kriza globale dhe fondet në dispozicion për Strategjinë janë të pamjaftueshme për të siguruar pëmbushjen e objektivave të saj, duhet të përmendet se një numër i aktivitetëve që nuk kërkojnë investime të mëdha janë momentalisht duke u financuar nga buxheti i Kosovës. OJQ-të e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve kanë demonstruar iniciativë duke qenë të përfshirë në mënyrë aktive dhe duke zbatuar shumë aktivitete të përcaktuara në dokumentin e Strategjisë. Por, a është kjo e mjaftueshme? A do ta konsiderojë BE-ja se Qeveria e Kosovës e ka kryer punën e vet vetëm duke i hartuar këto dokumente?

Edhe pse fillimi i procesit të zbatimit të Strategjisë RAE në **Kosovë** duhet të mirëpritet, gjithashtu mund të vijmë në përfundim se ka mbetur edhe shumë për tu bërë. Pothuaj se të gjitha veprimet për pëmbushjen e objektivave të specifikuar në Planin e Veprimit deri më tash janë zbatuar përmes fondeve të siguruar nga donatorët dhe institucionet ndërkombëtare që janë prezente në Kosovë, dhe në mënyrë sporadike përmes buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Është koha që Qeveria e Kosovës t'i rishikojë zotimet dhe vullnetin e saj politik në lidhje me zbatimin e Strategjisë RAE duke e vendosur atë në mesin e prioritetëve të saj dhe menjëherë të ndajë burime të mjaftueshme për të siguruar zbatimin e saj dhe pëmbushjen e objektivave, siç janë specifikuar në Planin e Veprimit përmes procesit të planifikimit të buxhetit vjetor, vazhdimësisë dhe koordinimit në mes të institucioneve përgjegjëse për veprim.

Mungesa e koordinimit, prioritetizimit të

objektivave, shkëmbimit të informatave në mes të institucioneve qeveritare, donatorëve dhe OJQ-ve si dhe mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit për zbatimin e Strategjisë RAE vetëm sa po e pengojnë procesin e zbatimit të saj, dhe si rezultat edhe përmirësimin e kushteve të jetesës së tri komuniteteve. Prandaj Qeveria e Kosovës duhet të marrë rol udhëheqës në këtë proces duke i vënë në funksion të plotë organet qeverisëse dhe koordinuese përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Veprimit, respektivisht Grupi Punues Teknik për Planin e Veprimit dhe Këshilli Drejtues Ndër-Institucional. Të dy këto organe duhet t'i vëzhgojnë me kujdes termat e referencës dhe procedurat siç kanë përcaktuar në dokumentin e Planit të Veprimit, dhe dekretet e qeverisë. Këto dy organe duhet të përcaktojnë grupe të veprimeve të cilat duhet të zbatohen me prioritet, të sigurojnë buxhetin e nevojshëm dhe të kërkojnë veprime të menjëhershme që duhet të ndërmerren nga institucionet përgjegjëse.

Pamja në nivelin lokal administrativ, ku ndodh çdo gjë, nuk është në situatë më të mirë. Edhe kapaciteti i personelit të komunës për të hartuar dhe zbatuar politika edhe aftësia për të gjeneruar burime financiare, mbeten të pamjaftueshme dhe sfidë e vazhdueshme për Planin e Veprimit që të ketë ndikim në nivelin lokal. Krijimi i bazës së të dhënave dhe sistemit të mbledhjes së tyre të cilët do të ndihmojnë përcjelljen e progresit të arritur përderisa zbatohet Plani i Veprimit duhet të vendoset pa vonesë; përndryshe nuk do të jetë e mundur të matet progresi as në afat të

¹ http://ec.europa.eu/justice/policies/discrimination/docs/com_2011_173_en.pdf

shkurtër e as në afat të gjatë. Fonacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur i ka bërë dy studime në vitin 2009; njëri për pozitën socio-ekonomike të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas² dhe tjetri për kapacitetin e qeverisë në të dy nivelet për zbatimin e Strategjisë³. Të dyja janë dokumente të vlefshme të cilat mund të përdoren edhe nga institucionet qeveritare edhe nga komuniteti ndërkombëtar që është prezent në Kosovë dhe shoqëria civile për planifikimin e iniciativave apo për matjen e ndikimit të të njëjtave më vonë. Marrja e statusit të "vëzhguesit" në Këshillin Drejtues Ndërkombëtar të Dekadës së Përfshirjes së Romëve 2005-2015 është padyshim një arritur që meriton përgëzim; megjithatë qeveria nuk do të duhet të jetë e kënaqur me këtë status në njërin nga institucionet më të rëndësishme që synon përmirësimin e romëve në Evropë. Qeveria e Kosovës duhet të tregojë përkushtim të vërtetë për të qenë anëtare e plotë në Dekadën e Romëve duke e emëruar institucionin përgjegjës për mbajtjen e kontakteve dhe konsultimeve të mëtutjeshme me Sekretariatit e Dekadës për përgatitjen e të gjitha strukturave dhe mekanizmave të nevojshëm për tu bërë anëtare e plotë dhe në fund të zotojë buxhetin e nevojshëm për këtë qëllim. (Shënim: Anëtarësimi i plotë i Kosovës në Dekadën e Romëve mbetet sfidë dhe e pasigurt për shkak të mungesës së pranimit të pavarësisë së saj nga pesë shtete anëtare të BE-së, tri nga të cilat janë anëtare momentale të Dekadës së Romëve). Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për vitin 2010 ishte mjaft kritik ndaj qeverisë së Kosovës, duke përfshirë këtu edhe progresin e zbatimit të strategjisë RAE dhe Planit të saj të veprimit, dhe në përgjithësi përmirësimin e kushteve të jetesës për këto tri komunitete⁴. Raporti i ri për vitin 2011 është gati për tu prezantuar dhe nuk pritet të jetë më pozitiv se ai paraprak. Perspektiva e secilit shtet që synon anëtarësimin në BE varet shumë nga gjetjet e prezantuara në raportin e progresit, kjo poashtu vlen edhe për Kosovën. Sipas logjikës së Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asocimit me 11 maj në Prishtinë u mbajt konferenca "BE-ja dhe përfshirja romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve – Rruga Përpara për Kosovën". Kjo konferencë një-



ditore e bashkë-udhëhequr nga Drejtori për Ballkanin Perëndimor në DG për Zgjerim, Z. Pierre Mirel dhe Ministrija për Integrim Evropian, Znj. Vlora Çitaku u mbajt në nivel shumë të lartë institucional, me pjesëmarrje të organizatave kryesore vendore dhe ndërkombëtare, donatorëve dhe shoqërisë civile, doli me një listë prej 40 rekomandimeve për të dy nivelet e qeverisjes dhe dëshmoi e theksoi edhe një herë rëndësinë e procesit të integritit dhe përfshirjes së komuniteteve romë, ashkalinjë dhe egjiptas për aspiratat e Kosovës për tu bërë shtet anëtar i Bashkimit Evropian. Këto rekomandime duhet të merren shumë seriozisht nga qeveria dhe organet tjera zbatuese nëse dëshirojmë të marrim vlerësim më pozitiv nga Komisioni Evropian, së paku në vitin 2012, por ajo që është më me rëndësi është se duhet të jemi të përkushtuar për përmirësimin e pozitës dhe mirëqenies së këtyre komuniteteve në

Kosovë dhe të ndihmojmë në kërkimin e tyre për shoqëri të drejtë dhe ruajtje të dinjitetit njerëzor.

Autori është Koordinator i Programeve në Fondacionin Kosovar për Shoqëri të Hapur. Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë artikull janë të autorit dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht politikat dhe këndvështrimet e KFOS-it.

(Autorja është Koordinautore e Programeve në Fondacionin e Kosovës për Shoqëri të Hapur.

Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë artikull janë të autorit dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht politikat dhe këndvështrimet e KFOS-it.)

² http://kfos.org/wp-content/uploads/2011/10/The-Position-of-RAE-Communities-in-Kosovo-Baseline-Survey_ENG.pdf

³ <http://kfos.org/wp-content/uploads/2011/10/Governance-of-Roma-Ashkali-and-Egyptian-Rights-in-Kosovo.pdf>

⁴ http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/ks_rapport_2010_en.pdf

SFIDAT GJATË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR INTEGRIMIN E KOMUNITETEVE ROMA, ASHKALI DHE EGJIPTASE 2009-2015

Cairan O'Toole



Strategjia dhe Plani i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Roma, Ashkali dhe Egjiptase është dokument gjithëpërfshirës i cili synon të plotësojë përpjekjet e institucioneve të Kosovës për zgjerimin e të drejtave të të gjithë anëtarëve të shoqërisë. Megjithatë, duhet shtuar që dokumenti nuk është harmonizuar në masë të mjaftueshme me strategjitë e tjera sektoriale dhe tejsektoriale duke e rritur kështu koston e operacioneve në nivelin komunal dhe atë qendror. Përveç kësaj, duplikimet në procesin e raportimit i ngarkojnë edhe më tepër strukturat ekzistuese që monitorojnë zbatimin dhe si rezultat stafi duhet të kalojë më shumë kohë në përgatitjen e përgjigjeve të ndryshme për fushat e mbuluara. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që mekanizmat e këtyre Planeve të Veprimit të rreshtohen për ta rritur efektshmërinë e proceseve të monitorimit dhe raportimit duke e rritur kështu edhe mundësinë e rafinimit të qasjeve si dhe zbatimin e monitorimit në kohë të duhur. Në figurën 1 është paraqitur struktura e propozuar për sistemin e unifikuar të monitorimit të institucioneve që punojnë në fushën e drejtave të njeriut.

Aktualisht, dy mekanizmat kryesor për zbatimin dhe monitorimin e Integritimit të Komuniteteve Roma, Ashkali dhe Egjiptase janë Komiteti Drejtues Ndër-Institucional dhe Grupi Punues Teknik për Planin e Veprimit (GPTPV). Mekanizmi i parë është trup politik me përfaqësim institucional të gjerë dhe të nivelit të lartë, roli kyç i të cilit është bashkëpunimi në mes të sektorit joqeveritar dhe Qeverisë në zbatimin e aktiviteteve. GPTPV-ja përcjell zbatimin e aktiviteteve; harton, prioritetizon dhe ekzaminon çështjet relevante në nivelin e politikave; dhe bën monitorim të vazhdueshëm dhe të përafërt. Grupi punues teknik kryesisht përbëhet nga stafi i Njësisë për të Drejtat e Njeriut të

ministrive respektive, dhe si rezultat nuk ka numër të mjaftueshëm të stafit të lartë teknik. Shkëmbimi ndër-institucional i informatave në disa departamente të ministrive respektive duhet të përmirësohet në mënyrë që niveli teknik të informohet me kohë mbi rezultatet e arritura. Këto vonesa mund të shkaktohen pjesërisht nga niveli i ulët i senioritetit të këtyre përfaqësuesve.

Struktura e propozuar (Figura 1) i shton arranzhimet aktuale bashkërenduese në nivelin teknik dhe atë politik duke e rritur anëtarësinë dhe duke iu mundësuar hisedarëve kyç të marrin pjesë dhe të ekzekutojnë funksionet e tyre të caktuara, si dhe duke harmonizuar agjendën për të drejtat e njeriut në një tërësi koherente (integrimi i komuniteteve roma, ashkali dhe egjiptase; personat me aftësi të kufizuara; të drejtat e fëmijëve, etj). Komisionet ekzistuese në nivelet e ndryshme do t'i ofrojnë të dhëna Grupit Punues Teknik Ndër-Sektorial për rrugë të qarta të raportimit të cilat do të bashkërendojnë proceset e punës dhe do të trajtojnë të drejtat e njeriut në tërësi e jo si çështje të izoluar. Arranzhimi i propozuar mundëson komunikim të shtuar në mes Grupit të Lartë Punues Teknik që përbëhet nga Sekretarët e Përgjithshëm të ministrive respektive të cilët i raportojnë nivelit politik të përbërë nga Ministrat. Rrjedha e informatave në mes të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe Ministrave është njëra ndër hallkat që mungon në zbatimin e të drejtave të njeriut në Kosovë, dhe si e tillë struktura e rishikuar do ta trajtojë këtë komunikim në mënyrë të konsoliduar.

Grupi Punues Teknik Ndër-Sektorial do t'i trajtojë në tërësi çështjet e drejtave të njeriut, por edhe ndaras për tu siguruar që çdo çështje do të ketë kohë të mjaftueshme për diskutime dhe analizim të progresit, për ta informuar pastaj në mënyrë adekuate

Komisionin Drejtues Ndër-Institucional dhe për të ofruar rekomandime për bashkërendimin e përpjekjeve në fushën e drejtave të njeriut. Në mënyrë nivelet e caktuara të Qeverisë të informohen plotësisht, sugjerohet që Komisioni Drejtues Ndër-Institucional, çdo gjashtë muaj t'i dorëzojë raport Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazinë Gjinore, Personat e Zhdukur dhe Peticionet, mbi progresin dhe pengesat drejt Drejtave të Njeriut për raportim të konsoliduar në Kuvend.

Raporti vjetor 2010 për integrimin e komuniteteve roma, ashkali dhe egjiptase u finalizua në maj të vitit 2011, për shkak të disa sfidave, përfshirë këtu kapacitetet e kufizuara monitoruese të GPTPV-së si dhe raportimit në nivelin e aktiviteteve i cili nuk iu referohej indikatorëve të propozuar në Planin e Veprimit. Për arsye të ngjashme nuk është finalizuar as raporti i parë për vitin 2011, i cili do të duhej të hartohej dy herë në vit. Për ta bërë këtë çështje edhe më komplekse, Njësitë për të Drejtat e Njeriut raportojnë në format narrativ me informata të kufizuara teknike/statistikore dhe si rezultat sistemimi i formateve të ndryshme të raportimit paraqet një sfidë e vërtetë. Prandaj, është më se e qartë se duhet të ekzistojë një format uniform i raportimit dhe se formati i akorduar duhet të respektohet plotësisht. Sa i përket sistemit të monitorimit, nuk ekziston një kornizë e mirëfilltë dhe raportimi narrativ përfshin një qasje me pika të shkurta për shkak të mungesës së plotë të pikave të krahasimit dhe synimeve me të cilat do të matej progresi i arritur. Për shkak të mungesës së pikave të krahasimit dhe të synimeve, është e pamundur të bëhet vlerësimi i mbështetur në dëshmi i progresit e as rafinimi i planeve vjetore të punës të Ministrive relevante për rritjen e dukshme të përpjekjeve në fushat specifike.

Sfidë tjetër në zbatimin e Strategjisë janë pengesat buxhetore nga ministrinë respektive, përfshirë këtu Ministrinë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji (MASH) si dhe Ministrinë e Shëndetësisë. Edhe pse burimet financiare për përmbushjen e aktiviteteve janë të përcaktuara në masë të madhe, alokimet aktuale buxhetore për këto aktivitete paraqesin sfidë dhe shkaktojnë zvarritje në procesin e zbatimit e në disa raste edhe moszbatim të plotë të aktiviteteve. Këto kufizime buxhetore kanë ndikuar në përparime në fushën e arsimit siç është përfshirja e numrit më të madh të edukatorëve në nivelin parashkollor, që është themel i karrierës solide në arsimor dhe një nga hapat e parë për të dal nga varfëria. Përveç kësaj, MASHT-i ka vërejtur numër të kufizuar të stafit të kualifikuar në mesin e komunitetit rom për përdorimin e gjuhës rome në shkollë. Këto sfida vijnë edhe më tepër në shprehje si rezultat i nivelit të ulët të zbatueshmërisë nga institucionet relevante në të gjitha nivelet (siç janë, shkollat, komunat dhe niveli qendror) e Ligjit për Arsimin Obligativ dhe nivelet e larta të analfabetizmit – posaçërisht në mesin e femrave dhe vajzave – si dhe martesat e hershme, që shpeshherë rezultojnë me mungesën apo largimin e vajzave nga shkollë. Ministria e Shëndetësisë ka cekur që mungesa e bazës së të dhënave për komunitetet roma, ashkali dhe egjiptase ka shkaktuar sfida sa i përket përgjigjes koherente për ofrimin e shërbimeve për këto komunitete. Përveç kësaj, ka shumë pak hulumtime për këto komunitete specifike si dhe për fushat në të cilat ato kanë nevojë për përkrahje të shtuar në mënyrë që të gëzojnë qasje të barabartë në shërbime shëndetësore si të gjithë kosovarët e tjerë.

Procesi aktual i hartimit të "Ligjit për Mekanizmat për Bashkëpunim, Raportim dhe Promovim të Drejtave të Njeriut" paraqet rast të vulltshëm për rreshtimin e mekanizmave të propozuar në Figurën 1. Përfshirja e këtyra kornizave në këtë Ligj mund të ofroj mundësinë e shumëpritur që çështjet e të Drejtave të Njeriut të trajtohen në mënyrë më koherente dhe jo si komponentë të ndarë. Zyra Këshilldhënëse për Qeverisje të Mirë (ZKQM) në Zyrën e Kryeministrit, e përkrahur nga UNICEF-i, është në proces të operacionalizimit të Planit Kombëtar të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve 2009-2013, dhe shumë komponente të këtij plani janë të përfshira




Figura 1: Struktura e propozuar për bashkërendimin e arranzhimeve rreth zbatimit dhe monitorimit të planeve kombëtare të veprimit që ndërlidhen me të drejtat e njeriut

edhe në Planin e Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Roma, Ashkali dhe Egjiptase. Qasje e ngjashme mund të përdoret edhe për këtë Plan të Veprimit në mënyrë që të harmonizohen qasjet dhe të shmanget duplikimi në raportim – duke e zvogëluar kështu barrën mbi strukturat ekzistuese. Korniza e rishikuar e monitorimit do të rreshtonte mekanizmat e monitorimit dhe do të harmonizonte formatet e raportimit të Planeve të ndryshme të Veprimit Kombëtar në një tërësi të vetme koherente me qëllim të informimit sa më të mirë të sistemit të shfaqur në Figurën 1. Korniza monitoruese synon të informohet me të dhëna rutinore në nivelin e ministrive i cili ose është i gatshëm ose i forcon sistemet në mënyrë që të jenë të gatshme, në vend të aktiviteteve ad-hoc për mbledhjen e të dhënave për ta monitoruar zbatimin e aktiviteteve. Këto sisteme monitoruese do të pasqyroheshin çdo vit në raportin vjetor mbi monitorimin e buxhetit, për të parë nëse janë bërë alokime të mjaftueshme financiare për përmbushjen e aktiviteteve të parapara. Raporti vjetor do të përmbante shënime për çdo sektor për të vlerësuar progresin drejt arritjes së Planeve të Veprimit në një qasje të bashkërenduar, duke e rritur monitorimin rutinor të përjashtimit social.

Rritja e numrit të stafit në zyrë është tejet e domosdoshme nëse ZKQM-ja dëshiron të funksionoj si sekretariat për punën në fushën e të Drejtave të Njeriut, jo vetëm në ofrimin e përkrahjes për nivelet politike dhe teknike të paraqitura në Figurën 1 por edhe për një gamë të gjerë të komisioneve që tash do t'i

raportonin Grupit Punues Teknik Ndër-Sektorial. Përveç kësaj, Njësitë për të Drejtat e Njeriut, në nivelin komunal dhe qendror, duhet të kenë numër adekuat të stafit në përputhje me Udhëzimet Administrative që përcaktojnë funksionet e tyre, në mënyrë që të ketë ndarje efektive të përgjegjësisë në nivelin bazë të tërë arranzhimit të propozuar strukturor. Për shkak të kapacitetit të kufizuar monitorues të Njësisë për të Drejtat e Njeriut në të dy nivelet, është shumë e rëndësishme të bashkohen trajnimet dhe zhvillimet e kapaciteteve në strukturën e rishikuar. Procesi i zhvillimit të kapaciteteve duhet të përqendrohet në kapacitetet monitoruese dhe raportuese të niveleve qendrore dhe komunale. Në mënyrë që të arrihen të gjitha arranzhimet e propozuara strukturore si dhe të përmbushen kërkesat për zhvillimin e kapaciteteve, duhet aplikuar për Fondet IPA për të siguruar një qasje adekuate. ZKQM-ja mund të shfrytëzoj shërbimet përkrahëse që ofron bashkësia ndërkombëtare nëpërmjet UNICEF-it, gjatë hartimit të këtij Ligji, si dhe përkrahjen e tyre në përgatitjen e aplikacionit për Fondet IPA.

(Autori është Ekspert Ndërkombëtar për Monitorim, UNICEF)

Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë punim janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikat apo qëndrimet e UNICEF-it. Teksti i dokumentit nuk është redaktuar sipas standardeve të botimeve zyrtare dhe UNICEF-i nuk mban përgjegjësi për gabime eventuale.)

DYZETË MASA PËR TË NXITUR ZBATIMIN E STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR KOMUNITETET ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN



Komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas (RAE) në Kosovë i takojnë grupeve më të cenueshme. Andaj Komisioni Evropian ka ndërmarrë iniciativën dhe e ka organizuar një konferencë për politikën e dialogut së bashku me Ministrinë për Integrim Evropian për fuqizimin e përfshirjes së komuniteteve RAE në Kosovë. Konferenca është mbajtur në Prishtinë, më 11 maj dhe është drejtuar nga Drejtori për Ballkanin Perëndimor në DG Enlargement, Z. Pierre Mirel. Në të janë përfshirë të gjitha palët me interes, si ato ndërkombëtare po ashtu edhe ato vendore, të cilat punojnë për çështjet RAE. U hartuan 40 veprime konkrete për përkrahjen e Zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për romë, ashkalinj dhe egjiptas. Kjo shkon prej masave për të siguruar vijimin e shkollimit nga fëmijët RAE, përpjekjet për rekrutimin e RAE në sektorin publik e deri te përpjekjet e forta për regjistrimin civil të komuniteteve RAE dhe alokimin e tokës për zgjidhje të qëndrueshme të banimit. Është menduar se një mekanizëm monitorimi dhe implementimi i zhvilluar dhe i përshtatur do ta ngritë efikasitetin për të gjitha përpjekjet. Në vijim janë 40 veprimet.

Çështjet ndër-sektoriale:

1. Përparësitë për masat e përfshira në **Strategjinë dhe Planin e Veprimit RAE** (SPVRAE) duhet të përcaktohen përmes planeve vjetore të punës dhe caktimit të buxhetit për ministritë relevante dhe komunat.
2. **Grupi Teknik i Punës për Planin e Veprimit** për zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian duhet të rrisë veprimtarinë e tij për të koordinuar në mënyrë më efektive shpërndarjen e burimeve dhe për të monitoruar zbatimin e prioritetëve. GTPPV duhet të informojë pa vonesë

autoritetet përkatëse për rolin e tyre si dhe ta ndjekë atë në vazhdimsi.

3. **Komunat** kanë një rol kyç në përfshirjen e komuniteteve RAE. Komunitet dhe ministritë përkatëse, në bashkëpunim të ngushtë me komunitetet RAE duhet të rrisin bashkëpunimin e tyre në këtë drejtim. GTPPV duhet të orientojë komunat për vendosjen e prioritetëve dhe/ose për zbatimin e prioritetëve të propozuara të SPVRAE.
4. **Lehtësuesit nga komuniteti, udhëheqësit si dhe familjet e komunitetit** kanë një rol vendimtar për ngritjen e besimit, arsimimit, punësimit dhe shërbimet sociale duke përfshirë këtu edhe parandalimin e martesave në moshë të re. Është me shumë rëndësi që komunat të njohin lehtësuesit.
5. **Ndërgjegjësimi, transparencja, pjesëmarrja dhe përfshirja** janë vendimtare për zbatimin e SPVRAE. Për të rritur ndërgjegjësimin mbi të drejtat e komuniteteve RAE dhe për të inkurajuar angazhimin e komuniteteve RAE me autoritetet duhet të realizohen fushata mediatike që shënjestrojnë institucionet qendrore, komunat dhe publikun e gjerë.
6. **Aksesi i padiskriminuar në sistemin e drejtësisë** është jetik për të realizuar përfshirjen e komuniteteve RAE; pra qeveria duhet të caktojë burime për të mbështetur komisionin e ndihmës ligjore si dhe për të lehtësuar aksesin e komuniteteve RAE në sistemin e drejtësisë.
7. GTPPV duhet të sigurojë **mbledhjen e të dhënave** në mënyrë që prioritetet e SPVRAE të rishikohen çdo vit; duhet të krijohet një sistem për mbledhjen e të dhënave të izoluar në të gjitha institucionet e agjencitë shtetërore si dhe nëpër komuna.

8. Qeveria duhet të krijojë një **sistem unik për monitorimin dhe raportimin**

rutinë i cili duhet të mishërojë instrumente të standardizuara dhe procedura të njëtrajtshme për mbledhjen e të dhënave.

9. Një vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet **grave dhe vajzave** të komuniteteve RAE.
10. Kosova duhet të planifikojë që të aplikojë për anëtarësimin në **Dekadën Rome**.

Regjistrimi Civil

1. Regjistrimi në gjendjen civile duke përfshirë regjistrimin e lindjeve të komuniteteve RAE duhet të kryhen dhe të përditësohen në mënyrë proaktive nga Zyrat Komunale të Gjendjes Civile me asistencën e punonjësve komunal që merren me çështjet e komuniteteve RAE. Duhet të aktivizohen bordet e shqyrtimit për lehtësimin e regjistrimit të komuniteteve të cënueshëm të cilët nuk posedojnë dokumente.
2. Certifikatat e regjistrimit të anëtarëve të komuniteteve RAE duhet të jepen falas gjatë fushatave që ndërmerren për të zgjidhur problemin e regjistrimit të shtetasve RAE.
3. Legjislacioni i ri për gjendjen civile ku përfshihen aktet normative dhe udhëzimet administrative për ri-regjistrimin dhe regjistrimin e vonuar duhet të miratohet shpejt. Punonjësit e zyrave të gjendjes civile të të gjitha komunave duhet të trajnohen se si të zbatojnë kornizën e re ligjore.
4. Në çdo komunë, me mbështetjen e Zyrave të Gjendjes Civile dhe të Agjencisë së Gjendjes Civile, duhet të zhvillohen regjistrime rutine si dhe të ketë sisteme kontrolli.
5. Procesi i regjistrimit për fëmijët e ri-atdhesuar duhet të realizohet në mënyrë sistematike.

Arsimi

1. Duhet të merren masa për të siguruar vijimin e shkollës duke përfshirë këtu një proces regjistrimi falas dhe të thjeshtëzuar, fushata ndërgjegjësimi dhe monitorim të vijimit efektiv. Këto masa duhet të shënjestrojnë si fëmijët që janë regjistruar ashtu edhe ata që nuk janë regjistruar asnjëherë.
2. Kosova duhet të luftojë braktisjen e shkollimit, ndër të tjera edhe duke zbatuar Planin e Veprimit kundër Braktisjes së Shkollimit dhe duke identifikuar nevojat dhe numrin e nxënësve, sidomos të vajzave që kanë lënë shkollën. Kujdesi në vitet e para të fëmijërisë, veprimtaritë parashkollë, klasat për të rikuperuar orët e humbura dhe bursat janë mjete të rëndësishme për të lehtësuar frekuencimin e shkollës dhe për të reduktuar braktisjen e shkollimit.
3. Duhet të njihet dhe të theksohet roli kyç i prindërve "dhe ndërmjetësve".
4. Komunitat duhet të luftojnë paragjykimet dhe diskriminimet në shkolla, konkretisht duke organizuar seminare për mësuesit nëpër shkolla.
5. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe komunitet nga shtatori 2011 duhet të zbatojnë kurrikulën rome dhe të shpërndajnë tekstet përkatëse. Mësuesit e kurrikulës rome duhet t'i nënshtrohen trajnimit të nevojshëm.
6. Për nxënësit dhe të rriturit e komuniteteve RAE duhet të ofrohen trajnime të hartuara në bazë të nevojave duke përfshirë kurse gjuhe dhe kurse kundër analfabetizmit.
7. Kuotat e vendosura për studentët e komuniteteve RAE duhet të përdoren në mënyrë efektive.
8. Duhet të rritet mbështetja e donatorëve ndërkombëtarë për arsimin.

Punësimi

1. Duhet të bëhen përpjekje të mëdha për të punësuar anëtarë të komuniteteve RAE në sektorin publik, konkretisht në shkolla si mësues dhe asistentë si dhe në shërbimet komunale dhe shërbimet publike.
2. Ministria e Punës duhet të vazhdojë të zbatojë planin e punës për ngritjen e kapaciteteve të punësimit publik për të përmirësuar punën e tyre me grupet e lëna pas dore.
3. OJQ-të RAE duhet të lehtësojnë bashkërendimin ndërmjet qendrave komunale/rajonale të arsimit profesional dhe qendrave të punësimit në mënyrë që të



përmirësohet qasja e komuniteteve RAE në tregun e informacionit dhe të punës.

4. OJQ-të dhe qendrat e punësimit duhet të lehtësojnë ngritjen e urave ndërmjet komuniteteve RAE dhe sipërmarrësve privatë; mund të zhvillohen trajnime të përbashkëta në punë.
5. Për të bërë më të lehtë punësimin e anëtarëve të komuniteteve RAE si dhe hapjen e bizneseve të reja nga ta duhet të realizohen incentiva fiskale dhe masa për realizimin e të ardhurave duke përfshirë dhënien e granteve të vogla dhe nëpërmjet partneriteteve ndërmjet sektorit publik dhe atij privat.

Kujdesi social dhe shëndetësor

1. Ministria e Shëndetësisë duhet të realizojë "hartën e të grupeve të cënueshme" për të identifikuar përqendrimet më të larta dhe nevojat e sakta të grupeve të cënueshme.
2. Skema e përfitimeve shoqërore duhet të rishikohet dhe, në mënyrë që të luftohet varfëria e fëmijëve, duhet të fillojnë të zbatohen masa për një skemë të diversifikuar të asistencës sociale që jepet në para në dorë. Pjesa e buxhetit që caktohet për kujdesin shëndetësor duhet të rritet. Kosova duhet të zbatojë kujdesin shëndetësor parësor/mjekësinë familjare.
3. Autoritetet dhe OJQ-të, me mbështetjen e lehtësuesve që janë pjesë e komunitetit, duhet të zhvillojnë fushata të rritjes së ndërgjegjësimit për të informuar komunitetet RAE për faktorët mjekësorë.
4. Kosova duhet të shtojë përpjekjet për të zbutur faktorët e rrezikshëm mjekësorë

(kontaminim nga plumbi dhe kontaminime të tjera) konkretisht duke zbatuar protokollin e menaxhimit të rasteve të helmimit të fëmijëve nga plumbi si dhe duke e bërë atë të qëndrueshëm nga ana financiare.

Strehimi

1. Kampet në Osterode dhe Leposavic duhet të mbyllen shpejt.
2. Koordinator për të drejtat e pronës duhet të emërohet brenda zyrës së Kryeministrit.
3. Çështjet ligjore të kthimit të pronave të paluajtshme të komuniteteve RAE duhet të jenë prioritet për gjykatat dhe Agjencinë e Pronave të Kosovës; ndër to prioritet më i lartë u duhet dhënë familjeve të riatdhesuara të komuniteteve RAE.
4. Komunitat duhet të sigurojnë dhënien e tokave për të ngritur vendbanime të ligjshme dhe/ose të legalizojnë 174 vendbanimet aktuale të ashtëquajtura "të paligjshme".
5. Vendbanimet informale duhet të përfshihen në planet hapësinore të komunave.
6. Kosova duhet të miratojë pa vonesë strategjinë për vendbanimet informale.
7. OJQ-të duhet t'u japin mbështetjen e tyre komunave për të zhvilluar dhe zbatuar përmirësimin e skemave sociale të strehimit për komunitetet RAE.
8. Nevojat për strehim dhe nevoja të tjera që kanë të bëjnë me kthimin duhet të planifikohen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
9. Caktimi i tokave për sistemin e personave të kthyer duhet të sigurohet sistematikisht për një periudhë të paktën dyzetë vjeçare.

PROJEKTET PËR MBËSHTETJE TË IMPLEMENTIMIT TË STRATEGJISË PËR INTEGRIMIN E KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTAS



Integrimi është një fjalë e "madhe" dhe nënkupton që personat e një prejardhjeje të caktuar, etniciteti të caktuar të jenë të përfshirë në një sistem të caktuar, pa dallim përkatësie, gjinie apo pozite sociale.

Fondacioni adreson këtë nevojë përmes përmes dy projekteve: **(1) Mbështetje për implementimit të strategjisë së qeverisë së Kosovës për integrim të komuniteteve RAE-projekt i financuar me grant të veçantë nga Z. Soros dhe (2) Përkrahja e BE-së për implementimin e strategjisë për komunitetet RAE i financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë.**

Në vitin 2006, Qeveria e Kosovës e nisi procesin e hartimit të "Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Roma, Ashkali dhe Egjiptase 2009-2015" e cila u miratua në dhjetor të vitit 2008. Pas kësaj, Qeveria filloi ta hartoj "Planin e Veprimit për Zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Roma, Ashkali dhe Egjiptase 2009-2015" të cilin e miratoi në dhjetor të vitit 2009. Partnerë vendor dhe ndërkombëtar u ftuan për t'iu bashkangjitur rrugëtimit për përmirësim të kushteve të jetës së komuniteteve Roma, Ashkali dhe Egjiptase dhe lehtësimin e integrit të tyre në shoqërinë kosovare. Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur ka ndihmuar me ekspertizë dhe me fonde të dy

proceset e nisura në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës dhe tani vazhdon të jetë njëri prej partnerëve kryesorë të qeverisë në zbatimin e kësaj strategjie. Për këtë qëllim Fondacioni siguroi fonde nga dy burime: Zotimi i Z. Soros në konferencën e donatorëve për Kosovën, të mbajtur në vitin 2008 në Bruksel, për të mbështetur implementimin e strategjisë së qeverisë së Kosovës për integrim të komuniteteve RAE me shumë prej 0.5 mil € tërhoqi edhe zotimin e Komisionit Evropian për të ndarë 1.0 mil. € për të njëjtin qëllim. Kjo marrëveshje në mes të Z. Soros dhe Z. Rehn më pas u operacionalizua në Kosovë në mes të Fondacionit ECLIO. Të dy projektet tani janë operacionale dhe në implementim e sipër.



PÛRKRAHJA E BE-SË PÛR ZBATIMIN E STRATEGJISË RAE

PÛrkrahja e BE-së pÛr
procesin e integritimit



Varfëria dhe mungesa e integritimit social, qÛ rezultojnÛ me mungesÛ tÛ edukimit, papunësisÛ, mungesÛn e kujdesit tÛ duhur shëndetësor dhe strehimit; janÛ vetëm disa nga vështirësitÛ me tÛ cilat ballafaqohen komunitetet romÛ, ashkalinjÛ dhe egjiptas (RAE) nÛ jetÛn e tyre tÛ pÛrditshme nÛ KosovÛ. Me qÛllim tÛ ndryshimit tÛ kÛtij realiteti tÛ hidhur dhe pÛrmirësimit tÛ integritimit tÛ kÛtyre tre komuniteteve nÛ shoqërinÛ e Kosovës, Bashkimi Evropian, pÛrmes Instrumentit tÛ Para-AnÛtarësimit (IPA) 2009, është duke pÛrkrahur projektin e BE-së PÛrkrahje pÛr Zbatimin e Strategjisë RAE (EU SIMRAES). Projekti u hartua nga Fondacioni Kosovar pÛr Shoqëri tÛ Hapur (KFOS) nÛ bashkëpunim tÛ afÛrt me QeverinÛ e Kosovës dhe ZyrÛn NdërlidhÛse tÛ Bashkimit Evropian nÛ KosovÛ, ku kjo e fundit është edhe menaxhues i projektit. Ky projekt si i tillÛ ka nÛj afat kohor tÛ zbatimit prej dy vitesh, duke filluar mÛ 1 shtator, 2010 si edhe duhet tÛ pÛrmendet se ky projekt është nÛ pajtim tÛ plotÛ me dy dokumentet kryesore tÛ Qeverisë sÛ Republikës sÛ Kosovës pÛr integritimin e komuniteteve RAE: "Strategjia pÛr integritimin e Komuniteteve romÛ, ashkalinjÛ dhe egjiptas 2009-2015" dhe Plani i Veprimit pÛr zbatimin e strategjisë sÛ lartpÛrmendur. QÛllimi i projektit është pÛrmirësimi i mirëqenies socio-ekonomike tÛ komuniteteve romÛ, ashkalinjÛ dhe egjiptas nÛ KosovÛ pÛrmes ndihmës pÛr qasje nÛ edukim, duke ruajtur dhe promovuar trashëgiminÛ kulturore tÛ RAE dhe duke ngritur informimin pÛr komunitetet RAE nÛ mediat kryesore. PÛrvoja dÛshmon se siguri i qasjes dhe mundësive mÛ tÛ mira pÛr edukim tÛ

mirÛ është hapi i parÛ dhe mÛ i rëndësishmi nÛ luftimin e varfërisÛ si edhe sigurimin e integritimit mÛ tÛ mirÛ tÛ komuniteteve RAE nÛ shoqërinÛ e Kosovës. Andaj, KFOS si partneri kryesor implementues i projektit EU SIMRAES, i ka pÛrqendruar aktivitetet e veta kryesish nÛ pÛrmirësimin dhe ndihmÛn pÛr qasje mÛ tÛ mirÛ nÛ edukim tÛ anÛtarëve tÛ rinj tÛ komuniteteve RAE. PÛr mÛ tepÛr, janÛ planifikuar edhe aktivitetet tjera qÛ synojnÛ promovimin e kulturës dhe trashëgimisÛ sÛ komuniteteve RAE si edhe ngritjen e informimit pÛr RAE nÛ mediat kryesore nÛ KosovÛ. PÛr ta arritur kÛtÛ, KFOS ka angazhuar disa partnerÛ dhe subkontraktorÛ si: Qendra pÛr Arsim e Kosovës, Iniciativa 6, Durmish Aslano, Balkan Sunflowers, Qendra pÛr Dokumentim pÛr romÛt dhe ashkalinjÛt, Bethany Christian Services, Caritas Kosova, AfÛr Fëmijëve, Rrjeti i Ballkanit pÛr Raportim Hulumtues, Qendra Multimedia dhe Urban FM. PÛrveç kÛsaj janÛ zgjedhur edhe gjashtÛ qendra tÛ komunitetit nÛ pesÛ komuna pÛr tÛ qenÛ pjesÛ e projektit.

Edukimi

Edukimi si trugu i shoqërisÛ i ka zgjeruar degÛt e veta nÛ komunitetet romÛ, ashkalinjÛ dhe egjiptas nÛ KosovÛ. MÛ parÛ, situata e fëmijëve RAE nÛ KosovÛ ishte:

- Vetëm nÛj numÛr simbolik i fëmijëve tÛ moshës 3-6 vjeçare vijonin edukimin parashkollor;
- MÛ pak se gjysma e fëmijëve tÛ moshës shkollore vijonin shkollimin fillor;
- MÛ pak se 20% vijojnÛ apo kanÛ vijuar

shkollimin pas moshës 12 vjeçare;

- Vetëm 4.5% e kanÛ pÛrfunduar shkollÛn e mesme;
- Vetëm 40 studentÛ (1.3%) ishin tÛ pÛrfshirÛ nÛ arsimimin terciar.

Projekti EU SIMRAES i adreson kÛto çështje pÛrmes programeve edukative tÛ zbatuara nÛ Qendrat Mësimore qÛ janÛ themeluar nga projekti duke u bazuar nÛ vÛzhgimin e situatës nÛ terren. KÛto Qendra Mësimore janÛ themeluar nÛ komunÛn e Prizrenit, Gjakovës, Mitrovicës, Ferizajt dhe Graçanicës ku nÛj qendÛr është themeluar nÛ nÛj komunÛ, pÛrveç Prizrenit ku janÛ themeluar dy Qendra Mësimore. NÛ mënyrÛ qÛ tÛ sigurohet qÛndrueshmëria pÛr Qendrat Mësimore janÛ nënshkruar Memorandume Mirëkuptimi me komunat pÛrkatesÛ, tÛ cilat do ta marrin mbi vete menaxhimin e qendrave pasi tÛ pÛrfundojÛ projekti. TÛ gjitha qendrat e lartpÛrmendura janÛ pajisur me nÛj set standard tÛ mobileve tÛ pÛrshtatshme pÛr secilin program qÛ do tÛ zbatohet. NÛ tÛ njëjtÛn kohÛ kur janÛ themeluar Qendrat është planifikuar edhe ngritja e kapacitetit profesional pÛr kÛto komunitete. Qendra pÛr Arsim e Kosovës (KEC), e cila është pÛrgjegjÛse pÛr komponentÛn e edukimit tÛ projektit, punon me gjashtÛ partnerÛ, nga tÛ cilÛt 4 janÛ OJQ tÛ menaxhuara nga komunitetet RAE. Aktivitetet edukative tÛ projektit implementohen me ndihmÛn dhe pÛrkrahjen e Ministrisë sÛ Arsimit, Shkencës dhe TeknologjisÛ. Si rezultat i kÛsaj, secila qendÛr mësimore nÛ bazÛ tÛ nevojave i ka zbatuar programet nÛ vijim:

- Programin PÛrgatitor Parashkollor – moshja 3-6 vjeç



- Ndhmë për Detyrat e Shtëpisë – mosha 6-15 vjeç
- Pako përkrahëse për fëmijët shkollor – mosha 6-15 vjeç
- Kurse përgatitore për nxënësit e ardhshëm të shkollës së mesme dhe studentët terciar
- Programi për Shkrim-Lexim
- Programi për Aktivitete Rinore

Secila Qendër Mësimore ka një Koordinator dhe gjashtë facilitatorë të cilët janë përgjegjës për zbatimin e programit parashkollor, ndihmës për detyrat e shtëpisë dhe programin për shkrim-lexim. Është me rëndësi të përmendet se shumica e personelit të punësuar është nga komunitetet RAE. Personeli është trajnuar sipas programit të njohur Hap pas Hapi, të ofruar nga trajnerët e KEC-it. Ky program përdoret për tu fokusuar në individualizim, mësimin e shkathhtësive bazike sociale dhe të shkrimit e numërimit, duke krijuar klasë me fëmijën në qendër, dhe themelimin e bashkëpunimit të afërt me familje. Fëmijët kalojnë 2-3 orë në ditë në Qendrat Mësimore.

Klasat Hap pas Hapi nxisin shprehitë demokratike. Fëmijët inkurajohen të:

- Bëjnë zgjedhje dhe të marrin përgjegjësi
- Mësojnë të pavarur si edhe në bashkëpunim
- Të jenë tolerant dhe t'i respektojnë dallimet

Qëllimi i këtyre Qendrave Mësimore është të krijojnë një mjedis miqësor dhe të përshtatshëm për fëmijët RAE të cilët frekuentojnë aty. Fëmijët kanë qasje më të lehtë në mësim dhe ngritje të aftësive të tyre gjatë vitit shkollor. Gjithashtu, përveç mësimin dhe kryerjes së detyrave, Qendrat ofrojnë mundësi për tu angazhuar në aktivitete argëtuese rinore. Megjithatë, përpjekja më e rëndësishme për përmirësimin e gjendjes socio-ekonomike të fëmijëve dhe të rinjve RAE është se gjatë këtij projekti janë ofruar 200 bursa për nxënës të shkollës së mesme dhe 20 bursa të tjera për studentë universiteti. Kjo nënkupton se për periudhën 2 vjeçare, nxënësit e shkollës së mesme do të marrin nga 30 EUR në muaj, ndërsa studentët e uni-

versitetit do të marrin nga 100 EUR në muaj. Përveç kësaj, në mënyrë që të motivohen nxënësit (klasat 1-9) projekti siguron në fillim të çdo viti shkollor 1000 pako përkrahëse shkollore. Kjo ndikon shumë te fëmijët e klasës së parë, të cilët kanë më së shumti nevojë për këto pako për shkak të situatës së vështirë ekonomike. Duhet të theksohet se projekti nuk i ka lënë anash as të rriturit, e në veçanti gratë. Të rriturit RAE kanë mundësi të vijnë kurset për Shkrim-lexim që ofrohen nga facilitatorët e programit për Shkrim-lexim të Qendrave Mësimore. Në këtë mënyrë, Qendrat Mësimore përveç ofrimit të shërbimeve të lartpërmendura krijojnë edhe një lidhje të fortë me komunitetin dhe përkushtim për progres në fushën e edukimit.

Kultura dhe media

Në mënyrë që të prezantohen specifikat kulturore të komuniteteve RAE, EU SIMRAES zbaton aktivitete të ndryshme kulturore. Për më tepër, me qëllim të përmirësimit të situatës në fushën e

medie, anëtarët e komuniteteve RAE janë duke vijuar trajnimet profesionale. Në mesin e aktiviteteve janë: organizimi i festivalit njëjavor, përfshirja shkrimtarëve RAE në Karvanin e Shkrimtarëve të Kosovës "Agim Deva", Klubet e Aktiviteteve, prodhimi i një TV dokumentari, ekspozita etnologjike, trajnimi në media dhe produksion të përbashkët.

Festimi i kulturës

Edicioni i parë i Festivalit të Kulturës RAE u organizua nga 23 deri 29 maj 2011 me ngjarje në Prishtinë, Prizren dhe Mitrovicë. Ky Festival u organizua në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si edhe me përfaqësues nga të tri komunitetet. Arritja më e rëndësishme është se në ngjarjet e festivalit kanë marrë pjesë jo vetëm anëtarët e komuniteteve RAE por edhe anëtarët e komuniteteve tjera që jetojnë në Kosovë, si edhe mediat. Në këtë mënyrë, ky festival përfaqësoi kulturën e tri komuniteteve jo vetëm për ata që ishin prezent por edhe për audiencën e gjerë kosovare.

Hapja e festivalit u shënuar me Ekspozitën e Fotografisë të titulluar "Përmes Syve të Mi". Kjo ekspozitë ishte rezultat i punës së fotografisë të organizuar në gjashtë qendrat e komunitetit që janë pjesë e projektit. Gjatë këtyre punës, fëmijët dhe të rinjtë kishin mundësi të mësojnë bazat e fotografisë nga Z. Naim Shala, fotograf i njohur në Kosovë. Pas kësaj atyre u dhanë kamera digjitale me mision fotografimin e momenteve të rëndësishme në rrethinën e vet dhe kështu paraqitën si duket jeta tyre përditshme. Gjatë këtij aktiviteti u prodhuan shumë fotografi të bukura ku secila transmeton një mesazh për publikun e gjerë dhe i afroi këto komunitete me njerëzit e Kosovës.

Ekspozita Etnologjike "Kush Jemi Ne" u përgatit në mënyrë që të prezantojë doket, ceremonitë dhe rritet specifike që i kanë këto tri komunitete, me traditën e tyre, veshjet, historinë dhe faktet e rëndësishme.

Performancat teatrale ishin gjithashtu pjesë e këtij edicioni të parë të festivalit. Një grup i të rinjve nga Prizreni dhe Gjakova punuan me një trajner profe-

sionist. Rezultati ishte performanca e improvizuar "Ne Jemi e Ardhmja", e cila i lidh temat e ndryshme sociale përmes muzikës dhe tregimeve personale të këtyre aktorëve të rinj.

Përveç programit të pasur kulturor, gjatë festivalit u organizua debati që adresoi çështjet e integritetit. Rëndësia dhe mënyrat e integritetit të komuniteteve romë, ashkalinjë dhe egjiptas përmes medias dhe kulturës ishte tema kryesore që u udhëhoq nga personalitete të medie, kulturës, institucioneve qeveritare, organizatave ndërkombëtare, etj.

Dita e pestë e Festivalit ishte më e rëndësishme për shkak të performancave muzikore që u organizuan. Bende, këngëtarë dhe valltarë vendore romë, ashkalinjë dhe egjiptas prezantuan repertorin e tyre para audiencës në rrugën kryesore të Prishtinës dhe tërhoqën vëmendjen e njerëzve me tingujt dhe ritmet e tyre karakteristike. Artistët performonin njëri pas tjetrit duke krijuar atmosferë festive në kryeqytetin e Kosovës. Një pikë tjetër kulminante ishte dhe performanca e mysafirëve special: Okteti i Prizrenit, Ansambli Rushit Shakir dhe Toni Kitanovski & Cherkezi Orkestra nga ish republika Jugosllave e Maqedonisë.

Festivali përfundoi me projeksione të dokumentarëve për çështjet që kanë të bëjnë me romët. Dokumentarët u prezantuan në Prishtinë dhe Mitrovicë ku audiencia kishte mundësi ta diskutojë përmbajtjen e dokumentarëve me krijuesit e tyre.

Promovimi i kulturës

Përveç Festivalit, projekti zbaton edhe aktivitete që kanë për qëllim promovimin e kulturës RAE. Klubet e aktiviteteve janë grupe të artistëve të njohur vendorë (muzikantë, aktorë, shkrimtarë, piktorë, drejtorë të TV-ve) që i vizitojnë qendrat e komunitetit të RAE dhe punojnë me fëmijët që t'i zbulojnë talentet e tyre.

Përveç kësaj, një grup i shkrimtarëve RAE iu bashkëngjiti Karvanit të Shkrimtarëve të Kosovës "Agim Deva" i cili po i viziton qendrat e komunitetit dhe ndërvepron me të rinjtë përmes poezive, të cilat lexohen nga shkrimtarët. Për më tepër, projekti ka themeluar bashkëpunim me

transmetuesin publik kombëtar RTK, i cili për çdo vit krijon një TV dokumentar për Festivalin e kulturës RAE.

Pas një viti

Sot, një vit pasi filloi zbatimi i projektit, rezultatet janë tashmë të dukshme. Qendrat Mësimore janë themeluar dhe programet po zbatohen pa ndonjë problem me:

- Më shumë se 300 fëmijë që vijojnë programin parashkollor,
- 450 vijojnë programin për ndihmë me detyra të shtëpisë,
- Rreth 100 vijojnë kurset për shkrim lexim,
- 1000 nxënës kanë pranuar çanta me material shkollor dhe
- 200 nxënës dhe 20 studentë kanë marrë bursa.

Personeli i Qendrave Mësimore është në gjendje t'i identifikojë problemet me të cilat ballafaqohen nxënësit dhe i adresojnë ato me efikasitet gjatë orëve të cilat i vijojnë në qendra. Një grup i të rinjve që vijojnë trajnimet për media krijuan raporte e tyre të para që tashmë janë transmetuar në transmetuesin kombëtar të Kosovës RTK. Këto raporte mbulojnë tema si Diskriminimi i komuniteteve RAE në bazene, të rinjtë dhe muzika, dhe njerëz interesantë dhe me këtë kohë që i dedikohet këtyre komuniteteve në mediat kryesore është duke u rritur dalëngadalë. Festivali i Kulturës së romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve u shënuar me aktivitete të ndryshme dhe mjedis argëtues gjatë ngjarjeve në të cilat morën pjesë një numër i madh i të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Nëse ky trend vazhdon edhe pasi të përfundojë projekti, do të përmirësohet pozita socio-ekonomike e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve.

(Autorët janë personeli i projektit:

Përkrahja e BE-së për Zbatimin e Strategjisë RAE

Muamer Niksic, Menaxher i Projektit

Drilon Krasniqi, Koordinator i

Komponentës së Edukimit

Mimoza Gavrani, Koordinatore e

Komponentës së Mediave)

SOROS FONDI PËR IMPLEMENTIM TË RAE STRATEGJISË

Rebeka Qena



Ky projekt 3 vjeçar, i mbështetur nga fondet e ndara nga Z. Soros në konferencën e donatorëve, i filluar në vitin 2009 ka për qëllim avancimin e pozitës socio-ekonomike të komuniteteve RAE dhe krijimin e një baze institucionale për adresimin e nevojave të tyre për një integrim sa më domethënës në shoqërinë Kosovare.

Në vitin e parë, në 2009, përmes këtij projekti është përgatitur infrastruktura e nevojshme për implementim të suksesshëm të tij. Viti përgatitor u shfrytëzua për vlerësim dhe identifikim të komunave për implementim të këtij projekti. U organizuan disa punëtori planifikuese me përfaqësuesit e komuniteteve RAE dhe të qeverisë lokale dhe qendrore për të përcaktuar prioritetet dhe fushë veprimin e projektit, u kontraktuan dhe publikuan dy hulumtime të cilat po shërbejnë për të ofruar një pasqyrë më të qartë të pozitës socio-ekonomike të komuniteteve si dhe kapaciteteve ekzistuese të qeverisë në nivelin lokal dhe atë qendror për të implementuar Strategjinë RAE. Qendrat e komuniteteve janë pajisur në mënyrë që të jenë më funksionale (janë pajisur me kompjuterë, tavolina, karrige dhe mjete të tjera të punës.

Në kuadër të projektit ka filluar edhe implementimi i pilot projektit mbi avancimin e pozitës së komuniteteve RAE në fushën e shëndetësisë dhe çështjeve sociale.

Projekti, në kapacitet jo të barabartë të barabartë, implementohet në gjithsej 9 komuna: (1) Gjakovë, (2) Graçanicë, (3) Ferizaj, (4) Fushë Kosovë, (5) Mitrovicë, (6) Istog, (7) Lipjan, (8) Pejë, dhe (9) Prizren. Gjatë vitit 2010 duke pas të vendosur in-

frastrukturën e nevojshme për implementim projekti është përqendruar në objektivat në vijim:

1. Fuqizimin e të rinjve të komuniteteve RAE për të marrë një rol më aktivë në shoqëri;
2. Avancimi i bashkëpunimit në mes të përfaqësuesve të komuniteteve RAE dhe qeverisë lokale;
3. Avancimi i pozitës sociale dhe shëndetësore të komuniteteve RAE

Të rinjtë dhe roli i tyre në shoqëri

Përkrahja e të rinjve nga rradhët e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian është e një rëndësie të veçantë. Identifikimi i nevojave të tyre, rritja e vetbesimit përmes përvetësimit të njohurive të reja janë parakushte për ndryshimet pozitive në të ardhmen e afërt. Për këtë shkak këto nevoja janë përkrahur përmes projekteve të ndryshme duke filluar nga trajnimet e ndryshme për gjuhë angleze apo edhe gjuhë shqipe për të kthyerit nga diaspora.

Janë mbajtur kurse të kompjuterëve por edhe aktivitete të lira për të rinjtë (trajtime debati, shkrim të projekt propozimeve, udhëhijes së projekteve, raportimit dhe marrëdhënieve me donatorë për të ngritur aftësitë e tyre. Gjithashtu janë përkrahur edhe aktivitete të ndryshme kulturore, edukative dhe ambientale.

Avancimi i dijenisë së të rinjve nga rradhët e komuniteteve është një mjet i fuqishëm që do të mundësojë arritjen e potencialit të tyre e kështu do të sigurojë ndryshimet e domosdoshme në shoqëri të Kosovës.

Shkolla verore Soros- ide inventive që synon të ndihmojë liderët e rinj!

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të hapur konsideron fushën e edukimit si një prej fushave më të ndieshme dhe nevojat e pjesëtarëve të komuniteteve RAE janë shumë të shprehura.

Për këtë shkak KFOS-i që dy vite me rradhë ka mbajtur Shkollën verore (Viti 2010 dhe 2011) e cila ka identifikuar fëmijët / të rinjtë nga rradhët e komuniteteve me sukses të mirë shkollor nga shumë komuna të Kosovës (vitin e parë 5 komuna e vitin e dytë gjashtë komuna).

Këto kampe u kanë mundësuar pjesëmarrësve të mësojnë mbi Debatin Karl Popper, rëndësinë e iniciativave qytetare, punën vullnetare, realizimin e projekteve ndërsa vitin e dytë kanë ofruar njohuri mbi funksionimin e shtetit, gjyqësorin, Për identifikim të fëmijëve meritot KFOS ka bashkëpunuar me Drejtoritë e Arsimit, vitin e dytë Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ka bashkëfinansuar mbajtjen e Shkollës Verore dhe kjo sinergji do të vazhdojë edhe në vijim, veçanërisht pasi që edhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është zotuar se do të përkrahë mbajtjen e Shkollës Verore për vitet në vijim.

Avancimi i bashkëpunimit në mes të përfaqësuesve të komuniteteve RAE dhe qeverisë lokale

Deri më tani përmes projektit të përkrahjes së implementimit të Strategjisë për Integrim të komuniteteve RAE janë punuar Planet Lokale të Veprimit që në mënyrë të drejtpërdrejt "përkthejnë" obligimet e Komunës në nivelin lokal duke lehtësuar përmblidhjen e objektivave dhe



monitorimin e zbatimit të tyre. Deri më tani në kuadër të kësaj fushe janë realizuar Planet e veprimit lokal në Fushë Kosovë, Ferizaj, Gjakovë, Prizren dhe Mitrovicë. Miratimi i tyre nëpër Asambletë komunale është i rëndësishëm pasi që identifikon aktet kryesor lokal që do të realizojnë Planin e veprimit e njëkohësisht u ndihmon edhe donatorëve të cilët e kanë më të lehtë të koordinohen me qëllim të implementimit të hapave konkret që parashihen në dokumentet e hartuara.

Ndërmjetësimi shëndetësor /social për një jetë më të mirë

Duke synuar përmirësimin e pozitës së RAE komuniteteve në sferën e shërbimeve shëndetësore dhe sociale Fondacioni, duke u bazuar në eksperiencat e shteteve të regjionit, në veçanti në eksperiencat në Rumuni dhe Bullgari, ndërmori iniciativën e ndërtimit të modelit të ndërmjetësuesit shëndetësor/social. Ky model synon ndërmjetësimin në mes të komuniteteve dhe institucioneve përkatëse për të

lehtësuar qasjen e komuniteteve ndaj institucioneve respektive.

Këtë vit në kuadër të fushës së Ndërmjetësimit Shëndetësor është arritur përfundimi i trajnimit në gjithsejt tetë qendra të Kosovës. Trajnimi është mbajtur nga Asociacioni i Mjekëve Familjar të Kosovës ku me sukses kanë përfunduar trajnimin 20 persona.

Kësisoj tani në tetë komuna të Kosovës punojnë nga dy Ndërmjetësues që mbikqyren nga një Koordinator dhe të cilët bashkrisht me stafin e Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare organizojnë biseda me pjesëtarë të komuniteteve (temat identifikohen përmes vizitave që realizohen në terren) qofshin ata të rinj, nëna apo baballarë. Trajtohen tema të ndryshme sikur çështjet e vaksinimit (flitet për rëndësinë e vaksinimit – por edhe organizohen raunde të vaksinimit), çështja e sigurimit të dokumentacionit përkatës (me ç’rast identifikohet problemi dhe ndërmirë hapat e duhur për tu zgjidhur problemi), çështjet e punësimit, organizohen tryeza

për informim të komuniteteve me mundësi punësimi – me ç’rast ftohen edhe zyrtarët përgjegjës komunal por edhe donatorët që shpeshherë financojnë projekte të ndryshme punësimi.

Prizreni, Gjakova, Ferizaji, Istogu, Lipjani, Graçanica, Mitrovica dhe Peja janë komunat ku po zhvillohet projekti i Ndërmjetësimit – projekt ky i cili synon të kalojë nën përkrahjen financiare të Komunave respektive duke qenë se po ndikon shumë pozitivisht në ngritje të vetdijës së qytetarëve, po ofron ndihmë direkte aty ku kërkohet ndihma. Projekti njëkohësisht edhe po përmirëson lidhjen në mes të Institucioneve të Republikës së Kosovës që ofrojnë shërbim dhe vet komuniteteve. Fondacioni vazhdon me mbështetje të këtij programi meqenëse ndikimi i cili mund të arrihet përmes këtij projekti është shumë i fuqishëm dhe i nevojshëm.

(Autorja është Koordinatore Projekti në Fondacionin e Kosovës për Shoqëri të Hapur)

KULTURA ROME

Kujtim Paçaku



Parathënje e shkurtër

Duke u bazuar në filozofinë kulturore, dimë se kultura përmbledh aktivitetet më të diversuara të njerzimit. Kur ato hasen? Në jetën e përditshme që nga sjelljet e një grupi njerzish deri në krijimet e tyre shpirtërore. Antropologët me këtë term inkorporojnë në të gjitha aspektet e jetës së njeriut. Nga kjo nënkuptojmë se të flasësh për kulturën e një populli, kësaj here për kulturën rome, atëherë themi se kjo kulturë ka një spektër i gjërë përplot kolorit. Duhet përmenden segmentet kulturore siq janë: jetesa, ekonomia, relogjioni, zakonet, martesat, familjet, besimet, simbolet, krijimtaria dhe vlersimi, gjuha, të gjitha segmentet artistike, mendimet etj. Zakonisht të gjitha këto segmente të përmendura ndahen në të mirat kulturore materiale dhe shpirtërore.

Të gjitha elementet konstituive ose bërësit e kulturave mund ti gjejmë edhe tek romët. Duke u bazuar në prejardhjen le të kuptohet se kultura e romve ka shumë ngjajshmëri me ate induse. Që nga migrimi i romve, nga pjesa veriore e Indisë-Kanauxh, në vitin 1017-18, gjerë më sot, romët edhe krahas peripetive shekullore historike, ata kanë ruajtur shumë elemente kulturore që padyshim flasin për kulturën dhe identitetin e tyre. Të përmendim vetëm disa: zakonet, doket, gjuha, simbolet, mënyra e jetesës, dasmat etj.

Në kulturën rome pa dyshim se haset edhe ndikimi i kulturave tjera, të popullit mazhor, ku romët jetojnë faktikisht në ndikim nga kulturat të popujve tjerë, që kanë kulturë më të zhvilluar. Por, çuditërisht se baza, lajtmotivet, motivet,

esenca e kulturës rome nuk është humbur, siq janë: gjuha, kënga, doket, zakonet, besimi, gjegjësisht kultura shpirtërore.

Kur jemi të ndikimet, aëherë themi se në kulturën rome, aty ku ata jetojnë si popull minoritar, aty vërehen edhe ndikimet nga popujt tjerë. Vlen përmendet ndikimet nga kulturat persiane, jermene, arabe, turke, greke, sllovenëve të vjetër, iliro-shqiptare etj. Të gjitha këto elemente "të huazuara" nga kulturat e popujve tjerë në kulturën rome, mund të themi se këto janë futur në "dhjamin" e kulturës tradicionale rome të cilat edhe tani promovohen me dashuri të madhe dhe respekt ndaj elementit kulturor, po cili ai të jëtë.

Tre elemente : Fati, dashuria dhe liria

Siq e kanë vërejtur dhe studiuar hulumtuesit duke thënë se kultura rome afirmon njeriun dhe vlerat njerëzore, në mes të cilave vlera rrjedh diçka e çuditshme që le të kuptohet shumë qart se fati, dashuria dhe liria janë ato elemente të cilt kanë vend qëndror në suatzat e kulturës dhe jetesës rome.

Gjenocidi dhe asimilimi historik ndaj romëve shpie deri te akulturimi i kulturës rome. Por, edhe krahas këtyre presioneve, që ti mos i përmendim tani ato vende, sepse do ty hyn ne hak historinë. Të themi edhe krahas formave rudimentare ndaj romve, përsëri romët kanë ruajtur atë që kanë në shpirt-kulturën.

Arti

Për të ilustruar më mirë kulturën rome, atëherë do ti përmendim disa vende

ballkanike, ku romët ishin edhe bartësit e kulturës muzikore. Ata në shek. XIII, kur mbërin në vendet mesdhetare ballkanike, lajmërohen si "phirne zanatlie" mjeshtër zejesh si bartës së kulturës së zejeve. Duke bredhur nga fshati në fshat dhe nga qyteti në qytet, ata me punën e tyre kanë kontribuar në farkim përpunim të hekurit, bakrit etj. Nga prodhimet e tyre me përemër pronor "i/e romeve ose rome "siq janë: gozhda, (karfin) gozhdë e gjatë (klinco), gozhdë për derë (pull-lia), turjelë, patkua, karriga metali, mjete të ftohëta lufte, si dhe prodhime prej druri, lugë, vaskë për larje, sita, pjata etj.

Duke u bazuar në një thënje europiane dhe të logjikshme, se të dituritë shkrimlexim është bazë e kulturës, mu kjo bëri që kultura të jetë fitore ndaj kohës. Në shumë raste tek romët nuk hasim kulturën e shkruar mbi dhe për romët. Është kjo kulturë e cila me gjelozi dhe dashuri është trashiguar prej brezi në brezë. Legjendat, mitet sot e kësaj dite flasin shumë mbi kulturën rome.

Në kohëra të migrimit të romëve nga India, hasim shenja konvencionale të cilat shërbenin për marveshje vizuale, caktimin e vendit dhe të kohës. Këto shënje quhen "shikajmako" ose "patrina" (gjethet e drurit), nga se për tu kuptuar kanë përdorur gjethet ose në dru gryhej druri (vizatohej) shenja e duhur, 19 të tilla ishin nga këto shenja. Ishte kjo një retrospektivë e shkurtër mbi kulturën rome në përgjithsi. Por të flasësh për dhe mbi kulturën rome duhej kohë më e gjatë. Në shkrimin tonë tani do të ndalemi vetëm në ato më karakteristike që edhe sot në

shekullin e ri kratakerizon romët me kulturën e tyre:

... gjuha ende e gjallë

I takon familjes së madhe indo-europiane e cila përmes sanskritit ka aritur në Ballkan. Ajo në mesin e tërë romëfolësve thuhet e njëjtë, "Romani hib-gjuha rome"

Sot këtë gjuhë në Europë e flasin mirë mbi 12 milion rom të deklaruar dhe numër i madh më vogë se ky, ata të asimiluar. Përbërja e gjuhës rome është dialektore, ka strukturat e saja dhe është e kuptueshme për tu folur. Gjuha rome është shumë e kuptueshme sidomos në segmented kulturore, në kengë, doke, zakone, përalla, legjenda etj.

Religjioni dhe besimi:

Pasi që kemi të bëjme me religjionin dhe besimin, i pa evitueshëm për tu përmenduar emri Zot. Në gjuhën rome për emrin Zot, thuhet Del (lexo Dell) ose Devel. Kjo fjalë ka domethanë për madhësi që jep çdo gjë, Diell, Qiell, Tokë, Ujë. Emri Del ose Devel, përmendet në çdo religjion ose besim siq tek popujt tjerë poashtu edhe tek populli rom. romët çdo herë marrin besimin dhe religjionin aty ku jetojnë, në mesin e popullit mazhor. Trajtohen si besimtar të devotshmë cili do religjion t'i takojnë.

Bibi (Halla)

Krahas religjionit si pjesë e kulturës, ata kanë mbajtur besimet e tyre. Të festuarit e Bibi-t (hallë-s) ose në vendet tjera ballkanike si Kali Sara (Sara e Zezë), që flet seromët në Indi, festuan kultin "Shivi" i kan takur sektës Sakti, sektë e cila karakterizohet me kremtën e festive. Bibi, kremtohet zakonisht në fund të çdo muaji, Janar. Ajo festohet që të realizohen dëshirat një familje rome. Dëshirat më të shpeshta janë: martesat me personin/en e dëshiruar, lidjet, ndërtimi i shtëpisë, punësimi, shërimi i të sëmurve e të tjera. Në kremtë ftohen të afërmit e asaj familjës.

Elementet të cilat përdoren gjatë festës janë: qirinjtë e ndezur, stolit nga arit, pasqyra, krehëri. Këto elemente kanë edhe simbolikën e tyre; qirinjtë sim-



bolizojë dritën, stolit nga ari-pasurinë në familjë, pasqyra-ka simbol se pas ushqimit "besohet" se do të vie Bibi e bukur që të shiqohet në pasqyre dhe krehëri- që ajo do të krehet. Enët, lugët e asaj darke në atë mbrëmje nuk pastrohen, me pretekst se do të vie Bibi, të shiqoj se ajo familjë ka kremtuar festën.

Muzika dhe vallet rome

Duke u bazuar se në Indi, se çdo art është jogë, e ajo ka respekt të lartë, poashtu kuklturën muzikoreromëte konsiderojnë dhe e trashigojnë me respekt të posaqëm. Muzika induse e cila dukshëm dallon nga ajo evropiane, shumë ka ndikuar në muzikën në kontinentin e Azisë, pos atyre në Kinë dhe Japoni. Me këtë vlen kuptohet se muzika rome ka një korelacion të dukshëm me kulturën muzikore të e popujve të persisë, avganistanit, asaj arabe, turkmenistanit etj. Muzika rome, siq thonë kompozitorët e shquar, ajo ka kualitet sensibil, ajo është spontatinet gëzimi, çuditrisht ajo në një mënyrë ose tjetër shpirtisht lidh ekzekutuesin e muzikës dhe dëgjuesin. Ritmi, muzika, në ndërkohë janë mendim hareje, ritëm i zemrës dhe rrjellëshmëri e gjakut në trup.

Kjo kulturë e artit muzikor, shpeshë merr edhe elemente të popujve tjerë, elemente të cilat futen në muzikën rome dhe respektohen barabar në tërësi të vijës muzikore ose të kengës. Është in-

teresante se fjala muzikë nuk ekziston në shprehjen rome, për muzikë ekzaktë romosht thuhet: "ba alipe-n" si shprehje onomatopeike që do të thotë muzikim. (nga sanskritishtja bha, që do të thotë gjënim ose gurgullim).

Muzika rome para se gjithash është muzikë vokale, e cila shpreh zkonisht, fatin, jetën filozofike të këtij populli. Karakteristike është edhe kjo seromët-për këngët e tyre shpeshë thonë: "amare dila isi dukhavne-këgët tona janë të dhimbshme". Poashtu, teskti i këgve rome ka të bëjë në dialog me Zotin, jetën, dashurinë, vdekjen. Si shembull për muzikë të mire shumë kompozitor janë frymëzuar nga muzika rome siq janë: List, Bize, Brams, Kodalj, Bartok etj.

Muziktarët rom japin edhe kontributin e tyre përmes muzikës rome edhe popujve tjerë. Shembull marim shtetet si India, Hungaria, Spanja, Turqia shtetet e europës lindore si dhe ato ballkanase. Karakterizohet momenti se shoqatat muzikore në Ballkan dhe popujt e përmendura dhe me gjërë, në radio stacionet e tyre, televizionet, koncertet muzikore, dasmat, ahengjet e ndryshme, nuk janë paramenduar pa prezencën e muziktarëve ose këngëtarëve rom.

Me këte vërejmë seromëtkan dhënë kontribut të madh në kulturën muzikore tek popujt tjerë por, edhe kanë marrur



elemente muzikore dhe kulturore nga popujt tjerë duke i respektuar ato. Edhe vallet rome si kultur e tyre nuk dallon aq shumë nga muzika. Ndoshta aq shumë jo në Ballkan por sidomos në Spanjë, në pjesën aziatike të Turqisë dhe kontinentit të gjërë aziatik gjurmët kulturore të koreografisë gjegjësisht të valleve janë të mëdha. Le të përmendim Flamenco në Spanjë si dhe kostimografin e tyre ose vallet Qardash, Verbunktos, në Hungari.

Kultura muzikore dhe grupet e saja
Janë katër grupe kryesore të kulturës muzikore tëk romt, zakonisht këto i hasim në isht republikat e jugosllavisë së atëhershme. 1) *Kultura muzikore e sheteteve lindore*, 2) *Kultura muzikore e evropës së mesme*, 3) *Kultura e vjetër muzikore ballkanike*, dhe 4) *Kultura muzikore rome*.

Kultura muzikore e sheteteve lindore, me dekada dhe shekuj të tërë romët kanë muzikuar në kohën e perandorisë osmane. Që nga kjo periudhë romët japin dhe marrin elemente të muzikës gjat muzikimit në

panaire të ndryshme, ahengje, dasma etj. Në këto mënyra romët njihen me kulturën e përgjithshme të shteteve të lidjes, kryesisht të muzikës turke. Jo vetëm muzikën, por edhe mënyrën e jetesës, doket, zakonet, religjionin. Sidomos në orkestrat rome që nga shekulli XX, vërehen orkestrat të pasura me prejardhje të instrumente të shteteve lindore, siq janë: klarineta, daullja, defi, zurla si dhe vallet dhe kostumografia.

Kultura muzikore e evropës së mesme, ka të bëjë edhe migrimet e romve të vazhduara edhe përmes shteteve të evropës së mesme në vendet ballkanike, sidomos përmes austro-hungare vendet e ish jugosllave. Ata në këto vende sjellin edhe përbërjen e orkestrave të ndryshëm në krahasim me ato të sheteve lindore. Tani hasim në orkestra rome, viola, violina, cimballo, bas. Krahas këtyre veglave muzikore, kemi edhe vallet hungareze, doket, zakonet, të cilat janë sjell nga evropa e mesme përmes shteteve austro-hungare që të gjitha këto kultivohen edhe sot zakonisht mbeten në pjesët veriore të ish ju-

gosllavisë.

Kultura muzikore e vjetër ballkanike, në këtë grup bënë pjesë muzika në përgjithsi dhe kultura muzikore, tek popujt ballkanike, rumune, shqiptare, greke etj. të cilën me shekuj e kanë kultivuar edhe romët në mesin e tyre dhe e kultivojnë edhe sot.

Kultura muzikore rome, tek ky grup kemi këngët autohtone rome. Këto këngë këndohen në koncerte të romve, dasma, ahengje. Por për shkak të interesit ekonomik të romve, këto këngë nuk i këndojnë ata nëse punëdhënësi nga ata kërkon këngë tjera. Sot, reputacioni, fondi i këngve rome është i madh dhe le të kuptohet se muzika rom dhe vetëromëtjanë mjaft të të ngritur nga ky aspekt. Përfundimisht të përmendim emrat e muziktarve rom të cilët kanë hyrë në analet e historisë së muzikës: Raya dhe Natasha Udvokova, Cinka Pana, Bihari, Xhango Ranjhart, Citrush, Esma Rexhepova, Shaban Bajramoviq e shumë e shumë të tjerë.

Tregimet popullore dhe poezia

"Kush e ble atë që nuk i duhet, do të shes atë që i duhet"

Tregimet popullore në përgjithësi janë të vjetra aq sa është i vjetër vetë populli. Kultura rome në tregimet popullore është shumë e begatshme. Ajo kryesisht është bartur prej gjeneratës në gjeneratë. Kryesisht nga shekulli i kaluar e kemi në literaturë, por para shumë vitesh jo. Në tregime zakonishtromëtpërshkruhen si të varfër, protagonist në tregime të cilët karakterizohen si shpirtmirë, human, paqësor por edhe komik. Në tregimet rome gjejmë edhe fjalë të urta popullore mbi romt. Do ti përmendim disa sa për ilustrim: "Kush ka dhëmbje në kokë, ai kokën e lidh" "Çfarë është fshati, ashtu janë romt", "Kush ble atë që nuk i duhet, do të shes atë që i duhet," "Paraja dhe djalli nuk rrin të qetë".

Si pjesë e letërsisë, poezia rome tërheq vëmendjen e shumë humltuesve letrar. Siq e vlerësojnë kritikët dhe artistët, poezia e këtij populli është identike me jetën e tyre dhe shpirtin. Ajo është e afërt, e kapshme për vesh, shpirt dhe emocione, është shpesh naive por thellësisht e sinqertë. Shumë shkrimtar botëror, me dashuri të madhe e kanë dëgjuar poezinë rome. Disa prej tyre me dëshirë marrin motive nga poezia rome për ti përdorur në veprat e tyre. Prej atyre që bënë emër në poezinë rome përmendim ca emra, siq janë: Bravislava Papusha, Manush Romanov, Sali Ibrahim, Jovan Nikoliq, Mehmet Saqipi, Ali Krasniqi, Florina Zoltan, Kujtim Paçaku... Shumë poet rom identifikohen në poezitë e tyre përmes dashurisë, shpirtit rom, këngës, nënës natyrë, ose vuajtjeve të migrimit, le ta ilustrojmë vetëm pakëz:

*Njëmijë vjet kemi bredhur.
Zemrat e ngrira,
Gjaku ynë na i ka ngrohur....*

*Unë jam pyll i prerë
Dhe jam pluhur rrugësh.
Jam fole e vjetër
E zogjve të shpërndarë....*



*... dhe zjarri i dashurisë:
Në të cilin ngrohemi
Ne të dy.*

*Zjarr ky që djeg
Pa bubullimë
Pa vetëtimë
Pa tym.*

Ky pra është zjarri i të gjitha zjarreve.

Doket- Zakonet

"... edhe gruri hedhet mbi nusen"

Në gjuhën rome nuk ekziston fjala doko ose zakon. Për këto fjalë thuhet zakonosht në kontekst të fjalës thuhet "puranimata" të vjetrat, ose shpjegohet "kështu kanë bërë të parëet tanë, po e bëmë edhe ne". Do të thotë se këto zënë vend në traditat e vjetra dhe besimin nga romt. Ritualet e dokeve janë të trashiguara nga të parët e tyre dhe ruhen shumë në mënyrë konfidenciale. Doket ose zakonet i vërejmë gjatë lidjes së femiut, martesave, tek gruaja shtatëzene, sëmundjeve të ndëyshme dhe ceremonive mortore. Shembull sa për ilustrim cekim gruan shtatëzënë (khamni rromni) e cila në bashkësi ka definicione dhe përpasi të mëdha.romëtthonë se "ajo ka tani dy shpirta" Në shumtën e rasteve si zakon është që shtatëzona të mos tregojë personave jashtë bashkësisë kur ajo ka kohën e lindjes, me pretekst se

mund t'i ndodh diq jo e mirë. Anëtarët e bashkësisë asgjë nuk guxojnë të hanë fshehurazi nga shtatëzëna. Nuk guxon as ajo të të hanë fshehurazi sepse mendohet se në frytin e fëmisë do të bëhet ndonjë shenjë. Është një ritual interesant tek shtatëzënat se tek kremtimi i festës së Herdelezit- Shën Gjergjit, që romët e festojnë me të madhe këtë festë. Në atë mbrëmje nën një pemë vëhet ose shtrohet një nga robet e mbrendshme të shtatëzanes dhe qëndron tërë natën nën pemë. Nëse atë natë mu mbi atë robe të shtatëzanes bie ndonjë fletë e pemës, konsiderohet se shtatëzëna do të ketë lindje të lehtë. Doket ose zakonet e romve si pjesë e kulturës së tyre i vërejmë që nga lindja dhe tërë jetën e tyre. Beba e posalindur së pari duhet thithë gjirin e djathtë të nënës dhe atëtarët e familes e beben pagëzojnë me një emër intern duke ia thënë emrin në vesh disa herë, më pas femën e pagëzojnë me emrin që të gjithë e dinë.

Edhe martesat kanë karakteristikat e tyre. Përdoret sita e miellit për shenjë bereqeti në shtëpi. Vjehra (i/e sasuj) me ardhjen e nuses në shtëpi, ajo hedh mbi nusen grurë për të sjellur nusja bereqet në shtëpi.

Zakoni është zakon, adeti –adet, që edhe shumë kohë do të jetë në mesin e kulturës rome, për tu identifikuar ky popull dhe për një diversitet më të begatshëm.

ROMËT – KULTURA DHE IDENTITETI I TYRE

Ibrahim Elshani



India – djepi i kultures dhe i civilizimit botëror

Romet origjinën e kanë nga India. Kultura dhe historia e saj është shumë e vjetër: "Vedet" (Diturite), me kater librat e saja: "Rgveda", "Samaveda", "Jaxhurveda" dhe "Atharvaveda". Rgveda është shumë e vjetër, e cila është duk kah sh. XIII p. e. Pastaj, monumentet grandioze, fantastike dhe marramendese. Pas kesaj, le të përmenden epet, "Mahabharata" dhe "Ramajana", të cilat janë epet me të mëdha në bote. Mahabharata përmban afër 200 000 vargje, e cila nuk ka mundur të botohet teresisht asnjëherë. Për të, Nehru ka thënë: "Ajo është enciklopedia e traditës dhe e legjendave, e institucioneve politike dhe shoqërore të Indisë antike", ndërsa filozofi gjerman, Shopenhauer, për pjesën e saj, "Bhagavat Gita", ka thënë: "Ajo është lektura me mesonjëse dhe me të lartë në bote: ajo ishte lehtësim i jetës sime dhe do të jetë lehtësim për vdekjen time".

Romet nga India kanë migruar kah sh. X. Popujt nga të cilët rrjedhin romet janë: Banxhara në Raxhastan, me kryeqytetin Xhampur, Gadulia në Panxhab – Qandigar, Lohari në Maharashtra – Mombaj (Bombaj) dhe Andra Pradesh – Hajderabad, si edhe Kandahari. Nga India kanë migruar në dy drejtime: kah Afganistani, Persia, Armenia dhe Rusia, dhe kah Afrika veriore: Egjipti, Alxheri, Maroko, Tunisi, dhe prej aty në Spanjë, Francë, Itali, Gjermani, deri në vendet skandinave. Në Ballkan kanë arritur me Turqit (sh. XIV).

Romet në Kosovë janë minoriteti etnik. Si minoritet, ata duhet të ruajnë vecoritë e veta etnike – nacionale, të ruajnë gjuhën e vet, kulturën, doket, zakonet e traditat, muzikën e vet, veshjen, vetëdijen mbi perkatesinë nacionalitetit të vet, religjionin etj.

Gjuha si vecori i identitetit etnik Romet, si u thënë kjo me lartë, origjinën e kanë nga India, të cilët nga India kanë filluar të migrojnë në sh. e X. Nga India, botën në sy e kanë marrë shtresa me e varfur, e cila nuk ka sjellur me vetë asgjë, as gjuhën, as kulturën, e cila në Indi ka qenë shumë e zhvilluar, pasi, siç dihet, India konsiderohet djepi i kultures dhe i civilizimit botëror. Romet, duke kaluar nga një vend në tjetrin, nga vendet e ndryshme kanë marrë shumë fjalë. Me se shumti nga greqishtja dhe persishtja. Por, megjithatë, romet e kanë ruajtur gjuhën e vet, ashtu që sot romet e kanë dhe e flasin, si edhe e shkruajnë gjuhën e vet. Gjuha rome shprehet me dy dialektet kryesore: dialekti Arli dhe ai Gurbet. Dialekti Arli përfshinë të folmen e Ballkanit, i cili haset në Bosnë, Serbi pa Vojvodinën, Maqedoni, Bullgari, Turqi, Greqi, Shqipëri dhe Kosovë. Ai Gurbet flitet në vendet e Evropës veriore, në Hungari, Rumani, Poloni, Gjermani, Rusi etj.

Si u thënë me lartë, dialekti Arli paraqitet në Ballkan. Në vendet e përmendura të Ballkanit, gjuha në përgjithësi është e njëjte, me disa ndryshime të vogla, të cilat janë lokalizmat. Lokalizmat janë evidente edhe në një vend, ashtu si është kjo edhe me të folmet e të tjerëve.

Në Kosovë flitet një gjuhë e njëjte, me disa ndryshime të vogla në disa vende të saja. Për këtë arsye, romet e Kosovës janë paraqitur me një shkrim të njëjte, i cili është shprehur në disa shkrimet tona: revisten "Romano alav" – "Fjala rome", me 13 numrat e saja, magazinën "Yekhipë" – "Bashkimi", 37 numra, e cila është në dalje e siper.

Mund të përmenden edhe disa përkthime, si janë: Rabindranat Tagora, "Gitanjali", poema indase "Mahabharata", si edhe

"Iliada" dhe "Odiseja" e Homerit, cdonjëra prej tyre në mbi 650 faqe. Është përkthyer edhe drama klasike indase e dramaturgut Kalidasa, me emrin "Sakuntala", e cila është e përkthyer në shumë gjuhë botërore, edhe në gjuhën shqipe qëysh me 1933 dhe ribotimi i saj me 1970 në Prishtinë. Le të përmendim edhe veprën "Publicistika, Gjuha rome, Kritika letrare", në 400 faqe, në të cilën është shkruar për pyetjet e ndryshme lidhur me problematiken rome, me qëndrimet kritike lidhur me nënçmimin dhe injorimin e romeve në mediumet e shkruara dhe ato elektronike, pastaj lidhur me gjuhën rome, se si gjuha rome të flitet drejtë e pa gabime, si edhe kritika letrare rome, shkrime keto të cilat hasen vetëm të ne. Vlen të përmendet edhe përkthimi i romanit të famshëm i Ismail Kadarese, "Gjenerali i ushtrisë së vdekur". Në botim e siper janë edhe romani i romancierit turk, Orhan Pamuk, "Une jam e kuqe", si edhe romani autobiografik i Kryetarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Barack Obama, "Guximi për të shprehur". Vlen të përmendet edhe vepra e shkrimtares kroate, Vesna Krmpotiq, me emrin "Një mijë lotosa", e cila është në botim e siper.

Keto janë disa prej shkrimeve modeste në gjuhën rome në Kosovë.

Kur është fjala për standardizimin e gjuhës rome, ajo ende nuk është evidente. Me këtë pyetje ende duhet të pritët, ndoshta edhe një kohë prej me shumë vitesh, ashtu si është bërë kjo me gjuhët e tjera, si për shembull me gjuhën shqipe, ku është pritët afër 200 vite, duke u shkruar gjuha në dy dialekte, dhe ajo ende është problem.

Gjuha rome ende është e pa zhvilluar dhe e pa gatuar. Ajo duhet të trajtohet për nga

pyetjet e ndryshme gjuhesore, pas kesaj mund t'i hyhet standardizimit te gjuhes rome.

Ne ne Kosove do ta vazhdojme te folmen tone me shkrimin tone, te cilin jemi duke e perdorur qysh para 30 – 40 vitesh. Lidhur me kete, eshte bere nje bisede ndermjet nesh dhe dr. Marsel Kurtiades, qe tani per tani, te perdoren te dy te folmet, e folmja Arli dhe Gurbet, dhe te dy shkrimet, ai i yni dhe ai i autorit te permendur.

Emri si tregues i identitetit etnik

Nje rol te rendesishem per te treguar identitetin tone nacional, luan emri dhe mbiemri i personit. Nga emri kuptohet cilit nacionalitet i perket nje individ. Keshtu, kur permenden emrat dhe mbiemrat Gezim Berisha – Teuta Rogova, Muhamed Ali – Leila Bajram, Ferdi Kocbashi – Sevim Karabeg, Franc Bekenbauer – Urlike Shnajder, Xhon Kenedi – Aleksis Majler, Lajosh Zilahi – Erzhebet Farkash, Zhan Pier – Brizhit Bardo, Nikolaj Korsakov – Tatjana Goncarova, Miguel Servantes – Karmen Himenez, Franquesko Petrarka – Paola Tomazini, Ahiles Onazis – Penelopa Dimitrios, Mao Ce Dun – Sun Xhat Sen, Xhavaharlal Nehru – Sirimavo Bandaranaike, dhe emrat e mbiemrat e popujve te tjere, e dijmë edhe perkatesine nacionale te tyre, se Gezimi – Teuta jane te perkatesise shqiptare, Muhamedi – Leila arabe, Ferdi – Sevim turke, Franci – Urlike gjermane, Xhoni – Aleksisa angleze, Lajoshi – Erzhebeta hungareze, Zhani – Brizhita frenge, Nikolaji – Tatjana ruse, Servantesi – Karmen spanjole, Franquesko – Paola italiane, Ahilesi – Penelopa greke, Mao – Suni kineze, Xhavaharlal – Sirimavo indase.

Emrat jane te lidhur me gjuhen, me kulturen si edhe me historine e nje nacionaliteti. Keshtu, emri Gezim ipet duke pas parasysh gezimin, Teuta na asocionon mbretetreshen shqiptare Teuten; Muhamedi na perkujton profetin Muhamed, Leila, emri me i njohur arab, qe do te thote nate, na e perkujton Gjulieten (Romeo e Gjulieta) dhe keshtu eshte me cdo emer tjetër.

Si u pa, emrat ipen duke pas parasysh gezimin, miresine, lirine, bukurine, burnine, forcen, por edhe lulet, kafshet si edhe konceptet tjera, sikunder qe ipen lidhur edhe me kulturen dhe historine nacionale. Koheve te fundit, si na, ashtu edhe te



tjeret, emrat i japim pa shikuar gjuhen, kulturen etj. Keshtu, ne mode jane emrat e artisteve, miseve etj.

Ne romet, emrat i japim sipas vendit ku jetojme, duke pas parasysh gjuhen e vendit, kulturen, historine si edhe religjionin. Edhe nga emrat tregohet asimilimi yne. Ne Kosove, shumica e romeve emrat i japim ne gjuhen shqipe, kulturen dhe historine shqiptare. Kemi edhe emra nga gjuha turke e arabe, si edhe emra te tjere. Ne romet, prejardhjen e kemi nga India. Per mbajtjen dhe ruajtjen e identitetit tone nacional, vecorite specifike etniko – nacionale, kulturen tone, traditat, gjuhen tone, emrat tona duhet ti japim duke pas parasysh prejardhjen tone. Trajtimi i kesaj problematike e ka rendesine e madhe kur e kemi parasysh asimilimin tone. Keshtu, na deri me tani kemi humbur shume vecori te identitetit tone. Pas nje periode, do ti humbim edhe me shume, dhe keshtu do te humbim teresisht. Prandaj, si u thene me larte, duhet te tregojme nje aktivitet, te zgjohemi nga letargjia se jemi mire, se neve nuk na duhet asgje, e sidomos ta thejme mendimin se ne romet nuk mund te bejme asgje ne pikepamje te zhvillimit e perparimit tone.

Nje iniciative per ruajtjen dhe mbajtjen e identitetit tone, para 20 vitesh (me 1985), e ka bere Hilmi Jashari ne dramen “Ne

rruge”. Ne drame, emrat e personazheve kane prejardhje nga India, gjegjesisht personazhet i kane “emrat tona”, si jane: Indira, Sadari, Anandi, Sinha, Samini, Mirani. Sic shihet, emrat jane vertet shume te bukur e shume muzikal, te cilat duhet te hasen – gjenden ne jeten tone, prej tani t'i ipen djemeve e vajzave tona. Ne fund, le ta kemi parasysh Indin, e cila eshte nena jone. Le ti kemi parasysh disa emra te gjinise femrore e mashkullore, te cilet jane me te njohur e me te shpeshte ne Indin e sotme, si jane: Indira, Sakuntala, Anila, Anita, Gita, Dushjanta, Maja, Shila, Sugjita, gjegjesisht Gandhi, Nehru, Amit, Krishna, Mohan, Arun, Kamal, Ramesh, Sanxhi, etj.

Nese per asgje nuk kisha mundur te thene me siguri te plote, kjo mund te thuhet per emrat e permendur, te cilet vertet jane shume te bukur e muzikal. Edhe domethenia e tyre eshte shume e mire, sikunder qe eshte edhe me emrat e te gjithë popujve. Keshtu, emri Indira do te thote Zoti i Henes. Edhe India eshte “Toka e Zotit”, si eshte quajte ajo nje kohe. Emri Sakuntala eshte i njohur nga poeti – dramaturgu Kalidasa, i cili e shkroi dramen “Sakuntala” (Unaza e humbur), per te cilen poeti Gete u shpreh me fjale me te larta. Emri Gandhi, babai i Indise, Nehru, kryetari i njohur indas, Arun – Diell, e keshtu me rra-

dhe, cdo emer tjetër e ka domethenien e vet.

Mendimi ynë lidhur me vecoritë e identitetit etnik, vecmas lidhur me emrat tona rome, me të cilat kishte me u tregue dhe me u ruajte identiteti etnik, janë emrat tona nga gjuha jone, nga kuptimet e gjuhes sone. Emrat e tillë kishin me qene sipas kuptimit të gjuhes sone, mu ashtu si ipen emrat e të gjithë popujve nga kuptimi i atyre gjuheve. Por, sic u thene kjo me larte, emrat mund të ipen edhe sipas tingllimit, muzikalitetit, pa pas parasysh domethenien e tyre. Ne vazhdim do të ipen disa propozime të emrave tona në gjuhen tone rome. Keto emra kishin me qene: Kamlie, Kamlan, Luludie, Luludjan, Laqie, Bahtalie, Bahtalan, Loshalie, Loshaljan, Sastran, Tromalan, Dudie, Dudjan, Nadarjan, Usharjan, Usharnie, Devlan, Devlanie etj, etj. Tani për tani kishte me u filluar me keto emra sipas propozimit tone, ndersa emrat tjera mund të ipen sipas dëshires, në baze të kuptimit të gjuhes sone. Në fillim sigurisht që do të jetë vështirë të ipen emrat e propozuar, por duhet të ekzistojë guximi që të thehet akulli. Besojmë se pas emrave të para, do të shkojë lehtë dhe pa pengesë, ashtuqë emrat e tilla do të jënë normale.

Kjo me sa thene për emrin si tregues të identitetit etnik të personit, është mendimi ynë për ruajtjen dhe mbajtjen e identitetit tone, të kultures sone, traditës, gjuhes dhe perkatesise sone nacionale. Por, miret me mend se emrat nuk mund të ipen normativisht. Ketu është dhënë një propozim, i cili në jetën tone duhet të realizohet me një gradualitet, jo për njëherë. Pra, kuptohet se nevojitet një periode që mendimi i paraqitur të shohi dritë, që se shpejti ti degjojme emrat tona rome.

Muzika dhe veshja – tregues të identitetit etnik

Romet janë popull muzikal. Është e mirënjohur se romet muziken e kanë në gjak, se romet e muzika janë kuptime të pandashme. Ata qysh prej femijerisë se hershme violinen e kanë në duar, ashtuqë violina është lodra e parë e tyre.

Romet në cdo vend janë muziktarë të njohur. Në cdo lokal gjenden orkestrinat e tyre. Edhe dasmat e gazmendet nuk mund të mirren me mend pa grupet e muziktarëve rome. Keshtu, ata me muzi-



ken e tyre dhane kontributin në zhvillimin e muzikes vendase. Edhe në Kosovë deri vonë romet kanë qene të vetmit muziktarë.

Për muziken rome kanë fol muziktarët e kompozitorët e njohur botëror. Në Hungari, kompozitori, pianisti dhe dirigjenti i njohur botëror, Franc List (she. XIX), komponoi në muziken rome, ndersa Bela Bartok, kompozitor e pianist bashkohor, të cilin një pjesë e veprimtarisë është e përshkuar me folklorin e muziken rome, vecmas i kushtoi rendesi mbledhjes së

muzikes rome. Vec kësaj, në Austri është ngritë edhe permendorja një muziktar rom.

Muziken dhe tematiken rome në muzikë e kanë trajtuar edhe Zhorzh Bize, me operen "Karmen", pastaj Johan Shtrausi i Ri me operet fantastike "Romi baron", si edhe shumë muziktarë e kompozitorë të tjerë, por në ketu nuk po i paraqesim me tutje, pasi kemi parasysh orientimin tjetër, muziken rome dhe me anë të saj shprehjen dhe ruajtjen e identitetit rom. Si është e njohur, në cdo vend romet e

bejne muziken e vendit, duke pas parasysh melosin dhe frymen e muzikes se vendit. Keshtu, Ne Spanje muzikohet sipas melosit, frymes e mentalitetit spanjoll, duke pas parasysh ritmin, melodine e harmonin spanjolle. Le ta permendim si kuriozitet flamenkon, me ritmin fantastik, me melosin por edhe me veshjen shume terheqese e bizare. E tani, poashtu per kuriozitet, le ta permendim edhe veshjen "xhipsi" te romeve, e cila eshte modifikim i veshjes indase. Veshja xhipsi, me vecorite tipike te romeve: koloriti (llojlojshmeria e ngjyrave), me shume stolisje ne duar e trup, me modelimin karakteristike, me barkun e zbuluar, vecori keto te cilat jane sjell nga India, sot eshte bere veshje kombetare rome. Keshtu, per sa i perket veshjes, kishim per te thene se eshte arite dhe eshte bere nje krijimtari adekuat e sukseshme e veshjes rome.

Pra, si muzika, ashtu edhe veshja flamenko ne Spanje, jane krijimtari rome, e cila eshte duk qysh ne qendren arkitekturnale dhe skulpturale ne "Al – Hambra" te Spanjes.

Keshtu, duhet te behet nje orvatje edhe me muziken rome, me te cilen duhet te shprehet e te tregohet identiteti yne. Muzika rome, ne cdo vend duhet te zhvillohet sipas melosit, harmonise e ritmit specifik rom. Per tu arite ky qellim, ne nje ane orientimi duhet te behet ne muziken indase, duke i pas parasysh elementet e muzikes indase, ndersa ne anen tjeter, te kihen parasysh edhe elementet e muzikes vendase. Ne kete menyre arihet nje krijimtari e re, krijimtari origjinale dhe specifike rome. Nje muzike e tille eshte bere ne Gjilan para luftes, por, ajo ka qene elementare dhe e pa mjaftueshme. Krijimtaria e tille eshte duke u pare diteve te sotme ne Shqiperi, ne Maqedoni etj. Ne kete menyre, muzika e tille, dita – dites, po behet realitet shume i degjuar, realitet shume terheqes dhe atraktiv.

Sa i perket veshjes rome ne Kosove, ajo eshte e larmishme. Ne nje ane perdoret veshja vendase, me elementet turke si edhe arabe: dimia me kemishe te qendrisur, me jelek, mintan dhe dollame shume te bukur dhe terheqes, me tasves dhe me lule te punuara, te ngjyrave te ndryshme etj. Kjo veshje duhet te perdoret edhe me tutje, pasi eshte tradicionale kosovare. Por, pas kesaj veshjeje, patjeter duhet te perdoret edhe veshja shume e njohur

rome, veshja "xhipsi". Edhe kjo veshje eshte shume e bukur, shume terheqese, atraktive, e cila, koheve te fundit po behet "hit", e cila po perdoret edhe nga te tjeret. Ne fund, ne romet duhet te tregojme se prejardhjen e kemi nga India. Ne Indi perdoren shume lloje te veshjeve sipas vendeve. Por, njera prej tyre eshte me e njohur, me tipike dhe me karakteristike, e cila quhet "sari". Kjo veshje eshte shume e bukur dhe shume atraktive. Ne ne Prizren, qysh me heret e kemi perdorur kete veshje ne solemnitetet folklorike, ne rastet e koncerteve tona. Por, ajo eshte duke u perdorur edhe ne rastet e gazmendeve dhe dasmave tona. Keshtu, pra, romet dallohen me tri veshjet e perfolura dhe te permendura, te cilat perdoren ne Kosove.

Përkatesia religjioze e romëve

Religjioni i pare i romeve ka qene ai budist. Por, romet, gjate migracionit, duke kaluar prej vendit ne vend, e kane marre religjionin e vendit te caktuar. Kete e kane bere me qellim te pershtatjes vendit te caktuar, mu ashtu si eshte bere edhe me vecorite e tjera te identitetit rom. Sot romet i perkasin tri religjioneve: religjionit musliman, katolik dhe ortodoks. Religjioni musliman haset ne tere Kosoven. Para konfliktit, ne Kosove ka ekzistuar nje numer shume i vogel i romeve me perkatesi ortodokse, e cila eshte has ne Rahovec, Suva Reke, si edhe ne disa vende te tjera. Edhe ne Shqiperi shumica e romeve i perkasin religjionit musliman, ndersa ne Greqi jane te religjionit ortodoks, sikunder qe nje numer jane edhe ne Serbi, ne Bulgari, Rumani, vecmas ne Rusi. Ne vendet e tjera, romet vendor, e kane religjionin katolik. Pra, perkatesia religjioze e romeve eshte e njejte si me perkatesine religjioze te shqiptareve.

Vetedia mbi identitetin etnik

Te gjithë romet, si te ne, ashtu edhe ne tere boten, jane te njejte. Disa ndryshime ndermjet nesh jane te lidhura me ngritjen ekonomike – sociale, ashtuqë disa rome jane ne gjendje me te mire: kane shtepia te mira, me veshje dhe rregullim te mire, duke u marre me pune e cila siguron jete me te mire, ashtuqë keta Rome nuk ndryshojne nga te tjeret per nga gjendja e tyre, sikunder qe nuk ndryshojne edhe per nga pamja e tyre Te tjeret

jetojne ne kushte shume te renda jetesore: shtepiat i kane nga materiali i dobet - nga derrasa, kartona dhe najlona, me shume femije dhe me nivel shume te ulte shkollor.

Por, romet dallohen edhe per nga punet me te cilat mirren. Keshtu, disa mirren me punet e kovacellekut, hekurit, te tjeret me punen e tokes, sikunder qe kemi edhe rome te cilet mirren me muzike, me tregeti dhe me disa pune te tjera. Por, romet dallohen ndermjet vedi edhe per nga niveli i ngritjes se vetedies mbi identitetin etnik. Nje numer i romeve e mohojne perkatesine e vet si rom. Te ketille jane romet e situuar, romet me gjendje te mire ekonomike, te cilet e meshehin veten nen nacionalitetin tjeter. Te mohuarit e perkatesise komunitetit rom e bazojne ne gjuhen rome, te cilen disa rome nuk e dijne, per arsye te asimilimit me te plote te tyre. Por, duhet dijtur se gjuha eshte njera prej vecorive te identitetit etnik. Te gjitha vecorite e tjera jane te njejta me romet. Keshtu, ata kane marredhenie vetem me romet, sikunder qe martesat behen vetem ndermjet tyre. Keta rome me te tjeret nuk kane kurefar lidhjesh, ashtuqë te tjeret keta rome nuk i diferencojne si te tjere, por te gjithet i fusin ne nje thes, duke i konsideruar te gjithet rome. Per kete me herret eshte shkruar artikulli i vecant, nen titullin "Kush jane ashkalite dhe egjiptianet?"

Pra, marre ne pergjithesi, vetedia mbi perkatesine rome eshte shume e ulte, sidomos te ata te cilet jane ne gjendje me te mire ekonomike – sociale, te cilet meshihen nen hijen e te tjereve, ashtuqë keta rome edhe deklarohen si jo rom.

* * *

Romet ne Kosove, ne Kosoven multietnike, demokratike dhe shtet te pavaruru e sovran, jane komunitet i barabart me te tjeret. Ata nuk jane ketu para 50 ose 100 vitesh, por para me shume shekujsh. Ne Kosove, baballaret, gjysherit, stergjesherit dhe katragjeshirit i kane lene eshtrat e tyre. Prandaj, romet Kosoven e ndiejne vendin e tyre, atdheun si edhe token e tyre, keshtuqë "nuk mund te qendroje mendimi se shtepiat mund te jene tonat, por toka jo". Une, me goje te plote them, se Kosova eshte edhe toka e jone.

ARTI NË VEPRIM, IMAGJINATA I SHTYN TË RINJTË ROM, PLEMETINA I DREJTOHET PLANETIT



Arti në Veprim ishte një shkëmbim ndërkombëtar i të rinjve që i mbledhi rreth 60 të rinj nga Kosova, Serbia, Gjermania dhe Franca, por për të gjithë ne ishte më shumë se vetëm shkëmbim i të rinjve.

Ndokush mund të mendojë pse është zgjedhur Plemetina si vend. Shumica e njerëzve në Kosovë nuk e dinë ku ndodhet Plemetina. Disa njerëz kanë dëgjuar për të, vetëm për shkak se është afër termocentralit Kosova B, ndërsa disa të tjerë kanë dëgjuar për të "duke iu falënderuar" ndërtesave shoqërore apo "kampit të dikurshëm të të zhvendosurve", por megjithatë shumica e njerëzve nuk dinë asgjë për Plemetinën. Dy vite më parë, një grup vullnetarësh nga Serbia, Polonia, Italia dhe Franca erdhën në Plemetinë në Qendrën Mësimore të Balkan Sunflowers për të organizuar punëtori në lidhje me mjedisin për fëmijët dhe të rinjtë romë. Kjo ishte hera e parë për ta në Plemetinë dhe hera e parë që panë aq shumë padrejtësi në një vend.

Edhe pse të shtyrë nga përshtypjet dhe ndjenjat e përzieria, grupi i të rinjve vendorë e "kontaminuan" grupin e vullnetarëve me valë pozitive, kështu që ata vazhduan të vijnë sërish. Pak kohë më pas, në maj të vitit 2010 në Plemetinë lindi ideja për themelimin e një organizate të pages, e cila do të fokushej në veçanti në të drejtat e të rinjve romë, ashkalinj dhe egjiptas, GAIA u themelua me përkrahje nga Balkan Sunflowers dhe Shërbimi Civil Ndërkombëtar, përderisa themeluesit kryesorë ishin të rinjtë rom, ashkalinj, egjiptas, shqiptarë dhe serbë nga Kosova. Vetëm disa muaj pasi që u

themelua, GAIA së bashku me Romanwood filloi zhvillimin e idesë së Artit në Veprim. Në vitin 2010, në kuadër të festivalit të filmit IMAGelN'AIR në Gjilan, Romanwood e organizoi një punëtori artistike 10 ditore me të rinjtë rom nga Franca, Gjermania dhe Kosova. Duke u bazuar në këtë përvojë dhe për shkak se kanë praktika dhe interesa të përbashkët, Gaia dhe Romanwood e shkruan së bashku këtë projekt të ri.

Qëllimi i këtij shkëmbimi të rinjsh ishte krijimi i një hapësire ndërkulturore kreative dhe mundësive për eksperimentim me art dhe kulturë si mjete për shkëmbim shoqëror. Në fakt, kjo është ajo që ka ndodhur këtu.

Shumë nga emocionet dhe ndjenjat e pashprehura kanë mbetur prapa, me shpresë për veprime të ardhshme. Për disa nga ekspertët dhe aktivistët e rinj kjo nuk ishte hera e parë në Kosovë, por për ata që erdhën për herë të parë, sfida për të kuptuar nuk ishte e lehtë.

Edhe pse ka shumë probleme shoqërore, të mjedisit dhe politike në komunitetin e Plemetinës, çështjet me prioritet janë përcaktuar së bashku me të rinjtë vendorë. Të rinjtë, me shumë entuziazëm, zgjedhën temat në vijim: përjashtimi shoqëror, mobiliteti, situata në kampin e Plemetinës, padrejtësia mjedisore që shkaktohet nga ndotja nga termocentralet.

MENDO. MËSO. VEPRO.

Ky është një nga sloganët e krijuar nga pjesëmarrësit e shkëmbimit të të rinjve Arti në Veprim. Përmes 5 punëtorive të ndryshme ata patën rastin të mësojnë, shkëmbejnë, të zhvillojnë shkathtësi të reja, të përdorin mjete të reja mediale

dhe ta shprehin veten në mënyra kreative dhe artistike. Arti në Veprim ishte edhe vend për shkëmbim të praktikave më të mira në mes të pjesëmarrësve dhe ekspertëve nga Franca, Gjermania dhe Kosova. Kjo është bërë përmes muzikës, videove, fotografisë, vallëzimit step dhe punëtorive kreative aktiviste. Pasi që kjo ishte hera e parë që aq shumë të rinj nga kultura të ndryshme takohen në Plemetinë për një kauzë të përbashkët, ku i kaluan dy javë duke jetuar dhe punuar në të njëjtin vend, u sfiduan kufijtë, taktikat dhe arritjet e mundshme. Korniza dhe forma e vrazhdë u përcaktuan, por koncepti u plotësua nga aktivistët, artistët me më shumë përvojë dhe pothuaj se për herë të parë u përfshinë të rinjtë vendorë. Gjatë dy javëve, u krijuan 5 filma të shkurtër dokumentarë dhe video, 4 këngë u kompozuan, një koreografi vallëzimi step u përgatit, u krijua një ekspozitë e fotografive dhe u prezantuan problemet në lidhje me mjedisin.

Të gjitha rezultatet u prezantuan më 3 shtator në qendër të Prishtinës. Kjo ndoshta ishte një nga ngjarjet e para në ambient të hapur në Prishtinë që u mbajt në gjuhën rome dhe serbe. Ishte e fuqishme, inspiruese, pozitive dhe inkurajuese. Disa nga të rinjtë ëndërronin për këto momente – të këndonin në gjuhën e tyre para publikut, i cili kënaqet dhe i përkrah. Disa të tjerë dëshironin të thonë me zë se janë krenarë që janë romë dhe se i meritojnë të njëjtat si gjithë të tjerët – ata i kanë të drejtat e njëjta si të tjerët dhe do të mësojnë si të luftojnë për to në mënyrë kreative. Me këtë veprim, të rinjtë e Plemetinës i ndanë shqetësimet



e tyre rreth çështjeve që ndikojnë në të ardhmen e tyre. E gjitha kjo u theksua qartë në Deklaratën e cila iu shpërnda publikut dhe i është dërguar përfaqësuesve lokal. Si një kohëzgjatë simbolike, e tëra kjo ndodhi para Ministrisë së rinisë, Ministrisë së energjisë dhe minierave dhe korporatës energjetike të Kosovës. Është për të ardhur keq që asnjëri nga përfaqësuesit e tyre nuk ishte prezent atë ditë, pasi që të Rinjtë e Plemetinës kishin shumë për të thënë dhe shumë për të ndarë.

Ky është vetëm fillimi i përpjekjes së tyre të përgjithshme. Përderisa të rinjtë në Gjermani dhe Francë mund të zgjedhin se ku dhe si do ta kalojnë vitin e ardhshëm duke studiuar apo duke u paraqitur vullnetarë, të rinjtë e Plemetinës duhet ta zgjedhin formën e përpjekjes së tyre. Të drejtat e tyre njerëzore shkelen që nga

momenti kur lindin. Mjedisi i tyre është i ndotur nga pluhuri dhe tymi nga termocentrali për më shumë se 50 vite. Ata nuk kanë qasje në transportin publik që do t'i lidhte me vendet më të mëdha, si Obiliqi apo Prishtina. Shumica nga ta ende jetojnë në frikë nga diskriminimi apo lëndimi. Për të rinjtë në kamp, situata është edhe më e vështirë. Ata janë detyruar të largohen nga shtëpitë, ku nuk do të kthehen kurrë. Ata jetojnë në varfëri, në ndërtesa shoqërore ku kushtet e jetesës janë larg nga të qenit të pranueshme dhe asnjëherë nuk kanë mundësi për tu rritur, mësuar apo shëtitur. Me këtë shkëmbim, shumë gjëra u bënë për herë të parë. Të rinjtë vendor dhe pjesëmarrësit Ndërkombëtarë patën rast të vallëzojnë, këndojnë, luajnë, të tregojnë dhe të thonë. Publiku i Prishtinës pati rast të shikojë, të dëgjojë, të kënaqet

dhe të shohë e të ndiejë.

Ky shkëmbim i të rinjve vetëm mund të na inspirojë për më shumë, sepse është e mundur dhe e vlen çdo përpjekje, netët pa gjumë, ditët pa ujë dhe energji elektrike, sepse ndryshimi mund të ndjehet dhe të njihet, nëse me të vërtetë besojmë në të.

(Milica Milovic, koordinatore e Artit në Veprim & Helena Pouckj, Anëtare e Gaia dhe eksperte e Mjedisit.)

Filmat e Artit në Veprim www.youtube.com/user/gaiakosovo
muzika e Artit në Veprim <http://soundcloud.com/gaiakosovo>
Për ta shkarkuar Deklaratën e të Rinjve të Plemetinës dhe për më shumë informata rreth projektit: <http://gaiakosovo.wordpress.com/>
Kontakt: gaia.kosovo@gmail.com
+386 49 216 164

Arti në Veprim është përkrahur nga fondi Francez Gjerman në shtetet e botës së tretë, Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur KFOS dhe Instituti për Shoqëri të Hapur (Budapest).

ROLLING FILM FESTIVALI: KINEMATOGRAFIA ROME, RROKULLISJA PËR NDRYSHIM

Filma të krijuar nga & për romët
Charlotte Bohl



"Qëllimi im jetësor është të bëj filma për romët që njerëzit të mund ta kuptojnë kulturën, historinë, artin e romëve – e edhe luftën e tyre në jetën e përditshme. Por filmat që nuk shikohen nuk janë filma. Më duhej një vend në Kosovë ku do të mund t'i shfaqja filmat e mi për komunitetin rom por edhe punën e qindra filmbërësve tjerë rreth botës që po e vënë në pyetje keqinterpretimin, stereotipet dhe padrejtësinë shoqërore ndaj romëve. Këta filma kanë nevojë të shfaqen; këto tregime të dëgjohen. Kështu filloi e tëra me Rolling Film Festival-in".

Sami Mustafa, themelues dhe Drejtor Artistik i Rolling Film Festival-it;

I themeluar në vitin 2009, Rolling Film Festival-i u lind duke iu falënderuar kreativitetit të filmbërësit të ri rom, Sami Mustafa, dhe përkrahjes së Balkan Sunflowers, në veçanti koordinatorit të mëparshëm të projektit, Lara Cork, në bashkëpunim me OJQ-në Romawood.

Ndërtimi i festivalit të filmit mbi këtë temë nuk ishte punë e lehtë. Por motivimi i fortë i ekipit shtyhej përpara nga ndjenja e domosdoshmërisë dhe urgjencës për t'iu përgjigjur mungesës së njohurisë së publikut të gjerë në Kosovë për romët dhe diskriminimin e paragjykimin e konsiderueshëm ndaj tyre. Romët ballafaqohen me keqinterpretime të njëjta edhe në vendet tjera Evropiane por në Kosovë ata gjithashtu shihen nga shumë shqiptarë etnikë si dikush që ia ka mbajtur 'anën' serbëve gjatë konfliktit të vitit 1999 dhe prandaj shpesh herë trajtohen me përbuzje. Si të sfidohen këto imazhe negative ndaj romëve në Kosovë? Si të adresohet kjo mungesë e njohurisë? Këto janë pyetjet të cilave Sami po mundohet tu përgjigjet në punën e tij të përditshme si filmbërës.

Sfido imagjinaret

Edukimi, shëndetësia dhe punësimi duhet të ecin përpara. Por edhe imagjinata e njerëzve duhet të sfidohet gjithashtu. Kjo mund të arrihet përmes fuqisë së kulturës, themelore për krijimin e shoqërive të hapura dhe përfshirëse duke inkurajuar debatin dhe duke krijuar hapësirë për ndërveprim si edhe për shprehje publike dhe politike.

Filmi është një medium jashtëzakonisht i fuqishëm. Ai mund ta prekë dhe inspirojë audiencën dhe të jetë premtimi i ndryshimit të përfaqësimit kolektiv. Filmbërësit mund të ndihmojnë në transformimin e mentalitetit përmes tregimit dhe cilësisë së shprehjes së tyre.

Por filmat gjithashtu mund të kontribuojnë në arritjen e të kundërtës, rezultateve negative dhe destruktive. Kështu që, po një Festival të Filmit, por me selektim të kujdesshme. Kjo ishte një nga sfidat më të mëdha të Rolling Film Festival-it. Procesi i selektimit duhej të siguronte se RFF nuk do të kontribuonte në shpërndarjen apo përforcimin e stereotipeve për romët – jo vetëm stereotipet negative po edhe ato pozitive. Portretimet ekzotike dhe romantike mund të ko-ekzistojnë dhe t'i legjitimojnë dhe përforcojnë stereotipet negative. Filmbërësit e talentuar dhe të njohur gjithashtu flirtojnë me stereotipet pozitive; Rolling Film Festival-i vendosi që kjo çështje duhet të diskutohet.

Nga & Për Romët

Një nga përgjigjet në këtë sfidë ishte të përfshihen filma të bërë nga romët duke siguruar portretimin e balancuar të këndvështrimit të romëve. Filmbërësit romë kanë perspektivë të ndryshme për komunitetet e veta nga filmbërësit jo-rom.

Shfaqja e filmave nga filmbërësit rom dhe jo-rom ofron këndvështrim më të balancuar për publikun. Gjithashtu, filmbërësit rom nuk bëjnë gjithnjë filma për romët, prandaj ne dëshirojmë gjithashtu t'i përkrahim iniciativat e tilla dhe ta promovojmë punën e tyre si artistë.

Rolling për herë të parë

Njëzet e gjashtë filma nga e tërë bota janë shfaqur gjatë tre ditëve në edicionin e parë në vitin 2009, duke përfshirë filma të shkurtër, të gjatë, filma të metrazhit të gjatë, dokumentarë, filma profesional dhe fillestarë.

Shfaqja e filmave u pasua nga diskutimet pas secilit film të shfaqur – në disa raste me filmbërësit e ftuar enkas për këtë rast. Këto diskutime mbuluan tema si edukimi, identiteti, rolet gjinore, historia, pasojat e stereotipeve dhe dallimet në mes të komunitetve të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve në Kosovë.

Cilësia e programit të filmit nuk ishte suksesi i vetëm i këtij edicioni të parë. RFF kishte 1700 vizitorë, një përkrahje të jashtëzakonshme nga audienca, dhe inicoi një veprim të rëndësishëm të festivalit: Rolling në Shkollë.

Rolling në Shkollë – një takim me të rinjtë

Rreth 600 të rinj morën pjesë për prezantimin e filmave të pasuar nga "teatri stop dhe aktro" për diskriminimin dhe paragjykimin. Edukatorët e komunitetit e facilituan këtë program. Programi shkollor kishte edhe momentet më të mira, edhe disa nga më të vështirat e festivalit. Diskutimet theksuan se shumica e të rinjve kosovarë, madje edhe në shkollat më të mira dhe më progresive në kryeqytet, kanë

paragjykime dhe stereotipe jashtëzakonisht të forta ndaj romëve.

Programi i hapi mendjet për hulumtim në vitin 2011, "RFF e mori rrugën" dhe solli magjinë e kinemasë në shfaqjet në komunitet dhe në programe shkollore në nëntë qytete rreth Kosovës. Më shumë se 1300 nxënës morën pjesë në diskutime dhe në shfaqjen e filmave.

Ky program shkollor ndodhi pas 4 ditësh të Rolling programit në Prishtinë (Teatri ODA). Edicioni i dytë i festivalit e dyfishoi audiencën me rreth 3300 vizitorë duke përfshirë Rolling të shfaqjeve në Prishtinë, në Rugë, në Shkollë dhe në Komunitet. Zhvillimi i shpejtë brenda dy edicioneve premtonte qëndrueshmëri.

Rolling.... për ta takuar njëri-tjetrin

Gjatë edicionit të parë në vitin 2009, 61% e anëtarëve të audiencës së pyetur e identifikuan veten si shqiptarë kosovarë por vetëm 3% e identifikuan veten si romë të Kosovës. Sivjet Balkan Sunflowers dhe Romawood e zbatuan zgjerimin në

komunitetet romë për ta rritur pjesëmarrjen e romëve.

Ndryshe nga Prishtina, e cila përfiton nga jeta dinamike kulturore, pjesës tjetër të Kosovës i mungojnë aktivitetet dhe infrastruktura kulturore. Komuniteti rom në Kosovë jeton jashtë Prishtinës. Të rinjtë romë kanë shumë pak mundësi për të lëvizur qoftë për shkak të arsyeve ekonomike, qoftë për shkak të mungesës së lirisë së lëvizjes. Shumica prej tyre kanë qasje të kufizuar në aktivitete kulturore.

Si është e mundur të ndryshohet përfaqësimi negativ për romët nëse jo-romët nuk kanë mundësi t'i takojnë romët? RFF e organizoi transportin nga rrethina për ta ndihmuar pjesëmarrjen e të rinjve rom. Çdo natë të rinjtë nga Gracanica, Plemetina dhe Fushë Kosova morën pjesë në festival. Për shumicën, kjo ishte hera e parë në kinema, madje edhe pjesëmarrja në ngjarje në Prishtinë.

Nëse prezenca e audiencës romë ishte e veçantë sivjet, me më shumë se 50% të audiencës nga komuniteti rom në natën e hapjes, fatkeqësisht shumë pak përfaqësues

nga institucionet e Kosovës iu bashkëngjitën kësaj ngjarje. Komunikim i dobët? Jostabilitet politik gjatë kësaj periudhe? Mungesë e interesimit dhe përfshirjes? Rolling Film Festival-i duhet ta rishikojë strategjinë e vet për edicionin e radhës.

RFF në vitin 2011 i paraqiti më shumë se 30 filma nga e gjithë bota dhe inspiroi ndryshim, adaptim dhe ruajtje të jetës romë në shoqërinë e sotme. Përderisa këto tregime ishin në veçantinë e tyre nga dhe për romët, sukcesi i tregimtarëve është se ato janë gjithashtu tregime universale të ndeshjes së traditës dhe modernes, të humbjes dhe shpresës, të shtëpisë dhe kufijve të rinj, të krenarisë dhe paragjykimit, të humorit dhe dëshpërimit.

Filmat e zgjedhur janë zbuluar duke iu falënderuar thirrjes për filma por edhe përmes hulumtimit të gjerë mbi kinemanë romë, duke përdorë shumë rrjete të ndryshme për të gjetur filma dhe për t'i inkurajuar filmbërësit ta prezantojnë punën e tyre. Mbi 70 filma janë para-selektuar dhe shikuar nga ekipi selektues. Një qëllim i





programit të këtij viti ishte të zgjedhen tema specifike që do të zhvilloheshin secilën natë. Dy apo tre filma që ndërlidheshin me një temë specifike shfaqeshin njëri pas tjetrit. Audienca erdhi jo vetëm për të parë filma por edhe për tu kënaqur me koncertet, ekspozitat e pikturës dhe fotografisë, poezitë dhe performancat e vogla.

Shfaqja por edhe produksioni

Shfaqja e filmave është mision i rëndësishëm i RFF. Por kjo nuk është e mjaftueshme. Në mënyrë që të bëhet ndryshim në Kosovë, nevojitet që t'i japim hapësirë zërit të të rinjve rom dhe t'i sjellim ata në skenë. Ata janë mu ata të cilët mund t'i adresojnë çështjet në komunitetet e tyre. Ata janë mu ata që nevojitet të fuqizohen. RFF beson se këtë mund ta bëjnë përmes filmbërjes dhe përdorimit të teknologjive të reja. Ata mund të kenë mungesë të lirisë së lëvizjes por të gjithë kanë telefona mobil dhe adresë në Facebook. Arsimimi në media dhe imazhe është një aftësi që është padyshim thelbësore për jetesë në një shoqëri demokratike. Ai ndihmon zhvillimin e mendimit kritik, pjesëmarrjen dhe vetë-shprehjen. Ekziston një nevojë e fortë për ta rritur nivelin e arsimimit medial të njerëzve më të cenueshëm në Evropë, siç janë romët,

dhe tu ofrojë atyre mundësi për të analizuar dhe prodhuar media dhe imazhe ashtu që të mund të luftojnë për të drejtat e tyre dhe të kontribuojnë në rrënimin e përfaqësimeve kolektive negative. Prandaj në vitin 2011, RFF nuk ishte vetëm vend për transmetim, por edhe për prodhim të filmave. 15 filma të shkurtër të telefonave mobil u prodhuan me shumë energji dhe disa ide inovative nga të rinjtë rom prej vendeve të ndryshme në Kosovë. Këta filma janë shfaqur në Prishtinë gjatë natës që fokusohet në iniciativat dhe kreativitetin e artistëve të rinj romë, si dhe u dhanë shpërblime. Që atëherë filmat e shkurtër kanë marrë shpërblime në festivale të tjera Evropiane të filmit.

Le të Rrokullisemi... në 2012

Një selektim i kujdesshëm, ngjarje festive rreth festivalit, strategji për arritjen e komunitetit dhe audiencës, veprime specifike për ta arritur publikun specifik, programe edukative, hapësirë për të rinjtë romë ta shprehin veten dhe demokratizim i praktikës së filmimit: këto janë disa nga elementet e domosdoshme për ekzistencën e Rolling Film Festival-it.

Por këto nuk janë sfidat e vetme me të cilat ballafaqohet ajo që sot është ngjarja më e

madhe rome në Kosovë dhe njëra nga festivalet e pakta të dedikuara kinemasë rome në botë.

Ka shumë më shumë se zhvillimi për t'i arritur caqet tona dhe për të bërë ndryshim. Gjëja më e rëndësishme, ndoshta është krijimi i një programi afat-gjatë dhe planifikimin e aktiviteteve gjatë tërë vitit si "Klubi i kinemasë rome", program shkollor të vazhdueshëm dhe zhvillim të partneritetit afat-gjatë me shkolla, së bashku me punëtorë dhe trajnim afat-gjatë për të rinjtë romë mbi filmbërjen. Ky zhvillim, së bashku me vetë festivalin, do t'i ofronte projektit një trajektore afat-gjate dhe do ta mbante premtimin e ndikimit edhe më të madh shoqëror.

RFF do ta organizojë edicionin e vet të tretë në tetor 2012. Le të rrokullisemi....

(Autorja është Koordinatorë e projektit Rolling Film Festival)

www.balkansunflowers.org; www.romawood.wordpress.com; www.rollingfilm.org

Rolling Film Festival-i nuk do të mund të realizohej pa organizatorët e "Romawood" dhe "Balkan Sunflowers Kosova" dhe pa përkrahjen e sponsorëve: Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur, Filmat që Vlejnë të Amnesty International, Instituti për Shoqëri të Hapur, Këshilli i Evropës, Kampanja Dosta!, Ambasada e Zvicrës në Kosovë dhe Ambasada e Francës në Kosovë.

Fotografitë e përdorura për këtë edicion të Magazinës Evropiane



Chachipe garë e fotografisë

Shumica e fotografive në numrin e revistës *Magazina Evropiane* mbi romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit janë të marra nga dy konkurrimet e para të Chachipe fotografia të organizuar nga Fondacionet për Shoqëri të Hapur dhe OSA Archivum. Chachipe do të thotë “e vërtetë” apo “realitet” në gjuhën rome, por edhe mund të nënkuptojë “e drejtë”.

Gara e parë Chachipe, e mbajtur në vitin 2007, synoi fotografi që kishin të bënin me tema nga Dekada e Përfshirjes së Romëve 2005–2015—edukimi, punësimi, jetesa dhe shëndeti—dhe të cilat e thyenin paragjykimin tradicional të portretimit të romëve. Gara e dytë e shpallur në vitin 2008, Chachipe të Rinjtë, u hap për të rinjtë që kishin bërë fotografi për romët dhe jetën e tyre në shtetet e Dekadës. Chachipe të Rinjtë synoi të ndihmojë në luftën ndaj stereotipeve vizuale të asocuara me romët dhe t'i prezantojë romët dhe kulturën e tyre në mënyrë më të ndjeshme dhe më artistike.

Gara e tretë, Chachipe Harta, do ta vejë një theks të veçantë mbi shpërndarjen gjeografike të kulturës rome dhe t'i “rishpërndajë” në mënyrë simbolike ngjarjet dhe veprime që kanë të bëjnë me romët. Konkurrimi është i caktuar të fillojë në tetor 2011.

Për më shumë informata dhe fotografi, vizitoni www.chachipe.org.

Fotografitë e Chachipe që janë përfshirë në këtë numër të *Magazinës Evropiane*:

- © Nina Nikolova: faqja e parë
- © Valentin Hristov: faqe 2
- © Slobodan Simic: faqe 4
- © Zoltan Balogh: faqet 5 dhe 35
- © Dimitar Apostolov: faqet 6 dhe 22
- © Krisztian Kondor: faqet 23 dhe 25
- © Lucian Enasoni: faqet 24 dhe 56
- © Decebal Codruta: faqe 26
- © Sandor Naske: faqe 29
- © Therese Lippold: faqe 41
- © Ognjen Ademovski: faqe 52
- © Tamas Fabianffy: faqe 55
- © Kincso Salat: faqe 58
- © Boris Kocis: faqe 59



Punëtori e fotografisë “Përmes syve të mi”

Një numër i madh i fotografive në këtë numër të *Magazinës Evropiane* mbi romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit janë rezultat i punës të fotografisë të organizuara në 6 qendra të komunitetit në 5 komuna në kuadër të komponentës së kulturës të Përkrahjes së BE-së për Zbatimin e Strategjisë RAE. 60 fotografi të prodhuara gjatë punës janë ekspozuar në Teatrin Kombëtar gjatë Festivalit një javor për romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit, i cili u mbajt nga 23-29 maji, 2011 në Prishtinë, Prizren dhe Mitrovicë.

Përkrahja e BE-së për Zbatimin e Strategjisë RAE është projekt i financuar nga BE-ja, e i menaxhuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë dhe e Implementuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur.

Për më shumë informata mbi Festivalin Rom, Ashkali dhe Egjiptas, vizitoni <http://www.festival2011.info>

- © Sergjan Morina, Gjakovë/Djakovica: faqe 7
- © Ibrahim Hajdari, Mitrovicë/Mitrovica: faqe 8
- © Gylten Vashall, Prizren: faqet 12 dhe 18
- © Egzon Krzeyiu, Ferizaj/Uroševac: faqe 19
- © Kujtim Salihi, Mitrovicë/Mitrovica: faqe 20
- © Jemina Osmani, Prizren: faqe 36
- © Sognita and Sunaj Trefuni, Gjakovë/Djakovica: faqe 51



Projektet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur:

Do të donim gjithashtu ta falënderojmë Fondacionin Romedia, Budapest për fotografitë e bëra gjatë produksionit të filmit dokumentar *Uprooted*. Ky dokumentar i cili i adreson çështjet e riatdhimit të komuniteteve romë, ashkalinjë dhe egjiptas nga shtetet perëndimore u iniciua dhe financua nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur dhe Iniciativat Rome.

Falënderim i shkon edhe Balkan Sunflowers Kosova dhe GAIA për fotografitë e bëra gjatë implementimit të Festivalit *Rolling Film Festival* dhe Projekteve *Arti në Veprim*.



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo
Kosovo Foundation for Open Society